

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrare online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Përmbajtja / Sommario

EDITORIALI	faqe 3
Drejtori	
NGA ARBËRIA	faqe 4 -6
Motimadh / Giuseppe Mario Miracco, Kostantin Bellusci, Maria Teresa Conte	
ZAKONE POPULLORË, TEKSTE NGA ARBËRIA	faqe 7-8
Giuseppe Chiaffitelli	
NGA HISTORIA E KATUNDEVET ARBËRESHË - PURÇILLI	faqe 9-11
Alicia Bodily	
ARTIKUJ E STUDIME MBI BOTËN ARBËRESHE	faqe 12 - 30
Italo Costante Fortino	
Klara Kodra	
Ina Arapi	
Helena Grillo&Alisa Velaj	
Greta Jani	
Imri Badallaj	
ARTIKUJ E STUDIME MBI BOTËN ARVANITE-SHQIPTARE	faqe 31-40
Merita Toçila	
Shyhrete Morina	
STUDIME, POEZI, LETRA mbi zotin EMANUELE GIORDANO	faqe 41-48
Manjola Lubishtani	
Tommaso Campera	
Letra Drejtorit (mbi nr.79, të kushtuar zotit Emanuele Giordano)	
POEZI SHQIPE	faqe 49
Laureta Petoshati	
POEZI ARBËRESHE	faqe 50-53
Giovanni Frate, Alessandro Rennis, Nicola Alfano, Carmine Stamile, Giuseppe Gallo	
NGA FESTIVALI I KËNGËS ARBËRESHE	faqe 54
Francesco Scaravaglione- Pasquale Bruno	
SEMINARI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS	faqe 54
DORËSHKRIMI ARBËRESH	faqe 55-56
Bernardo arciprete Bilotta	
QISHA BIXANTINE ARBËRESHE	faqe 57-64
Emanuele protopapas Giordano	
NJOFTIM-INFORMACION	faqe 65
JO VET ARBËRISHT	faqe 66-67
Pierfranco Bruni	
LIBRE, REVISTA E BLOG	faqe 68
Emanuele zot Giordano, Italo Elmo, Univ.Prishtina, Zef Pllumi (Keda K.), Eparchia Lungro, Zef Chiaramonte	
BIBLIOGRAFI ARBËRESHE NDËPËR REVISTAT SHQIPTARE	faqe 69-77
Ylli, Drita	

Jeta Arbëreshe

Semestrale online
di Cultura
e Informazione Arbëreshe,
in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtë mujore online e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”,
Purçill / Eianina (Cs-Italia)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del
28-12-2001.

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**
Drejtori, Redaksi e Administratë / Direzione, Redazione,
Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)

Tel.: (+39) 345-3124376 / **e-mail:** jetarbreshe@libero.it / **sito internet:** <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografji, edhe ndëse s’botohen, nëng priren prapë / Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono.

Drejtoria nëng është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati.

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati.

ISSN 2465-1141 Jeta Arbëreshe [Online]

Arbëreshi s'trëmbet

“Liria e Besës është një e drejtë e njeriut”. E tha Papa, tek të vaturit e tij në Tiranë e në Istambul, të krishterëvet dhe islamikëvet. E tha, me jetën e saj, edhe Mëma Tereze, shqiptare. Shëjte ndë vjesht 2016. Nnganjë është i zoti të ketë e t'mos t'ketë Besë. Besa është një zgjedhje e lirë, s'mund të jetë e imponuar. Për Besën e vetë njeriu s'ka t'i jap kundë jetrit. Sosën të mos t'i bënë dëme jetrit, shoqërisë te ku rron. Pra, për Besën e vetë, njeriu ka t'i japë kundë vet Zotit, kur shkron te jetra jetë. Ndëse ka besë te Zoti. Ndëse ka besë te jetra jetë.

Besa e Evropës, e Perëndimit, është ajo e Krishterë, me rrënjët thell te Vangjeli i Jisu Krishtit, të Birit t'Ynzoti: i pari që foli për Liri e për Dashuri. Me të Lerit e tij, 2015 vjet prapë, zu Dhjata e re. Vangjeli pruar jetën ka e prapja. Një revolucjonë. Po për të Krishterët zunë edhe persekutimet. Çë vijojën. Sot terroristët izlamikë e kanë me të Krishterët: therjen e shkrehjen, bëjnë atentate, vrasen (e vriten) në emër të Allahut. E jo vet tek Kombet e tyre mesëlindorë o afrikanë, po edhe në Perëndim.

Na **Arbëreshë** jemi të Krishterë. Iktim ka Arbëria, kur ra ndër duart e Turqvet, te shekulli XV, pse e njihjem fanatizmin e Turqvet muslimanë. Na Besën e Krishterë s'e ndërromi me mosnjëtër. Sepse Besa e Krishterë na bëri të lirë, e Liria jonë s'është petk ngushti.

Jeta Arbëreshe, që kur u le, folën për Besën e Krishterë, boton faqe Vangjeli, lufton për ruajtjen e Ritet Bixantin të Katundevet Arbëreshë, për gjuhën arbëreshe te Qishat tona. Besë, Rit e Gjuhë qenë, e janë, shtyllat e kësaj rivistje. Kemi një Kulturë komplekse, na Arbëreshë: jemi 'vëllezër gjaku' me Shqiptarët, jemi 'vëllezër riti' me Ortodhoksët. Kur serbët zunë gjenocidin e kosovarëvet, na arbëreshë qemë gjithë kosovarë; kur, pra, kosovarët zunë e dogjtin qishat orthodoxe, na qajtim me serbët.

Mbi faqet e kësaj rivistje, ç'ka i pari numër, shqiptarët të Kosovës dhe Shqipërisë bashkëpunojën me arbëreshët: pa ndarje besje. E arbëreshë e shqiptarë e kosovarë venë e vijën, ka mot, e punojën e mbësujën e kërkojën e botojën e marrën pjesë në Seminar e Kuvende. Sepse Kosova e Shqipëria janë moderate. E terrorizmi s'i ka hjë.

Jeta Arbëreshe është e krishterë. Sepse Arbëreshi është burr e s'trëmbet: as ulkut, as turkut. U rrit hero te shkolla e Skanderbekut: ndër luftat, trim; mbë qishë, i Krishterë. E ruan Mëma Tereze: sot e Lumtur, mot Shëjte. Shqiptare. E Para Shëjte Shqiptare.

Drejtori

L'ARBRESH NON HA PAURA - 'La libertà di Fede è un diritto dell'uomo'. L'ha detto il Papa, nel suo viaggio a Tirana e a Istanbul, ai cristiani e agli islamici. L'ha testimoniato con la sua vita Madre Teresa, albanese. Santa il prossimo 4 settembre 2016.

Ognuno è padrone di avere o di non avere Fede. . La Fede è una scelta libera, non può essere imposta. Sulla Fede nessuno deve dare conto all'altro: basta che non faccia danni all'altro, alla società in cui vive. Per la Fede propria, l'uomo deve dare conto solo a Dio, quando passa nell'altra vita. Se ha fede in Dio. Se crede nell'altra vita. La Religione dell'Europa, dell'Occidente, è quella Cristiana, con le radici che affondano nel Vangelo di Gesù Cristo, Figlio di Dio: il primo che ha parlato di Libertà e di Amore. Con la sua Nascita, 2015 anni fa, è iniziato il Nuovo Testamento. Il Vangelo ha capovolto il mondo. Una rivoluzione. Ma per i Cristiani cominciarono anche le persecuzioni. Che continuano. Oggi i terroristi islamici ce l'hanno con i Cristiani: sgozzano e fucilano, fanno attentati, uccidono (e si uccidono) in nome di Allah. E non solo nei loro Paesi mediorientali o africani, ma anche in Occidente.

Noi Arbëreshë siamo Cristiani. Siamo andati via dall'Albania, quando cadde nelle mani dei Turchi, nel sec.XV, perchè conoscevamo il fanatismo dei Turchi musulmani. Noi la Religione Cristiana non la cambiamo con nessun'altra. La Fede Cristiana ci ha resi liberi, e la nostra Libertà non è merce di scommessa.

Jeta Arbëreshe, da quando è nata, parla di Religione Cristiana, pubblica pagine di Vangelo, lotta per la difesa del Rito Bizantino dei paesi arbëreshë, per la lingua arbëreshe nelle nostre Chiese. Religione, Rito e Lingua sono state, e sono, le colonne di questa rivista. Abbiamo una Cultura complessa, noi Arbëreshë: siamo 'fratelli di rito' con gli Ortodossi. Quando i serbi iniziarono il genocidio dei Kosovari, noi Arbëreshë fummo tutti Kosovari; quando, poi i kosovari iniziarono a bruciare le chiese ortodosse, noi abbiamo pianto con i serbi.

Sulle pagine di questa rivista, dal primo numero, albanesi d'Albania e Kosova collaborano con gli arbëreshë: senza distinzione di religione. E Arbëreshë e Albanesi d'Albania e Kosova vanno e vengono, da tempo, e lavorano e insegnano e ricercano e pubblicano e prendono parte a Seminari e Convegni. Perchè Kosova e Albania sono moderate. E il terrorismo non fa loro onore..

Jeta Arbëreshe è cristiana. Perchè l'Arbëresh è uomo e non ha paura: nè del lupo nè del turco. E' cresciuto eroe alla scuola di Skanderbeg: nelle battaglie, guerriero; in chiesa, Cristiano. Lo difende Madre Teresa, oggi Beata, l'anno prossimo Santa. Albanese. Prima Santa Albanese.

Bjermi copa

Nga dit çë shkon o duket, o është, një dit e ndërruar.
Pse ki katundi im bier copa, ndërron, si gjindja
ndërron të veshura.

Gjindja pighet: kush na ftesen?

Ndonjë nëmë e ligë, ndonjë magji, o na murtin s'ç.

U së kërdhërinj këta shurbise, ka t'jet më gjë.

Bënj fëtig sa t'çonj të ndienj, po përgjegje së kam.

Këto shurbise të mangonjen si prind, jan lloket ku u
rrita, ku shkonj tri o kater her ditën: e kollogré së
shogh më; e së ndienj rrubullion, kriatura çë bredhen
o këndonjen së ndighen më, pse u mbullí skolla për
të voglit "Zoti Peshk Frangjisk Bugliari".

Sa vashez van këtëj sa t'mbësoghçin par të bëjin
provë të bëghçin mastra/mjeshtla skollje për të
voglit.

Kollogrétë iktin, vullartin si ndallanishet, dera
pëllasit u mbullí.

Mbanj mendë kur ím të vogel e ish dimer, bridhim
te trapëza; bënij sarén e suor Melania dil e na jí dí
keke, një cik çikullát, tue na thën të vejim mbrënda,
se sëmürçim.

Atjë i mjeri Zot Capparelli fërnoi të bi t'shigheim një
fillm, me një përrallë, 'Zëpen e të vëllezerit'; e bi
t'pam të paren her një televizion, me një përrallë e
re për vasha e ganjun, me joke e shurbise çë bëghçin
te të tjer katunde. Edhe burra të mbëdha vejin atjë,
sa t'shigjin një mjeshter skollje cë mbësonij ambëçedarin,
sa të mbësoin të shkrujin ëmërin e tire.

Kush i ndreqen sallet ku bëghet katekizmi, e ku
bëghet festa e të parit kungim, me at triez e gjat e
gjat, me kakra qumshtë e elp, e pasteta, kriaturve kur
mbjidhen ka qisha, me ato triesa të ndrequra rrot ka
jëmat, pjot tarël, viskote e mistacölë.

Së m'përpigën më ato gra të veshura ndër të zëza, pa
i vëdekur njeri, cë kur ím të vogel na përpigçin e kish
t'i thojim "I lëvderuar In Zot" (Sia lodato Gesù
Cristo), e ato na pergjegçin: "Ngagherë i lëvderuar"
(Sempre sia lodato).

I çoje te putiga, te qënga, mbë qishë, ùdhave çë kin
vat çuar ndonjë pjak çë së rrij mir.

Ato të parat mbërmira, kur te sëmurturit, kin kur të
gjata, jatroj i dërgonij tek ato të bëjin nicjónat.

Ku van? Te një par muaj, kush u sëmur, kushë vëdiq,
kush qe e dërguar te tjerë katunde.

Drita ardhme, mengu një cik nëng qëndron, tue na
lëriarlevoma.

Moti Madh / M. Giuseppe Miracco

ka Shën Sofia (Cs)

Vëllá

Patim një copë jetë cë dukej e ndrruar, pa vënë ré se
ish një jetë e vjeter. Së ndërron faregjë ndëse gjindja
së del ka ajo bokrri çë lidhen të bënjë miçindrikun;
ka t'e fërnoç të shoç me sit e tjer, ndëse për
ngreshënxje lodhe t'e ruaç me sit tënd.

Ngë të sosi një muaj, në mot mot, në dy, në tre, në
kater, në pes vjet: u dishtin nëndë vjet sa t'dunarçe
çë vëllá kinje afer.

Vëllá, një mbrëma tue serposur të pé te trapza; së
t'njigghja, po, tue bën mendim kush është ki i kshëtë,
m'u dukë një faqe e njoghur.

Dit apriasu, ndë katund, murmurisej se mangojin pak
dit e vinij një zot i ri, pjot fuçi, pjot mall për qishen
ton, pse dil ka mjeshtria njëj zoti me fuçi për qishen
lëbrisht.

Këjo qishë e vjeter o e re, e vën te gjugha njëj o njëj
njetri për priftra të dashur o të reshtur ka njera o jetra
pjes katundarëraç, e ardhura e ktij zoti u duk se i kish
bën kutjend gjithë këto pjes, çë bëjin dhitürëra tue
zgjedhur pa dhën kunde njeriu kush ish i mir.

Këjo e ardhur pritej me kutëndicë, gjithë prisin kët e
bekuar e diall ç'i jip kësaj famulli zotin e katundit.

Më moti shkonij, më qisha ndërronij: e diella zë e
dukej e diell, ki zot zu e këndoij meshen te qisha Shën
Thanasit, me vuxhë te shëndoshtë, këngëtar me
vuxhë e ëmbel, edhe gra, burra e kriatura të vogel i
pririn këndimin me gjell e dashuri, zëjin e kendojin
meshen gjithë.

Moti shkonij, qisha zbukuronij, me drita të rea
gjegjëtim edhe meshen e prjerë lëbrisht; zunë e u
kënduan troparet e nusavet, kur trimëria vej e lidhin
kuror, per një dashuri e bekuar ka Inzot; gjithë ditët e
shënjtruara ín të përmëndur e më të ndiera, u ndërrua
edhe valtimi të vdekurit, muzika kish e ndar dy pjes
një valtım: një pjes e këndonij prifti me këngëtar, e
një pjes e bij muzika: shum lëtinjë qëndruan pa fjalë
kur shkeltin skallunet e kësaj qishë.

Vëllá, shum ka katundaret, nga gher çë bie kambana,
pighen.

Vëllá, nga gher çë ghinjen mbë qishë e së ndienjen
ëren e fitilit, pighen.

Vëllá, kur dashuria fërnon të jet mundësi, bëghet
fuçi.

Emigrantja

Kostandin Bellushi

ka Pllatëni (Cs)

Me kazjunan e një ndodhje udhëtimore “Sapur dhe Mjeshtri e Alto Jonio”, ndër 24 të Shën Mitrit, ka ora shtatëmbëdhjetë, te salla e Këshillit të Bashkisë së Pllatënit, u prezentua/shfaq *Emigrantja*, me masës e gazetarias, doktoresha Mancanella Carmen, libri poezish i poetesas shqipëtare Eleni Mingu Birçaj, Botimet KUMI, Tiranë 2015, që jeton nd’ Talljat ka shumë vjet. Manifestimi kle organizuar ka “Gal Alto Jonio Federico II”, bashkë me Sportjeli Gluhësor i Bashkisë së Pllatënit, me Shoqatan Socjall-Kullturor “Bashkë”, me Grupin SPRA dhe me skulet e Skollas së Pllatënit. Mbrënda librit jan shkruar poezi të bukura dhe interesante, më shumë mbi mallëngjimin e emigracjonas për dheun dhe mbi papan Françesko (Papa Françesko), mbi Kosovan, mbi guerrës dhe më tjera. Ka mbledhja e presentacionas ishan krei i Bashkisë, avukat Tursi Francesco, që suall përshëndetjan e gjindjas së Pllatënit Këshilltaria e Bashkisë, Elia Pamela; Drejtoresha e Sportellit, Smilari Sandra; nënkrietari i GAL Alto Jonio, Durso Franco; profesori Bellusci Costantino, shkrimtar, dhe on. Brunetti Mario, konsull i nderuar i Shqipërisë. Libri ka mbrënda më se diqind poezi shkruar shqip, më të shumta autobiografike, dhe atò që flasan për emigrimin (Emigranti) dhe për lëshimin e dheut ku njerzit lehan; një mbi papan Françesko, ca për vlerat (S’ kam më vlerë), për ndiemat, për mallra fëmiliare dhe atëdhetare. Pas mbledhjas kullturore u bë nj’ festë popullore me të ngrënt tipik arbëresh pllantanjot.

LA ESULE- Nell’ ambito dell’evento itinerante “Sapori e Mestieri dell’Alto Jonio”, organizzato dal GAL Alto Jonio e dal Comune di Plataci, con la collaborazione dello Sportello Linguistico Comunale, della locale Associazione “Bashkë” (Insieme), dei Ragazzi dello SPRAR di Plataci e alla presenza dei docenti e degli alunni della Scuola Primaria e Secondaria di I grado di Plataci, il 24 ottobre, alle ore 17.00, è stato presentato nella Sala Consiliare di Plataci, moderato dalla giornalista, dott.ssa Mancanella Carmen, il libro di poesie *Emigrantja* (la Esule), dell’ autrice Eleni Mingu (Birçaj), che da anni vive in Italia. Erano presenti ed hanno relazionato il Sindaco di Plataci, avv. Tursi Francesco, che ha porto i saluti di tutta la Comunità platacese; il Consigliere Comunale, Elia Pamela; la dott.ssa Smilari Sandra, Operatrice dello Sportello Linguistico Comunale; il Vicepresidente del GAL Alto Jonio, geom. Durso Franco; il prof. Bellusci Costantino, scrittore e l’ On. Brunetti Mario, Console Onorario d’Albania. Il libro consta di oltre duecento poesie in lingua albanese, in gran numero autobiografiche, che trattano, in particolare, argomenti sulla malinconia dell’ emigrazione e la nostalgia per l’abbandono della terra natia (l’Emigrante); una su papa Francesco, alcune sulla trasmissione e l’importanza dei valori (Non ho più valore), dei sentimenti, degli affetti familiari e dell’amore per la propria terra natia. Dopo il Convegno culturale, si è svolta una sagra con degustazione di prodotti gastronomici tipici della cucina arbëreshe platacese.

Dita e Flamurit, Rromë

Maria Teresa Conte

(nga Shën Sofia-Cs)

Diten 28 Shënmërtir është festa nacionale e gjithë dheut arbëresh. Kët vit Komiteti arbëresh i Shën Thanasit organixarti Rromë një konferenxë me titull “Emigraciona arbëreshe te Shteti i Papës ndë sekullin XVIII”. Diten pas, te qisha e Shën Thanasit u tha mesha arbërisht, por arbëreshët e shqiptarët të shpishur te gjithë dheu.

Konferenxën e mbajti Profesori Italo Sarro nga Shën Japku arbëresh. Ai tha se ndë vitin 1756 ca fëmilë nga Skutari, më se 200 njerëz, i liptin Bonsinjurit ndëse mënd vejn ndë Italje tek Shteti i Papës pse turkrat i perseguitarjin. Kështu u nistin nga katundi Bria e me një vapur arvuen Ankonë. Kishin me ta di priftra, pjeq, djalra, gra e burra. U nistin nga Ankona mbë këmb e dhovu një muaj arvuen te katundi Kanin, ndë provinçën e Viterbit. Nga Kanini, prana, i dërguen te katundi i vogel Pianiano. Këtu, Papa i dha dheun sa të shurbejin, e, por të shurbier, i dha nga familje di qe, një lopë, ca shatra e ca dropra.

Pianian, ca fëmilë dish t’ikjin pse ish mallarja atje e zun sa të vëdisjin gjindjat. Këto fëmilë par vanë Napul, ku mbetin një muaj, e prana vanë te një katund që ja thon Poggio Imperiale, që gjondej ndë Pulje. Ma edhe këtu ish mallarja e penxuan sa të prirçin Pianian. Atje nëng u gjëndëtin më mirë pse nëng kishin më dherat. Kështu se gjith gjndja u shprish e kush vate nga një anë e kush vate nga jetra. Na dimi se ndë fund të sekullit XVIII ndë Pianian nëng kish më arbëreshëra.

Kështu Profesor Sarri fërnoj konferenxën e, për të mbullitur ditën e Flamurit, u këndua Ini Nacionall, kështu si ju e proponirmi këtu posh:

HYMNI I FLAMURIT

Reth Flamurit të përbashkuar
me një dëshir' e një qellim
të gjith atij duk j'u betuar
të lidhim besën për shpëtim.

Prej lufte veç ai largohet,
që është lindur tradhëtor.
Kush është burrë nuk frikohet,
po vdes, po vdes si një deshmor!

Në dorë armet do t'i mbajmë,
të mbrojmë atdhenë me çdo kënt.
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,
këtu armiqtë s'kanë vent.

Se Zoti vetë e tha me gojë,
që kombet shuhen përmbi dhe
po Shqipëria do të rrojë;
për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur shënj' e shënjtë,
te ty betonemi këtu,
për Shqiperin' atdhen' e shtrenjtë,
për nder' edhe lavdimn' e tu.

Trim burrë quhet dhe nderohet,
atdheut kush iu be theror,
për jet' ai do të kujtohet
mbi dhet, mbi dhet si një shenjtor!

Vreshta

Giuseppe Chiaffitelli

(ka Mashqiti, Pz)

Të parat Arbreshë çë iktin nga Morea e erdhitin Mashqitë ishan suldetra (stritjotë) e pë të rrojan klen shtrënguar të lëjan shpatan e të mirrjan shatin e parmendan: nga suldetra çë ishan më par, u bën vreshtare: u vunë të shurbejan vreshtat e të mbiëlljan grurët. Kur dish të “qandojan një vreshtë të re (pastenin) bëjan “skatenan” tura punuar dheun thjell (mbunu) 40 cm ma “pikunin”.skuatrojan” dheun ma një tërkuzë o një “katenë”hekuri a glatë 40 metra ku ish lidhur nga metër një xagarelë a kuqë.

Shtrojan e tilqjan fort kurdelan dy vetë (burra) e një grua ngulij kelmrat ku ndodhshin xagarelet, ashtu dheu ish skuatruar per së glati e për së gjeri ma radha (ordëna) e barbatelat vëhshin ku ishën kelmrat ma “hurin”.

Huri ish një kucër ma dij mënge si një kudher e kish ndën një hekur (shëmbi) picut, të glat gjëmsë metër e trash pes çëndimëtra. Një burrë ma kopane të forta bëj ma hurin një gavërë ku një grua vëj barbatelan e a fulosij tura shtënur rerë o dhe te butë çë a shtypij ma një purtekë sa ashtu zëj më mirë.

Barbatelan a pushtrojan ma pake dhe e a zbulajan të muaji majit kur nxirrij të parat vellastar. Barbatelat çë ishan dhri merikan e durajan mirë “fillosëran” do t’ishan nxëtuar (nëstuar) ta korriku (lluli) ma nesta a “xëfi”, a “spaku” o a “uequ”.

Nani barbatelat blihan të nxët .

Nëstaturi prisij nga një vreshtë vëllastaret më të treshra e me të njoma (matërrjali) e nga këta ma thikan nëstaturi shqitij syjtë tura vënë shumë rë pas çë i kish bën reth syjut katër të prera. Këtë shërbëtirë a bëhjeja ta sallmëndari o ndën një vëlliri sa dielli shumë i ngrohtë nëng kish terij “materjallin”.

Pas çë kish shqitur afër dyzet nxita, i laj e i vëj brenda një kashetë druri çë a mbaj mbillur pë mos të vej plëhtë o dhe e a hapij nga herë çë dish të mirrij një nest. Ta druri barbatelet të “skauxuar” bëj katar të prera dreq si i kish bënë ta vallasteret shqitij “skorxan” (lëvoran) e ta vendi i saj, vëj ma shumë re nestin çë lidhij shtrënguar mirë ma “rafjan”.

Një djalë mblidhij pes gjasht pambëna e mbuloj

LA VIGNA

I primi Arbresh che fuggirono dalla Morea e vennero a Maschito erano soldati e per vivere furono costretti a deporre la spada e a prendere la zappa e l’aratro: da soldati che erano prima diventarono agricoltori e si misero a coltivare la vigna e seminare il grano. Quando volevano piantare una nuova vigna facevano la “scatena” zappando col piccone fino a 40 cm. “Squadravano” il terreno con una fune o una catena di ferro lunga 40m dove era annodata per ogni metro un nastro rosso.

Stendevano e tiravano con forza la fune due persone ed una donna conficcava le canne dove si trovavano i nastri, così il terreno veniva squadrato in lungo e in largo con filari e le barbatelle si piantavano col “palo” dove erano le canne.

Il palo era un tronco con due manichi come una incudine con sotto un ferro appuntito, lungo mezzo metro e spesso cinque centimetri. Un uomo con potenti colpi praticava una buca dove una donna introduceva una barbatella mettendovi sabbia o terra friabile che pressava con una bacchetta perchè così radicava meglio.

Le barbatelle le coprivano con un po’ di terra e le scoprivano a maggio quando esse mettevano i primi tralci. Esse erano vitigni americani resistenti alla fillossera e dovevano essere innestate a luglio con innesti a “zufu”, a “spacco” o a “occhio”. Adesso le barbatelle sono comprate già innestate. L’innestatore tagliava da una vigna i tralci più grossi e più teneri (il materiale) e da questi con il coltello da innesto staccava le gemme con molta attenzione dopo aver fatto attorno alla gemma quattro incisioni.

Questo lavoro lo si eseguiva al “salmentario”, all’ombra o sotto un ulivo, perchè il sole molto caldo non potesse seccare il “materiale”.

Dopo aver staccato circa 40 innesti li bagnava e li metteva dentro una cassetta di legno che manteneva chiusa perchè non entrasse la polvere o la terra e la apriva ogni volta che voleva prendere un innesto. Sul legno della barbatella scalzata praticava quattro incisioni proprio come aveva fatto sui tralci, staccava la corteccia e, al posto suo metteva, con molta diligenza, l’innesto che legava molto bene con la raffia. Un ragazzo raccoglieva 5 o 6 pampini e avvolgeva l’innesto, poi una donna con la zappa copriva la vite

nxitin, prana një grua, ma shatin, pustraj dhrinë ma pak dhé.

Ta vjeshti zbulojan nestat e ata që kishan zënë e ishan të njoma, i mbulojan ma ca kartë të trashë. Ta paravera pas, nesti nxirij vallastarin barbatelja ish a prerë më mbi sa nesti e bëhij dhri “nustrallë” e jo më dhri “merikanë”. Ta dimri afër vatrës, sfëllojan spartan që kishan prerë të njomë ta gushti; shqitjan nga degat e spartës filët më të gletra e të holla që prana i lidhjan tura bënë tufa (dorza) të mbdha sa një dhamatë. Ta zjarri vatrës përsullojan gjithë sfitilosurat që diljan nga fundi dorzës. Bëjan adhe dorza shelqësh: mirrjan degat a holla e të trashat pas që i kishan ndarë dysh o tresh par së glati.

Atë që mbetij a digjian ta vatra: adhe mbeturimat vlejan!

Sparta duhij për të “kannuart”, për të lidhjan dhrinë ta kallmi, shelqit për të “palarojan”, për të lidhjan të katrat kellmra a “palarit”. Pas të vjelurit, ta dimri “spallojan”, domathënë shkuljan kollmrat nga dhrinë; ata që ishan adhe të tëra e këllmrat a re i ehjian (pëcutojan) ma dy kopané kizja.

con poca terra.

A settembre scoprivano gli innesti e quelli che avevano attecchito ed erano vegeti li coprivano con della carta spessa.

Nella primavera seguente l'innesto metteva un tralcio, la barbatella era tagliata al di sopra dell'innesto e diventava vite nostrana e non più americana.

D'inverno vicino al focolare sfilavano la ginestra che avevano tagliato verde ad agosto, staccavano dai rami della ginestra i fili più lunghi e sottili che poi legavano facendo fasci (manipoli) grandi quanto un covone.

Al fuoco del focolare bruciavano le sfilacciate che uscivano dal fondo del fascio. Facevano anche fasci di salici: prendevano i virgulti fini e quelli grossi dopo che li avevano spaccati in due o tre parti, secondo la lunghezza.

Ciò che restava lo bruciavano al focolare: anche lo scarto era utile!

La ginestra serviva per “cannare”, per legare le viti alle canne, i salici per “pagliare”, per legare le quattro canne del “pagliaro”. Dopo la vendemmia d'inverno “spalavano”, cioè “svellavano” le canne dalle viti, quelle che erano intere, e le nuove le affilavano con due colpi di biperne.

Università di Porcile: Catasto Onciario 1752

(Riassunti e trascrizioni di documenti originali © 2002-2006 Alicia Bodily)

Alicia Bodily

rrënjë purçilote, rron në Usa

(Shih: nr.66 di Jeta, p.24; nr.75,pp.31-32)

Documenti registrati dopo lo Stato delle Anime

Sesto Documento

Enumerazione dei beni dei forastieri

(p. 16 recto)

Si fa fede per noi sotto Crocesig[nan]ti Sind[a]co, ed Eletti dell'Università di questo Casale di Porcile, come praticate tutte le necessarie diligenze, questa sud[dett]a Università non ave fuori assenti. Come altresì facciamo fede, che le persone forastiere, che posseggono beni in questo nostro ristretto sono li seguenti, La mensa Vescovile di Cassano; e la Commenda di S[an] Gio:[vanni] Gerosolimitano, l'Abbadia di S. Lucia, che si tiene presentem[en]te dall'Abb[at]e D. Cristofaro Dulcetti della Città di Castrovill[ar]i L'Abbadia di S.[anta] Barbara, la qual'e prefett.[ura?] del R[ea]l G[overnatore?] D[onno] Benedetto Albarelli di Napoli

Vi posseggono ancora poche vigne alcuni del Casale di Frascinetto con qual Casale in nostro Teritorio è promiscuo, come ancora con quello della Città di Castrovill[ari] Onde in fede del vero ne abbiamo fatta la pres[ent]e sotto crocesig[nat]o di nostre proprie mani per mezzo del nostro ordinario Cancelliere, e suggellata con nostro Universal Suggillo. Porcile li 7 9.bre 1752.

+ Segno di Croce di Dom[eni]co Miraglia Sind[ac]o

+ Segno di Croce di Ludovico Scornavacca Eletto

Martino Riccio Cancell[ier]e§

Settimo Documento

Si stabilisce il valore delle cose

(p. 17 recto)

Da Noi qui sotto croce signati Sindaco, ed Eletti dell'Università di questo Casale di Porcile si fà piena fede etiam cum juram[ent]o § Qualmente havendo ben considerato la rendita che possono dare gli Animali così Bovini, Vaccine, peccorine, Capriene (sic), ed altri come ancora li prezzi de vittovagli, e musto, ci è parso stabilire li prezzi nel modo, che sigue -

Per ogni paro di Bovi all'Arato docati quattro -

Capre, e pecore p[er] ogni centinajo docati quattro -

Ogni Barile di musto grana quindici -

Per ogni t[omolat]o di grano carlini otto -

Per ogni t[omolat]o d'orzo carlini quattro -

Per ogni Becca di frutto, osia domata, osia selvaggio carlini diece -

Per ogni Giumenta carlini diece -

Per ogni Somarro carlini diece - Et in fede della verità n'abbiamo fatto fare la p[rese]nte dal nostro ordinario Cancelliere, e Munita col nostro solito Un[iver]sal suggillo. Porcile li 7 di 9.bre 1752

+ Segno di Croce di Dom[eni]co Miraglia Sindaco

+ Segno di Croce di Andrea Blajotta Capoeletto

+ Segno di Croce di Ludovico Scornavacca Eletto
Martino Riccio Cancell[ier]e§

Ottavo Documento

Si presenta l'elenco dei prezzi ai deputati ed apprezzatori
(p. 18 recto)

Essendosi stabelito che nel di 8 di questo mese di 9[vem]bre nella casa del Mag[nifi]co Domenico di Pace si uniscono i si[guien]ti Amministratori, e deputati per discuotere la fede fatta intorno alla rendita e frutto, che gli animali danno in questo Teritorio, e fissarsi il prezzo delle vittovaglie, e di altri generi. Sene porta la notizia al Sig[no]r Deputato ecclesiastico D. Salvatore di Pace, acciò voglia intervenire per dire tutto questo che li occorrerà sù questa materia in esecuzione del Concordato. Porcile li 7 9.bre 1752

Die 7 m[ensi]s 9.bris 1752 Porcili§

Per me infrasc[rit]to Cancell[ier]e oggi sud[detto] giorno si è presentata altra consimile al CI[eric]o D. Salvatore di Pace Deputato Ecclesiastico et in fede§

Martino Riccio Cancell[ier]e§

Nono Documento

I deputati formano l'elenco dei prezzi
(p. 19 recto)

Essendosi da noi infras[cri]tti Deputati Eletti in Publico Parlam[en]to dell'Università di questo Casale di Porcile in seguela de' venerati Regali ordini p[er] la formaz[i]one del Catasto del medesimo considerat la fede fatta p[er] li Mag[nifi]ci del Governo di d[ett]a Uni[versi]tà intorno la rendita e frutto che danno p[er] gli Animali, e prezzo de vettovaglie; Dopo inteso alcuni Padroni degli Animali sudetti, si viene da noj a stabilire nel modo come Siegue

Per ogni paro di Bovi Aratorij ricava il Padrone d'ogni peso di guardia ed altro Annuij Docati quattro -

Per ogni paro di vacche atti ad arere Annui Docati quattro.

Per ogni paro di vacche Armentizze Annui carlini trenta.

Per ogni cento pecore, o capre, ricava il Padrone di rendita dedotto ogni peso di guardia, Erbaggio, ed altri, Annuj docati sei -

Per ogni Giumenta franca come sopra Annuj carlini venti.

Per ogni Bagaglia atta alla fatiga, Annuj Carlini quindecim.

Per ogni tumulo di grano Annuj Carlini otto.

Per ogni tumulo d'orso Annuj Carlini quattro.

Per ogni barile di musto Annuj grana quindecim

E gli abbiamo stimato, e stabillito, siccome stimiamo e stabillimo et in fede§

Porcile 8 9.bre 1752

Io Lazzaro di Pace Deputato

Io Dom[eni]co Ferraro Deputato

Io Dom[eni]co di Pace Deputato

Io Gioseppe Ferraro Deputato

+ Segno di Croce di Fran[ces]co Lalijna Deputato

+ Segno di Croce di Luca Miranda Deputato

Martino Riccio Cancell[ier]e§

Decimo Documento

Ordine di notifica all'Erario del Possessore
(p. 20 recto)

Carolus Dei gratia Rex Utriusq[ue] Siciliae, et Hierusalem, Infans Hispaniarum, Dux Parmæ, Placentiæ, et Castri, ac Magnus Princeps Hæreditarius Hetruriæ

Servienti della Corte di questo Casale di Porcile, farete ordine al Mag[nifi]co Erario dell' Ill[ustr]e Possessore del Medesimo, acciò in ricevere la p[resen]te debba formare la rivela con giuramento, e sotto pena di falso, e delle altre Condenute nel Banno Generale da noi fatto emanare p[er] l'esibiz[i]one delle rivela, così dei Cittadini, come de' Forastieri, di tutti beni stabili così feudali, come burgenzatici, Annue entrate, cenzi, Animali ed ogni altro, che esso Ill[ustr]e Possessore in tenimento, e Territorio di questo Casale possiede, ecetto Solam[en]te j Corpi Giurisdizionali, come altresì di quej, che possiede il mede[si]mo in feudi disabitati, ed in altre Università, le quali vivono in promiscuo con questa Padria, quale rivela debba esibire tra il termine di giorni due in nostro potere, affinché da noi si possa proseguire la Confez[i]one del Catasto di questo Casale in in seguela del ordinato da S[ua] M[ajestà] (Dio Guardi). E così debba eseguirsi sotto pena d'onze d'oro vinticinque fisco Reg[gi]o § Notificatis, et referatis in forma Dato in Porcile li 8 9[ve]mbre 1752

+ Segno di Croce di Dom[eni]co Miraglia Sindaco

+ Segno di Croce di Andrea Blajotta Cap'eletto

+ Segno di Croce di Ludovico Scornavacca Eletto

Martino Riccio Cancell[iere]§

Undecimo Documento

Notifica all'Erario del Possessore
(p. 20 verso)

Eodem retros[cri]pto Die Antonious Ciliberti ordinarius serviens Curiae hujus Casalis Porcilis cum juram[en]to vetulit Mihi supscripto, notificasse retrosc[ri]ptum ordinem, omniaq[ue] in ea consenta Fran[ces]co Lalijna, Erario Ill[us]tris Possessoris Casalis prædicti personaliter § presentibus pro testibus Angiolo Fazio, et Ant[oni]o Rimula, et in fidem§ Martinus Riccio Cancell[ier]is§

Fran[ces]co Laleinna Il Casale di Porcile erario loco feudi [...] Principe di Cariati, utile Barone di d[ett]o Casale rispondendo all'ordine, fanoli notificare da' mag[nific]i deputati del general Catasto, dice, che detto suo principale come primo Cittadino della Città di Castrovillari, di cui [?.] anche l'è utile Barone, formi la sua rivela di tutt[i] j beni possiede in d[et]ta Città, e Suoi Casali di Frascineto, e Porcile, nell'atto si formò il general Catasto nell'anzidetta Città, che fù nell'Anno 1743, e no[n] sul riflesso, che avendo la Citta con j Casali già detti, una vera promiscuità, stava in Sua libertà formarlo ove le piaceva; oltre dicche atrovandosi sin da' più Anni esso Ill[ustr]e Principe Padre onesto, non deve soggiacere a' menomo pagamento di collette servata la forma delle Provisioni, spedite a Suo favore della Reg[gi]a Camera della Summaria [...?].

Variboba, një poet arbëresh çë i pëlqeu gjindjes**Italo Costante Fortino**

Univ. 'L'Orientale', Napoli, ka Shën Bendhiti (Cs)

Ish moti kur arbëresht nëng kishin adhe një skollë për ta, kur priftrat nëng kishin kurse të teoloxhisë e të liturxhiës orientale, vjen me thënë të ritit të tyre bixantin: me një fjalë katundet arbëreshë ishin të varfër nga ana ekonomike e nga ana kulturalë. Shërbesi më i rëndë, pra, ish se priftrat, çë kish të mbësojin gjindjen e kish t'i jipin istrucionën relixhoze, ishin ata vet çë nëng dijin shërbiset e qishës e nëng kishin kulturën çë duhej. Kush mund të ja jipij atyre kulturën relixhoze?

Ish sekulli XVII, kur një Bonxhinjur, çë ja thojn Laskari, kish vizitartur katundet arbëreshë e kish parë se priftrat grekë katolikë kishin një kulturë shumë të ulët, ishin vërtet injorantë e se *“meqënsë jetojin ndë mest lëtinjvet dhe ture njohur shumë pak ritet grekë, përziejin njerin me tjetrin ndë çelebraciunat e qishës e ndë meshën, kështu si ndë çelebraciunat e Sakramenteve”*.

Kolexhi Korsini i Shën Benedhitit

Ish viti 1732 e Papa Klemendi XII i familjes “Korsini” ordinoi të ndreqej një Kolexh ku mund të formarshin studentët çë kish të bëshin priftëra. Me nxistimet e Zotravet Stefan e Feliçe Samuel Rodotà Kolexhin “Korsini” e ndërtuan ndë katundin arbëresh Shën Benedhin. Nga të parët studentë të këtij Kolexhi qe një çë është i njohur me emrin Xhul Variboba, nga Mbuzati (1724/25 – 1788). Qe një student i shpejtë e sa u bë prift e bën Retur të Kolexhit Korsini, po mbeti pak mot e pra vate te katundi i tij sa te bëj priftin. Këtu hapu një storje të gjatë e të ashpër se dej se Mbuzati ka të shkoj nga riti grek tek riti latin. Me gjithë studimet çë qenë bërë njera nani – çitarinjet vetëm ata çë bënë P. Vasa e L. Mbuzati ndë vitet '60 te Arkivi i Propaganda Fides ndë Romë çë dualltin te rivista “Shêjzat”, (Roma 1960) – nëng ndiohet mirë sepse një prift arbëresh, i rritur më parë nga i Jati, prift edhe ai bixantin te katundi Mbuzati, e pra ndë Kolexhin Korsini ku qe prevesur e Retur i atij Kolexhi, mund bëri një sherrje kështu të madh, ku muartin pjesë katundarët e Mbuzatit, Sindku i katundit, n'etër prift ç'ish edhe ai nde katund, Bonxhinjuri i Rusanës, e ndë fund edhe Kongregaciuna e Propaganda Fides. Variboba kish nisur një sherrje çë ndë pak mot u bë një skandall për gjithë gjindjen, për gjindjen lëtire e për gjindjen arbëreshe. Kështu se Propaganda Fide bëri mirë e e thërriti Romë, ku shkoi pra gjithë gjellën.

Vepra e bukur “Gjella e Shën Mëris Virgjër

Variboba vërtet kur ish prift Mbuzat nëng bori motin vetëm sa të zëhej me gjindjen, me jetrin prift e me Bonxhinjurin e Rusanës, po ish i shpejt e ish i lidhur me besën e krishterë, po mësemë me espresiunat e ritit latin. E kur i mbësoj katekizmin gjindjes, shërbiset e relixhonit, ja mbësoj ture folur arbërisht e ture kënduar shumë këngë, të marra nga tradiciuna popollare arbëreshe, si janë “Kalimeret”; nga tradiciuna italiane (“Vergine bella”, “Responsorio di S. Antonio” e më të tjera), nga tradiciuna e qishës latine (“Te Deum laudamus”, “Jesu korona virginum” e më të tjera), si edhe nga tradiciuna bixantine (“Ave Maria” e mbostartur mbi struturën e “Init Akatisto”). Gjithë katekizmi çë ai bëj gjatë vitit, ish i konçentrartur ndë të ardhurit e Krishtit mbi dhë, si edhe mbi figurën e Shën Mërisë. Mund të thomi se gjithë motin çë shkoi Mbuzat si prift – përveç sherrjeve – ja dedikarti katekizmit sa të formarij krishterë me zëmër të mirë e me tru të urtë.

Ka të thom edhe se me motin edhe qisha arbëreshe, ture mos pasur një formacionë të drejtë me tradhicionën e saj bixantine, vate ture marrë nga qisha lëtire dica uzanza: statua ndë vend të ikonave, këngë popollare nga tradhiciuna lëtire, lutje të qishës lëtire e më tjera shërbise. Spiegaret kështu pse Variboba mori këngë e lutje nga qisha lëtire. Me një fjalë: qisha arbëreshe bixantine pak e pak ish e latinixohej. E ndëç nëng u

kishin ndërtuar, më parë Kolexhi Korsini Shën Benedhit ndë vitin 1732, e pra Kolexhi Gjergj Guxeta ndë Palerm ndë vitin 1734, ku seminaristët studhian liturxhinë, këngët e storjen e qishes të tradhiciunës bixantine, mund të thomi se nani gjithë katundet arbëreshë ishin gjithë të ritit latin.

Katekizmi i Varibobës, o më mirë Katekizmi i Shën Mëris

Nani me pakë fjalë ka të rrëfiejm se ç'është Katekizmi i Varibobës, o më mirë Katekizmi që i mbësoi Shën Mëria gjithë atyre që vanë t'e gjëjin kur u le Zoti Krisht. Po edhe më parë është mirë të dimë se ç'është opera që njihet si "Gjella e Shën Mëris Virgjër" e që publikarti Variboba kur e dërguan Romë, ndë ezil. Nëng kish shkuar mëngu një vit, që kur Variboba kish arvuar Romë, e publikarti Romë operën "Gjella e Shën Mëris Virgjër", që komponiret ndë tre pjesë: 1) pjesa e parë është presentaciuna që Autori bënë sa të spiegarinj se shkruajti "Gjellën" për të mirën e gjindjes; vjen me thënë për të mirën e gjithë atyre që djovasin këtë libër të vogël me divucinë; 2) pjesa e dytë është të rrëfiejturit e të ardhurit të Zotit Krisht mbi dhë: e ndë këtë të rrëfiejtur jeta e Zotit Krisht gërshetohet me jetën e së Jëmës, me Shën Mërinë; pjesa e tretë ka këngë, ato këngë që Variboba i mbësjo gjindjes kur i bëj katekizmin kur ish Mbuat. Mbrënda këtyre tre pjesave gjëjim edhe një pjesë singlar: penxoni se është "Dotrina Cristiana" që Shën Mëria i mbëson gjindjes që vate sa t'e gjëj e që priftrat pra ka t'ja mbësojin tjerëve krishterë ndë qish. Njo fjalët e Shën Mëris:

"Pero Dhotrinën se gjith mëpār

"dua ju spjegār nani arbërisht,

"si mbi dhët ndë të kërshët

"prifti t'e thët një dit mbë qisht".

Shën Mëria e dij se kjo Dotrinë ish për gjindjen arbëreshe e i jep një mesaxh edhe priftrave sepse si e tha ajo arbërisht Katekizmin edhe ata pra ka t'ja mbësojin arbërisht gjindjes. Nj'etër elemend që shëjtëron këtë uzanxë është se edhe Zoti Krisht, vjen me thënë Bombini, që u kish lerë ahierna, zu e mori vesh atë që thoj e Jëma:

"E muartin vesh, gjith mben' qet,

"puru ai vet ç'ish Zoti Krisht,

"kūr kjo Rrexhin me vuxhët fīn

"zū fill e tha kënkën arbërisht".

Autori na presendarën të rrëfiejturit e katekizmit si një poezi, vjen me thënë me rimën AABB e megjithëse Shën Mëria spjegarën konxhetet e besës me fjalë popollare, megjithatë esprimirën konxhete shumë të thella të teoloxhisë. Ruani si e thotë bukur, si e thotë të shkoqur mirë konxhetin e Trinitatës: një qirī është një, megjithëse është i bërë nga "fitili", nga "llumunera" e nga "dillët". Po më mirë është t'i lëmë fjalën Shën Mërisë që bën e e ndëlgojim mirë atë që do të thetë:

"Via dhotrinën zëm fill

"që erth Bambini të na sill,

"mb'emërit t'Et e të Birit,

"Shpirtit Shëjt puru të mirit.

"Të tre vet jan' një Zofīn

"si Vangjeli na avertīrn,

"ë Zofīn Jati e i Biri

"Shpirti Shëjt puru i miri;

"ma të tre bēnjēn një Zot

"sembre paru si jan' sot.

"Mirr për sjemp ti një qirī,

"ec e dhes e ruaj me sī:

"ë fitili, ë llumunera,

"ë dillët që pī era,

“puru ti e sheh me sī
 “një të vetëm qirī.
 “Ashtu ë Jati e i Biri,
 “Shpirti Shëjt puru i miri,
 “Jan' tre vet, ma një Zofin,
 “kë të thuash jo tre Zofin.
 “E të tre një vullundat
 “kan' një zëmër, një bondat;
 “o si thot teoloxhia
 “çë dhjivasën urtëria:
 “ndë personat Trinitat,
 “ndë sustënxjet unitat.
 “S'e ndëlgonj, ma e kam bes
 “e jam prondu edhe të vdes.

Edhe sod kjo gjuhë ndilgohet, ndiohet, kapiret sepse nëng është se Variboba nëng njihij gjuhën letrare arbëreshe, vjen me thënë gjuhën e lartë, me shumë figura retorike, me fjalë të marra nga tjerë autorë; Variboba preferirti të shkruaj “Gjellën” ndë të folurit popollar, me gjithë fjalët çë gjindja thoj nga dita, çë i vijin më façile, të marra edhe nga dialeti kalabrez o nga gjuha lëtire.

Nani na bëhet një të piejtur: pse Variboba është një nga poetët arbëreshë më të njohur edhe nga gjindja çë nëng studhjarti? Të përgjegjurit, pjesë pjesë, e thamë: 1) e para se gjuha e “Gjellës” djovaset e ndilgohet sikur se ish e shkruajtur sod; 2) e dyta pse, si na thotë jetri poet i madh Xherolam De Rada, Variboba është një poet, i lerë poet; vjen me thënë se si ai esprimirij një idhë të bukur, kjo idhë, ose më mirë kjo espresionë mirrij formën e poezisë. Ai kish venën e poezisë, kish frymën e poezisë.

Shën Mëria e dij se arbëreshët nëng e ndionin gjuhën lëtire e i mbëson “Kredhin” arbërisht (“Gjegj ti Kredhin arbërisht / xhaka s'e ndëlgon lëtisht”) ndë një manerë çë edhe gjindja çë nëng kish studjatur mund i mirrij vesh, vjen me thënë edhe gjithë ata çë ishin analfabetë, çë ishin më të shumtit, o pothuajse gjithë arbëreshët çë ishin analfabetë ndë gjuhën e tyre, pse neng dijin e e shkruajin e nëng dijin e e djovasin. Pas “Kredhit”, Shën Mëria shkon e spiegarën “Li Komandamenti”, vjen me thënë dhjetë “Komandamentet”. Vetëm si “sjemp” - si thotë Variboba – vëni re si Shën Mëria spiegarën bukur ca komandamente: “Non nominare il nome di Dio invano” / “Për zmirëndeje, si thon’, / mos e ze ti tën Zon’”; “Ricordati di santificare le feste” / “Ndë të krëmtet e të dielt / mbai trüt sembre ndër qiellt” e kështu me të tjerët.

Si kemi thënë, rrima AABB ndihën ata çë djovasin këtë Katekizëm t'e mbajin mend sepse ai na stiset ndë krie me harmonin e vjersheve e me të djovasurit çë rrjedh pa pengime. Ky i Shën Mërisë është të mbësuarit ndë manerën më të mirë, pse me pak fjalë jep mesaxhin çë ka t' mbajim mend e çë ka t' praktikojim. Shën Mëria, për sjemp, nëng kutdohet të na thetë cilat janë sakramendet, po ajo na thotë, me një fjalë, se çë vjen me thënë çdo sakramend e çë do nga na sakramendi. Ruani si sintetizon gjithë sakramendet, e të mirat çë rrjedhin nga ata: “Sakramendet jan' shtat / çë na bënëjn pā mëkat: / Pagëzimi ai na lân, / Grizma fort na mbān, / ma Kungimi na gëzon, Skomallia na shëron, / Valt e Shëjt mortën e mīr, / Priftëria na bën fanmīr. / Të mos bëç si ata ndë Pist / Matërmon la Zoti Krisht”. Më duket se kemi vënë ndë dritë shërbesin prinçipal të Dotrinës së Shën Mërisë: 1) vjenmethënie e të mbësuarit të prinçipeve të Dotrinës; 2) formën popollare të gjuhës sa t'e ndilëgojin gjithë; 3) harmoninë e gjuhës me strumendet e poezisë; 4) fjala e ngroht çë të nget zëmërën.

Ai çë djovasën këtë Katekizëm ndihet i ngār nga fjala e Shën Mërisë e ndëse më parë ish indiferent ndaj Zotit, nani i qaset e i vete pas si vete delja pas Bariut. Ky është mirakulli më i madh i “Gjellës së Shën Mërisë Virgjër”: poezia me fjalën e bukur prier zëmërën e atyre ç'e djovasin e i bën vërtet dhishipuj të Krishtit ndërmjet fjalën e bukur të Shën Mërisë.

Sa t'e fërnojim, do të ju jap të djovasni interpretaciunën çë bën Variboba me vjershat e tij të “Ave Maries”:

AVE MARIA

“Harepsu, e Sh. Mëri,
“se tën' Zon' si bër e kë me tij.
“Harepsu, oj graxje pjot,
“se ti e pate hjë më tin' Zot.
“Harepsu, o e bëkuar,
“se shkëfin tënd e pate shëjtëruar.
“Harepsu, o e pāmëkat,
“se pema e barkut it duall me urat.
“Harepsu, oj ëma shëjt,
“ma kij kuldes për mua të jëm shëjt.
“Harepsu, oj Rregjëresh,
“e ea më vizitār kūr u të vdes.
“Harepsu, o e Sh. Mëri,
“e bëm' ahiera çë të vinj me tij”.

Individualiteti krijues i Matilda Ferraro-s

prof.dr. Klara Kodra
Instituti Albanologjik, Tirana

Çdo poet ka në krijimtarinë e vet një vatër tematike që e rrezaton së brendshmi dhe krijon një formë të vetën në përputhje me individualitetin e tij krijues. Mund të thuhet se për të gjithë ka një çelës për të depërtuar në botën e tij poetike.

Poetsha arbëreshe Matilda Ferraro na e ka dhënë vetë këtë çelës në fjalët që ka thënë: *“Poezia ime frymëzohet nga jeta e bashkësisë sonë arbëreshe, nga malli për atdheun e origjinës, nga bota ime dhe nga bukuria e harmonia e natyrës”*.

Pra, një shkrimje e temave tradicionale me temat e “përjetshme”.

Matilda është nga ata poetë të sotëm arbëreshë që e kanë realizuar ëndërrën e vet për të shikuar atdheun e të parëve, Shqipërinë.

Madje mjaft vjersha të saj kanë parë dritë edhe në shtypin shqiptar, në gazetën “Drita”, në revistat “Nëntori” dhe “Shqiptarja e re”.

Tema tradicionale e atdheut të të parëve, e trashëguar nga tradita e Rilindjes është objekt frymëzimi edhe për poezinë e Matildës që i këndon Shqipërisë si të tjerët, me shumë dashuri, krenari dhe mall, po me zërin e vet, në thelb lirik, me një çiltërsi fëmije, pa rënë asnjëherë në retorizëm e deklarativizëm.

(Fluturojnë/ mendimet e mia/ në Shqipëri/ si fluturojnë zogjtë në qiell/ Kam në sytë/ dhenë e saj/ kam në zemër/ gjakun e saj. / Sa e bukur/ sa bujare,/ sa e madhe/ je, Shqipëri!)

Poezia atdhetare e Matildës i ngjan një dialogu, dialogu me nënën e një bije që është larg, po që ruan të paprekura dashurinë e mallin.

Edhe figurën e Heroit Kombëtar, Skënderbeut, Matilda e vizaton në mënyrën e vet duke poetizuar një fakt real, ngritjen e bustit të heroit në fshatin e saj (Shënkoll i Katanxaros) dhe duke e shkrirë në mendimet dhe ndjenjat e veta si poeteshë lirike

(“Në vështrimin e tij krenar/ krenarinë e gjithë shqiptarëve/ unë shoh./ Në fitoret e tij / besimin e shqiptarëve ndiej./ një besim të patundur/ që përballon kohën e hapësirën”.

Poezia e Matildës është në dukje tepër e thjeshtë dhe ndofta është pikërisht kjo veti, thjeshtësia, po edhe çiltërsia e thellë që e bën këtë poezi të komunikojë me lexuesin dhe përbën magjinë e brendshme të saj. Poezitë janë në përgjithësi të shkurtra në ngjashmëri me vargun që është i shkurtër, dinamik, ndërsa fjala është e qëmtuar me kujdes prej autores, jep përshtypjen e spontanitetit, të të shkruarit në vrullin e parë të frymëzimit, po, e parë më me kujdes, vendosja e goditur e këtyre fjalëve dëshmon për një lëmim të vargut. Në thelb të poezisë së Matildës qëndron optimizmi, besimi te jeta dhe te njeriu (a s’thoshte dikur De Rada se poezia është e mirë kur ka një pikëz diell? Matilda e ka ruajtur këtë “pikëz”, duke mbrojtur nga mjegulla e antivlerave dhe pesimizmit të skajshëm) si edhe aspirata fisnike për liri e dinjitet njerëzor.

Natyra meditative është tipar i poezisë së saj, thjeshtësia e dukjes fsheh një thellësi mendimi të brendshme ashtu si uji i kthjellët i liqenit fsheh thellësinë.

Në lirikën e dashurisë Matilda është e ëmbël dhe spontane, si një adoleshente.

Matilda parapëlqen lirikën e pejsazhit dhe lirikën e saj të këtij lloji janë akuarele plot dritë ku njeriu identifikohet me natyrën. (“Plazhi i vetmuar”, “Meditime në fushë”, “Gjethja” etj.).

Autorja shpreh dhe kredon e vet poetike në mënyrë të drejtpërdrejtë të poezitë “Poezia ime” dhe “Vetvetes”. Në këtë të fundit, poetsha si dikur Serembeja, e vizaton portretin e vet. Në këtë autoportret tregohet koncize dhe objektive.

Në gamën e pasur të ndjenjave të lirikës së saj nuk mungojnë trishtimi dhe ndjenja e vetmisë që burojnë nga kontradiktat e jetës, po ato nuk shndërrohen në pesimizëm si te ndonjë poet tjetër bashkëkohës.

Një pastërti fëmijore e ndërthurur me meditime të thella: ja, poezia e Matilde Ferraros.

'Telet e zëmrës', kumte poetike nga Arbëria**dr. Ina Arapi**

lektore në Universitetin e Vienës

Vëllimi i fundit poetik i poetit Augustin Xhordano *Telet e zemrës*, që u botua vitin e shkuar në Prishtinë, i vjen lexuesit shqiptar nga bota arbëreshe, një botë me të cilën raportet tona njerëzore, shoqërore e kulturore pas rënies së diktaturës komuniste në Shqipëri u ripërtërinë e u gjallëruan. Në këtë proces luajtën rol jo vetëm marrëdhëniet krejt të reja që u vendosën midis vendeve evropiane pas kthesës së madhe politike në vitet '90 të shekullit që kaloi, por edhe lindja e përhapja e mjeteve masive të komunikimit publik si interneti e E-maili, që mundësojnë kontakte të vazhdueshme dhe shkëmbimin e mesazheve, me anë të të cilave jemi pothuajse gjithmonë atje ku zhvillohen ngjarjet. Në këtë mënyrë edhe Arbëria, nga një botë e pakapshme për të cilën mësonim vetëm në faqet e librave shkollorë apo tek tuk edhe nga ndonjë botim a shkrim në gazetë, u kthye për shqiptarët ballkanikë në një botë reale, të prekshme, në një pjesë të botës së përgjithshme shqiptare me të cilën mund të japim e të marrim si të dëshirojmë.

Vetë autori, Augustin Xhordano, që në fushën e letrave njihet më tepër me pseudonimin Buzëdhelprri, është një personalitet kompleks me shumë kontribute në jetën kulturore e shoqërore të Arbërisë. Pikërisht nëpërmjet internetit jam njohur fillimisht me revistën *Jeta Arbëreshe*, të cilën ai e nxjerr prej shumë vitesh, revistë që e lexoj me ëndje e interes për shumë arsye: në radhë të parë për informacionet e shumta që sjell prej kësaj pjese të universit shqiptar, të shkrimeve me karakter studimor për botën, gjuhën dhe letërsinë arbëreshe e shqiptare, si dhe për gjuhën që përdor, gjuhën e katundeve arbëreshe, çka e bën këtë revistë një fenomen gjuhësor unik në lëmin e letrave shqipe, pasi të gjitha organet e tjera të shtypit që dalin kudo në botë në gjuhën shqipe shkruhen pa përjashtim në gjuhën letrare. Prandaj, me anë të kësaj reviste drejtori Augustin Xhordano i bën një shërbim të pashembullt jo vetëm arbërishtes, por edhe vetë shqipes moderne duke ia mbajtur të gjalla rrënjët e burimit dhe duke na risjellë vazhdimisht e me një këmbëngulje të pakrahasueshme para syve brumin autentik e gjenuin të saj, si ushqimin më të mirë për ta mbajtur të shëndetshme e të freskët këtë gjuhë në një kohë kur presioni i gjuhëve të tjera të mëdha është tepër i madh.

Për lexuesin e rregullt të *Jetës Arbëreshe* është interesant fakti që drejtorin e saj, të cilin prej revistës e njeh si një individ jashtëzakonisht të angazhuar, nëpërmjet krijimtarisë poetike e përjeton si një poet të mirëfilltë, me një botë shpirtërore shumë të ndjeshme, duke zbuluar kështu dhe anën tjetër të medaljes. Megjithatë, është e qartë se në fillim ishte poezia. Përmbledhjen e parë *Hroaza* autori e botoi kur ishte 21 vjeç, çka na bën të mos i shpëtojmë krahasimit klasik me De Radën, i cili e shkroi veprën e tij më të njohur, *Këngët e Milosaos*, në të njëjtën moshë. Edhe në një mesazh të dërguar para disa ditësh autori më dëshmon "se këto "botime të mi poezish ose tufash poezish" mbi revistat shqiptare kane filluar heret, çë në vitet '70: aq në Maqedoni sa në Kosovë e në Shqipëri" (2. 6. 2014).

1. Një vëllim poetik për dashurinë njerëzore dhe mallin

Përmbledhja *Telet e zëmrës* përmban 85 poezi, 10 prej çdo vëllimi të mëparshëm (*Hroaza*, Castrovillari 1971, *Hapa mbi kalldrëm*, Shkup 1976, *Bota Arbëreshe*, Tiranë 1997) dhe 50 krijime të reja. Ideja dhe ndjenja bazë mbi të cilën është ngritur kjo përmbledhje është ajo e dashurisë; e dashurisë për qenien njerëzore, për njeriun arbëresh dhe shqiptar, për universin, për botën shqiptare, për katundin arbëresh, për prindërit, për fëmijët, për gruan. Që në titull na tërhiqet vëmendja se bëhet fjalë për një poezi që del nga zemra dhe prek telat e saj. Pikërisht nëpërmjet kësaj ndjenje supreme njerëzore përshkruhet bota që e rrethon autorin, që është bota tradicionale e njeriut shqiptar, në të cilën familja, dashuria dhe respekti për prindërit e të parët zë vendin kryesor. Kësaj teme i kushtohet edhe një cikël i veçantë, cikli *Sytë e prindëve* (fq. 100-109), që përmban disa lirika të mrekullueshme për dashurinë prindërore dhe hapet me poezinë 'Atit tim': *Ti je tata im / e u te zëmra jote / kam rrënjët e menatës*, thotë poeti. Nga këto vargje kuptojmë se çfarë përfaqëson familja për poetin: jo vetëm ngrohtësinë e nënës që e rrit e e burrëron djalin, jo vetëm sytë e atit që shkëlqejnë me ëmbëlsi dhe i

qëndrojnë pranë e i japin forcë birit në çdo moment të jetës, por edhe vazhdimësinë e vetë jetës, tharmin e së ardhmes. Një botë harmonike kjo që e gjen forcën e saj në trinomin ati – biri – nipi, çka shprehet më së miri në figurën e plakut që i shtrin duart nipit që do të lozë. Mos ndoshta te ky ligj ekzistencial duhet kërkuar edhe sekreti i ruajtjes së qenësisë gjuhësore e kulturore arbëreshe?

Te poezitë *Tatës tim* (44) dhe *Për vëllezërit shqiptarë* (46) dashuria ndaj prindërve merr karakterin e një kulturi. Por kjo dashuri do të ishte e vetmuar sikur të mos shoqërohej nga dashuria për njerëzit e tjerë, për bashkëfshatarët, për pleqtë, për të varfërin - të nëmurin a murgun në të folurën e autorit (*Lotët e të nëmurit*, 38, *Do të priresh edhe sonde*, 39, *Përpara pengores së varfërisë*, 43), delarin “barium” që ndodhet jashtë në erë e shi, për lypësin e mjerë.

Brenda dashurisë që e përshkon si fill i kuq jetën e autorit një vend të veçantë zë dashuria për gruan. Për këtë të fundit ai përdor fjalën e hershme shqipe mall, si në titullin e poezisë *Lerja e mallit* (fq. 55), të cilin Xhordano e “përkthen” në shqipen letrare me “Lindja e dashurisë”. Është një fjalë që e lidh autorin me folklorin arbëresh-shqiptar dhe veprat e parardhësve të tij, duke filluar që nga De Rada (Ja, si bregu i braktisur /gjembave e thellëzave, /ku vinë e ndërtojnë njerzit /një katund plot hijeshi /te luginat gjelbërore, /është malli i trimave - Këngët e Milosaos, XI) e deri te Lasgush Poradeci (Dh’aher’ i dehur prej durimit /Në mall të madh të këngës sate - Naimit).

Fjala mall ka njëkohësisht edhe kuptimin “e dashur”, si në poezinë e parë *Natën* që hap vëllimin, poezi për një dashuri që s’mund të realizohet dhe jeton vetëm në nënndërgjegje: *Natën, /mall, /të gjënj në shtegun e ëndrravet /Ditën /të bier ndë mes t’gjindëve ‘ paëmër* (fq. 13). Fjala përcakton një gjendje të veçantë emocionale, një ndjenjë specifike të lindur në rrethanat tipike ballkanike, të cilën gjyshstërgjyshërit e sollën me vete në atdheun e ri. Kjo fjalë përdoret me të njëjtin konotacion edhe në rumanishten dhe është një element i botës sonë shpirtërore që na bashkon me këtë popull tjetër ballkanik.

Dashuria përfaqëson për poetin strumbullarin e jetës. Prandaj dhe thirrja e tij është “Dashuro!”. Ja si e shpreh këtë ide në poezinë ‘Dashuro, more vëlla’: *Dashurò, more vëlla /E mbrëmanet /kur shuan zjarrin e vatrës /kamnuan s’do t’ e mallkosh /tym in e helmet e ditës do t’ i harrosh /si trim/ ç’ s’ i trëmbet më ulkut* (fq. 101).

Dashurisë i kushtohet cikli me 12 vjersha *Në tregun e gazevet* (49-60) në kapitullin Telet e zëmrës. Në poezinë *Vashës sime përshkruhet me mjeshtëri marrëdhënia midis dy të dashuruarve: Më pëlqen ngaherë edhe kur thua se s’je e bukur /Të kuptonj ngaherë edhe kur t’duket se s’të gjegjënj /Të vërenj ngaherë /edhe kur thua se ruanj gjetkë /Mos ki besë se është le për mua /kur të lë me një “T’dua mirë!”*. Shumë e gjetur nga ana psikologjike është edhe poezia *Qetësia ime, mëria jote* (60). Në poezinë *Poëtit* (58) shprehet dashuria dhe mirënjohja për bashkëshorten që i qëndron pranë dhe e frymëzon gjatë procesit krijues.

2. Katundi, qendra e jetës

Në vëllim gjëjmë poezi të arritura lirike që përshkruajnë natyrën dhe jetën e fshatit në një mënyrë të re. Kështu, Giordano i këndon borës e shiut me një gjendje të trazuar shpirtërore që lëkundet midis qetësisë, shqetësimit, meditimit e gëzimit, si te *Pika shiu* (108), në të cilën rrëketë e shiut në xhamin e dritares i krahason me autostradat ku ecin fantazitë e të birit, e të riut në kulmin e jetës.

Një vend të rëndësishëm zë jeta shoqërore e katundit. Në ciklin *Sheshi i heronjvet* (61-72), po ashtu me 12 vjersha, trajtohet sidomos tema sociale e përqëndruar rreth figurës së të varfërit dhe lypësit, por ka dhe poezi që na tregojnë për jetën e katundit arbëresh me melankolinë e natës, marrëdhëniet njerëzore (*I dashuri i reshtur*, 72) apo dhimbjen e madhe për vdekjen e kisharit, këtij personazhi simbol për shumë fshatra arbëreshe, ku identiteti fetar është një element me shumë rëndësi i identitetit kulturor. Por autori nuk qëndron këtu. Si një krijues i angazhuar ai nuk ka sesi të mos e shfaqë shqetësimin dhe dhimbjen e tij të thellë për vëllezërit e përtej detit dhe plagët e tyre në kohën tonë, siç e shohim te poema *Nata e Kosovës*, që shënon nga pikëpamja ideore dhe emocionale kulmin e të gjithë vëllimit.

3. Poezitë meditative-filozofike

Vëllimi përmban një numër të konsiderueshëm poezish të bazuara në meditime e përsiatje filozofike. Dua të përmend sidomos vjershat *E shkoi edhe sonde*, *Bie borë*, *Shkuan shumë vjet*, *Eja e m’gjëj*, *Sonde*, *Të taksënj*,

Mos u ngur, Somenatë, Udha, të gjitha nga vëllimi i parë poetik i autorit botuar kur ai ishte vetëm 21 vjeç. Mes tyre ia vlen të veçohet poezia ende shumë aktuale *Mos u ngur*, një protestë ndaj mënyrës së jetesës së njeriut modern që vetëm vrapon. Këto krijime, bashkë me ato më të reja, si *Qetësia ime, mëria jote* (60) vërtetojnë konkluzionin e nxjerrë nga Elsie (1997 : 472) se “letërsia e sotme arbëreshe është fuqizuar dhe ka hyrë në shtratin e kulturës bashkëkohëse perëndimore. Ajo e ka kapërcyer mjaft karakterin provincial tipik për shumë letërsi të vogla e kryesisht fshatare”. Më poshtë, ai i cilëson poezitë e Augustin Xhordanos si “poezi të shquara” (Elsie 1997: 476).

4. Gjuha

Duke qenë e shkruar në një varietet të rrallë të shqipes, vepra e Xhordanos ka rëndësi të madhe edhe nga ana gjuhësore. Fjalë si *menatë, somenatë, suvalë* “valë”, *le* “lehtë” apo trajta dialektore *ulk* e identifikojnë menjëherë tekstin si tekst arbëresh. Edhe mutacione të tilla semantike, si *i nëmur* ose *murg* për të varfërin.

Vetë autori na sqaron se ka filluar të botojë poezi në fund të viteve '60 të shekullit të shkruar në arbërisht, më vonë në shqipen moderne dhe pas kësaj përsëri në një formë standarde të arbërishtes të përpunuar sidomos nga i ungji, papas Emanuele Xhordano (Giordano 2010: 122-3). Sigurisht që rreth kësaj zgjidhjeje të autorit mund të diskutohet shumë dhe në shumë plane, por personalisht më duket një gjetje e goditur. Së pari, sepse duke qenë arbëresh ndjenjat e mendimet mund t'i përcjellë më së miri në gjuhën e nënës. Së dyti, sepse nuk është thjesht gjuha e katundit, por një formë standard që e kuptojnë edhe të tjerë. Së treti, sepse kështu i bën mirë shqipes, duke ia pasuruar format dhe shprehjet. Dhe nuk është e vështirë për t'u kuptuar, duhet fare pak mundim për ta marrë vesh si funksionon. Vetë i kam lexuar me shumë ëndje poezitë e Xhordanos dhe, siç e kam shprehur edhe njëherë tjetër në revistën *Jeta Arbëreshe* para shumë vitesh, mendoj se është e domosdoshme që disa fjalë e struktura të arbërishtes t'i mësohen nxënësit shqipfolës që në shkollë, me qëllim që në të ardhmen të ketë mundësi ta shijojë edhe këtë pjesë shumë interesante dhe të bukur të letërsisë sonë kombëtare.

Literatura:

Buzëdhelpr (Agostino Giordano). 2013. Telet e zemrës. Poezi. Prishtinë. Shtëpia Botuese “Faik Konica”.
 Elsie, Robert. 1997. Histori e letërsisë shqiptare. Tiranë-Pejë. Shtëpia Botuese “Dukagjini”.
 Giordano, Agostino. 2010. Prirje për një farë standardizimi të arbërishtes: kontributi i Emanuele Giordano-s. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29 /1. Prishtinë. Fq. 119-125.

Përmbledhje

Vëllimi i fundit poetik i Buzëdhelprit Telet e zemrës, botuar vitin e shkruar në Prishtinë, shënon një sukses të ri për letërsinë arbëreshe dhe atë shqiptare në përgjithësi. Në këtë artikull analizohen disa nga temat kryesore që trajtohen në këtë vëllim, të cilat e njohin lexuesin shqiptar të përtej detit me jetën e katundit arbëresh dhe njerëzve të tij. Interes të veçantë për autoren e shkrimit paraqet gjuha që përdor autori, një formë standarde e arbërishtes. Kjo formë përbën një pasurim të shqipes në përgjithësi dhe autorja e shkrimit këmbëngul që disa struktura bazë të kësaj forme t'u bëhen të njohura nxënësve në të gjitha trojet shqiptare që në shkollë në mënyrë që në të ardhmen ata të kenë mundësi ta shfrytëzojnë këtë burim të pasurimit të gjuhës së tyre dhe të shijojnë edhe këtë pjesë të letërsisë së tyre kombëtare.

Buzëdhelprë, poet i narracionit lirik

Dr. Alisa Velaj & Dr. Helena Grillo

Universiteti i Durrësit

Poeti arbëresh Buzëdhelprë/Agostino Giordano vjen në fushën e lirikës me veprën "Telet e zemrës". Duke u mbështetur në thënie të autorit për poezitë: *disave i ndërrova pak tekstin, disave i ndërrova formën e gjuhës; disave, i lë tekst e formë origjinalë*, kuptohet se poeti gdhend fjalën dhe vepra është produkt i një pune relativisht të gjatë e të lodhshme dhe lexuesve u vjen një poezi e përpunuar si nga ana skrukturore, ashtu dhe gjuhësore, përpos faktit se Agostino Giordano me vetëdije ka përzgjedhur të bashkojë zemra të ndara të Shqipërisë etnike duke lëvruar varietetin e shqipes së sotme standarde e varietete të të folmeve arbëreshe (ligjërim gojor dhe i shkruar). Rëndësia e veprës nuk është vetëm letrare, por dhe gjuhësore, sidomos në disiplina të historisë së gjuhës shqipe e dialektologji.

Në komunikimin letrar sipas parimit të ambiguitetit e polisemisë, mundësia për t'u kuptuar dhe interpretuar në mënyra të ndryshme nga marrësit (lexuesit dhe studiuesit), të cilët mund të nxjerrin interpretime ose "receptime" të ndryshme, barabar të ligjshme dhe, të gjejnë vështirësi pak a shumë të mëdha në kodifikimin e mesazhit u lë vend interpretimeve të ndryshme nga yni.

Poezia e *narracionit* lirik, si një nga dimensionet e lirikës moderne, zë fill me poetin austriak Georg Trakli. Në shprehjen e tij poetike gjejmë vazhdimisht kontrastin ndërmjet kuptimit të parë të fjalës dhe domethënies së saj kontekstuale (e jashtme /e brendshme), me të cilin krijohen zona hijeje që ndërpresin rrjedhën e mendimit. Nje teknikë e tillë organizuese në lirikë sjell devijimin e tipit të ligjërimit poetik, nga "vizioni" tek "narracioni".¹

Në traditën e poezisë shqipe kjo lloj lirike është lëvruar pak dhe nuk ka arritur të krijojë një profil të vetin, pasi lirika jonë ka anuar më së shpeshti nga subjektivizmi thellësisht denotativ. Poeti arbëresh Agostino Giordano i ka lëvruar me sukses të dy llojet e lirikës, por objekt të këtij shkrimi do të jenë poezitë e llojit të lirikës moderne, ku ai na paraqitet si një poet fin. Poezi të tilla si: "Natën", "Sonde", "Të taksën", "Udha", "Dishërimi", "Nesër niset treni im", "Do të priresh edhe sonte", "Në tregun e gazevet", "Sot vjershet e mi", "Nata e ikjes", "Vasillikoi i gazit", "Bukurisë", "Valle e lashtë", "Ajri i regjistroi zërat e mi", "Ëndrrat e jeta" dhe "Pika shiu" janë lirika të denja për çdo antologji të lirikës moderne shqipe dhe më gjërë. Rjedha e mendimit nëpër të gjitha këto lirika krijon herë zona hijeje e herë zona drite, të cilat vijnë në formën e rathëve koncentrikë, ku zonat e dritës brendashkruajnë më së shpeshti ato të hijes. Mirëpo duhet thënë se poeti e nis trajektoren e tij nga zonat e hijes, aty ku *shqetësimi përftohet nga ngulmimi në detaje të kulluara realiste*.²

"Sonde

të dërgonj një lule,

bujk

Mos më pyej "si më njeh"

Mblodha shërtimet e tu

e i vlova nën kuponjën e madhe"

Poeti di të luajë me kuptimet e fjalëve duke mos qenë aq i lehtë e fluturak (bujku me shërtimet e tij, një lule dhe kuponja e lisit), di të përzgjedhë fluturimin sipas parimeve të Italo Kalvinos. *Sipas parimit të dukshmërisë së Kalvinos janë imazhet pamore që celin në mendje duke lindur në cilësinë e shtysave nistore procese të krijimit letrar dhe shkrimit, si në kuptimin e imazheve, ashtu dhe të një teksti të shkruar*. (Detajet jetësore në këto vargje nuk lënë kurrfarë "dyshimi surrealist"). Mes tri detajeve frymon një e panjohur (*Mos më pyej "si më njeh"*). Vizioni i qartë i lë vendin narracionit abstrakt, asaj pamje tanimë aspak të tejshme, të cilën s'mund ta qartësojë asesi lirika thellësisht denotative, ose ndryshe lirika tradicionale. Kjo e panjohur vjen në krejt opusin poetik të lartpërmendur dhe mëton në thelb tek e njëjta enigmë. Trajektorja e enigmave

të tilla si; kuponja e madhe, deti, nata pa hënë, darka, menata, ëndë që s'flet në shesh, hjeja, treni, lëmosha e pakët, muri i shurdhërisë, nata e sprasme e verës, dita e prëhjes, flutur e lodhët, çaste thatësie të madhe dhe pika shiu, mëton tek e njëta hijë - mungesa e gazit. *Posi një Gilgamesh Buzëdheltri kërkon vasilikoin e gazit*³ dhe gjetja e këtij gazi sjell fytyrimin, përndrit natën, menatën, përjetësinë e valles së pashkëvë, natën e sprasme të verës nuk e gdhin në vjeshtë, por në pranverë e kështu me rradhë, dashurisë i rikthen tingujt duke shkuar kështu drejt trajektores së dritës.

Koncepti i gjithëkohësisë vjen si përditshmëri e përgjithësim i dalë prej saj:

...E shkoi edhe sonde/ si dje/ si ngaherë. Gjuhësisht kjo përditshmëri vjen mes përdorimit të detajit jetësor (udha, gurët, tryeza) madje pa asnjë figurë stilistike, nga pikëpamja e formimit fjalë të parme që e kapërcejnë vlerën e krijimit të imazhit artistik.

Më le si m'gjetë – vargu duket se është ulur këmbëkryq e sjell përvojën e gjithë brezave, si në rrëfenjat e gjyshes. Agostino krijon poezi me 5 fjalë : *Duar të ndëjtura/ thërresin/ urin e bilvet.* Poeti gdhend jo vetëm fjalën, por provon se është arti i të shkruarit që e bën poetin të ndryshëm nga të tjerët. Ai krijon përfytyrimin poetik të pamjeve mes detajit (pamor): *Sy të mbjakur nga qarja/ vlojnë të pangarë nderën/ e së parës lëmoshë.*

Në këtë grup lirikash përshkrimi, në dallim nga dy grupet e tjera ku krijon vetëm narrativën e unit, krijon edhe narrativën e një hapësire përtej vetes, ku surrelizmi tokësor, shndërrohet në surrelizëm qiellor, ndaj edhe gazi këtu është më fluid dhe me laryshi jete e drite. Realiteti këtu nuk rilind vetëm veten, por shumëfishon disa realitete paralele, të cilat hap pas hapi, ashtu si rathët koncentrikë, përpiqen të njësohen me diellin alegorik. Ky diell alegorik është gazi i dashurisë në të tri dimensionet e saj; *gaz erotik, gaz përjetësie dhe gaz lashtësie.* Në të tre rastet është domethënia kontekstuale e fjalës ajo që ka shpënë në udhëtimin drejt njohjes. Gazi erotik është më lehtësisht i dekodifikueshmi, e pas tij vjen gazi i lashtësisë, si simbol mbijetese, valleje arbëreshe që sfidon harresën e shekujve e rilind pambarimisht një etni.

Sipas kuptimeve të fjalës DIELL,- LLI m.

1. Trup i zjarrtë qiellor që gjendet në qendër të sistemit tonë planetar dhe që është burim drite dhe ngrohtësie;
2. Vend që e rrahin rrezet e këtij trupi qiellor; kund. Hije;
3. fig. Dicka që është burim jetë, përparimi, lumturie etj...;
4. përd, mb. Fig. Shumë i bukur që ndrin i tëri;

konstatojmë se poeti ndërkeqmben kuptimet konkrete me të figurshme duke krijuar diellin poetik që dinë të krijojnë vetëm poetët. Në të kundërt detajet surreale të gazit të përjetësisë kërkojnë më tepër vështirësi, për një kapërcim nga zonat e hijes në zonat me diell. Këtu është e nevojshme “ecja e ngadaltë”.

Simbolika biblike ngjiz poezi të tilla si; “Bie borë”, “Somenatë”, “Menatë e” njetër ditë”, “Ndaje bukën tënde”, “Predikime”, “Vdiq kishari i katundit” dhe “Çastet e mallit”. Narrativja poetike prodhon kështu derivate sa lirike, po aq edhe epike, ku çdo *pse* prodhon një *sepse* dhe çdo *sepse* lind një tjetër *pse*. Kjo është pika kyçe ku autori jo vetëm që shndërrohet në një Gilgamesh, por i duhet të bëhet njëkohshëm heroi dhe treguesi i bëmës së tij më të madhe, vjedhjes së rrembave nga kopshti i diellit. Këtu perëndesha e dashurisë dhe dashuria e perëndishme shkrihen në një të vetme, duke fshehur në shtresa thellësisht nëntokësore, gjenezën e një miti jo vetëm biblik. Është ndoshta kjo hapësira kur njeriu shndërrohet në një tjetër Njeri, ku heroi brenda burrit e ndërron këtë të fundit në një burrë-hero.

“Gënjimet

një e një

shqiten

ka hjea e helmit tim”

Somenatë

jam një burrë i ndërruar”.

Paralelisht interpretimeve të mësipërme vjen gjuha, (instiktive e rrënjësor, apo e stisur në ndihmë të lidhjeve të zemrës së munguar) që thellon shtresat nëntokësore dhe lidh pazgjidhshmërisht varietetet e shqipes së vjetër arkaike. Shqiptim i fjalës *híe* si [hjë] haset edhe në labërishte, çamërishte dhe në Horën e

Arbëreshëve të Sicilisë. Në këtë fjalë theksi lëviz mbi elementin e dytë të togut zanor, kurse *i*, që mbetet jashtë theksit shqiptohet si *j*, me një frymëtim të fortë. Giordano ka gjetur fillin e pakëputur, për të cilin Kostallari shpreh: *ka mbetur i pakëputur një fill që e ka ruajtur të gjallë lidhjen e breznive e të epokave, vetëdijen e kombësisë e të kombit. Ky fill është gjuha jonë amtare*.⁴

Poeti krijon shumëllojshmëri mendimesh e interpretimesh letrare e gjuhësore.

Agostino Giordano parapëlqen ndërtime sintagmatike: *në shtegun e ëndrravet, një gaz vashje, një natë pa hënë, vajtimit të mbrëmjes, lotë bujku, trëmbësinë e menatës, vitet e trimërisë, shijen e shtjerrit, lotët e jetës, mbi drizat e menatës, hekuret e gjakut, kopshti i puthjvet, shpresën e agimit, castet e mallit, përrallën e voresë, në tregun e gazevet, pengores së varfërisë, veshjen e bëgatërisë, mbi murin e shurdhërisë, rugat e zemrës, jehona predikimesh, mumbakun e ëndrrës, buzët e mërgimit, sheshe lulëbardhash, librin e qetësiravet.*

Nga pikëpamja gjuhësore me interes janë format e vjetra të gjinore/dhanore/rrjedhores shumë të formuara me mbaresën e pazgjeruar -e: *miqet* (miqve), *krushqet* (krushqve), *pleqet* (pleqve), *ullije* (ullinjve) etj., ndërkohë që emrat tema e shumësit e të cilëve mbaron me zanore, marrin mbaresën -ve, si në mbarë shqipen: *lisavet, kalavet, burgjvet, maçevet* etj.

Si gjuhëtar dhe poet, Buzëdhëlpri sjell kontribut të vyer në pasurimin e leksikut të gjuhës së poezisë dhe varietetit të gjuhës së shkruar kur rimerr fjalë të bukura, që kanë qenë krijuar në epoka të mëparshme por që, për arsye të ndryshme, nuk kanë gjetur përdorim e kanë mbetur mënjane. Me disa prej tyre ai krijon grup sintagmatik si: *një gaz vashje, trëmbësinë e menatës, shijen e shtjerrit, mbi drizat e menatës, përrallën e voresë, mumbakun e ëndrrës* duke i rikthyer në leksikon aktiv të shqipes. Poeti ndërkëmben fjalë nga një varietet në tjetrin, e nuk lë në harresë gjuhën e popullit. Dritëro Agolli pohon se *shkrimtari gjuhën duhet ta mbajë me lëng si një pjeshkë. Lëngu vjen nga gjuha e popullit.*

Poeti di të ndërkëmbejë në gjuhën e poezisë dhe format arkaike të shumësit si: *ëndrravet, liveret, rrusht, miqvet, gënjimet, hekuret, puthjvet, gazevet, lotëvet, mëmavet, rugat, lulediellat, nusevet, bilvet, këmborëvet, hapavet, mbrëmanet, të cilat shpesh krijojnë dhe ritmet e brendshme të vargjeve. Me interes në fushën e dialektologjisë do të ishte pasqyrimi i një fjalorthi dialektor të fjalëve nga varieteti arbëresh në poezinë e Agostino Giordanos, që e tejkalon qëllimin e këtij punimi.*

Shënime:

- 1) Georg Trakli, Poezia nën shenjën e ankthit, në Rrugëtim në letërsinë e unit në krizë, Leksione për letërsinë e huaj të shekullit të njëzetë, Pj. 1, Përgatiti Natasha Lushaj, Shtëpia botuese "Albas", Tiranë 2009, f.122;
- 2) Po aty;
- 3) Kujtim Rrahmani, Parathënie mbi Telet e zemrës, f. 9, Faik Konica, Prishtinë 2013.
- 4) A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe drejtshkrimi i saj, Tiranë 1973, f. 6. nime

Bibliografia

- Georg Trakli, Poezia nën shenjën e ankthit, në Rrugëtim në letërsinë e unit në krizë, Leksione për letërsinë e huaj të shekullit të njëzetë, Pj. 1, Përgatiti Natasha Lushaj, Shtëpia botuese "Albas", Tiranë 2009.
- Kujtim Rrahmani, Parathënie mbi Telet e zemrës, Faik Konica, Prishtinë 2013.
- A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe dhe drejtshkrimi i saj, Tiranë 1973.

Gjuha shqipe në vargjet e poetëve klasikë të Rilindjes

dr. Greta Jani

pedagoge e gjuhës shqipe në Univ. e Durrësit

Poezia ishte lloji letrar më i lëvruar në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Brenda dhe jashtë kufijëve të Shqipërisë poetët kërkojnë të përcjellin me çdo kusht mesazhet që lidhen me rilindjen e shpirtit njerëzor, rilindjen e njeriut të ri që çmon jetën, paqen, dashurinë në të gjitha dimensionet e saj. I tillë ishte De Rada, i tillë ishte Çajupi që, edhe pse larg nga njëri-tjetri synojnë të shprehin idetë e tyre me vargje të mrekullueshme në gjuhën shqipe. Të dy këta poetë kontribuan që gjuha shqipe të pastrohej e pasurohej për të qenë një gjuhë e denjë në shprehjen e gjithë ndjesive të shpirtit njerëzor. Ligjërimi poetik i tyre në këtë kohë dëshmon për një gjuhë të pasur në mjete shprehëse e figura stilistike. Megjithë disa luhatje te De Rada vërehen përpjekje për të qenë konsekuent në lëvrimin e përsosjen më tej të gjuhës me qëllim që ndikimi te bashkëkohësit e tij të ishte shumëplanësh.

Duke e lexuar De Radën në gjuhën e dashur arbëreshe, populli do të pasurohej shpirtërisht dhe personazhe të tillë, si: Milosao, Serafina, Skënderbeu do të shërbenin si modele frymëzimi që do të nxisnin e ushqenin vazhdimisht vetëdijen për përkatësinë e tyre etnike, dashurinë për atdheun të Parëve, që ishte dhe misioni më i madh i De Radës si rilindas. Ky pionier i letërsisë laike shqiptare të romantizmit, rreth tridhjetë vjet pas botimit të “Milosaos” arriti në përfundimin se në kushtet e rënda, kur Shqipëria lëngonte nën zgjedhën e huaj dhe populli shqiptar nuk kishte mundësi ta lëvronte lirisht gjuhën e letërsinë e vet, ishte detyra e ngulmimeve arbëreshe të Italisë të krijojnë një gjuhë letrare dhe t’ia jepnin këtë atdheut-mëmë¹. Ai ishte njeri i Rilindjes dhe Rilindja Shqiptare bashkonte në vetvete idealet politike qytetare të rilindjes së kombit dhe idealet humane të rilindjes së njeriut. Rilindja e kombit dhe liria e kombit në mendimin e De Radës dhe Çajupit është e lidhur me rilindjen e njeriut e me lirinë e njeriut, me zgjimin e pasurimin e tij mendor e shpirtëror, me përsosjen e tij morale. Në këtë vështrim përjetimet lirike të De Radës dhe Çajupi, të shprehura në “Këngët e Milosaos” dhe vjershat e “Baba Tomorrit” synojnë të afirmojnë një botë të re ndjenjash njerëzore, aspiratën e poetëve për emancipimin e njeriut dhe për pohimin e individualitetit e të personalitetit të tij. Këto motive i sollën një risi e një pasuri artistike të panjohur më parë poezisë shqipe. De Rada e Çajupi mbetën shembujt klasik të poetëve që shprehën shpirtin e popullit me një gjuhë poetike të thjeshtë e të drejtpërdrejtë, por shprehëse dhe të freskët.

Duke studiuar me kujdes gjuhën e poetëve të rilindjes vihet re se ata kanë një tipar të veçantë, ndjenjën e masës, në vargjet e tyre përftohet elipsa që u jep vargjeve hijeshi e gjallëri. Çajupi shprehet: *Malet me gurë,/fushat me bar shumë,/arat me grurë, më tutje një lumë.; Pika-pika bie shiu/dhe dëbora flokë-flokë./vetëtin e fryn veriu,/breshëri kërcet mbi tokë; Mor zot, pse dëm fjalët?* etj.

Fenomeni i elipsës është i natyrshëm, ose më mirë të themi, i rregullt për gjuhën, i përcaktuar nga arsye të ndryshme, subjektive dhe objektive, prandaj ai s’mund të lidhet çdo herë me gradën e vetëdijshmërisë, sepse si gjuha, si mendimi, të realizuara në një subjekt kanë edhe ekzistencë objektive². Ashtu siç thotë populli ynë “i bie shkurt”, edhe njeriu, e për më tepër, poeti ynë, bën kapërcime duke lënë mënjanë, me ose pa vetëdije çka mund të nënkuptohet. Ndaj nuk e shikojmë si një *varfëri* stili të Çajupit, por dukuri që vjen për shkak të një *parimi ekonomik* ku lihet mënjanë çdo gjë që nuk është esenciale për mendimin.

Formë eliptike është edhe trajta *u* që del në vargje, reduktim i formës së plotë të përemrit vector *unë*. P.sh.: *nga u ç të ligë ke parë?; hëngra dhe u mish njeriu*; apo shkrimi jo i plotë i foljes qan, emrave revole, telefon etj., p.sh.: *ç ke që qa prapë taninë?; nga një revoll; mund të na vijë një tel*; apo reduktimi i bashkëtingëllores *j* si në shembujt: *mbai për vete, vi rrotull* etj.

Reduktimi fonologjik është rrjedhojë e ekonomizmit gjuhësor i cili më i përhapur del në ligjërimin bisedor dhe nga aty është bartur edhe në gjuhën poetike³. Disa herë për shkak të elipsës gjuha e De Radës doli e vështirë dhe jo e vetvetishme. Tommaseu shprehet se elipsi, kjo figurë sintaksore është e nevojshme në poezi. Edhe te poemat e De Radës përdorimi i saj është kthyer në tipar stilformues të autorit. P.sh.: *Mendja tretur në ç’kish shkuar; Gjaku im te Lumi i Vodhit; Po tani të gjitha ëndrra!; Sa hie në ato zakone!*

Ndjenja e bukur dhe e fortë e dashurisë u jep forcë heronjve të përballojnë luftërat për jetë a vdekje dhe poetët me shumë delikatesë kanë zgjedhur ta shprehin përmes figurave të ritmeve e të tingujve. Ja, disa vargje ku shpërthimet poetike të Çajupit shprehen përmes *pasthirrmës*: *O qipariz bujarësh! O i bardhë bir bujari! O vasha kryegështenjë! Ditët e mia fatmira!* Jo vetëm gëzimin, por edhe dhimbjen që shkakton humbja e saj, Çajupi e shpreh me shpërthime të drejtëpërdrejta intonative që lindin si pasojë e gjendjes së rëndë në të cilën ndodhet Shqipëria, herë të tjera, poeti përmes *pasthirrmës*, shpreh shqetësimin nga ikja e rinisë, e dashurisë etj. P.sh.: *O moj Shqipëri e mjerë?; O pëllumb i shkruar!; O moj portë, moj e shkretë/Mos rri mbyllurë përjetë!; O kaur o këthatë!; O korrik, o faqezjarr!; O ju të ra dhe të ri!; Obobo e ububu/Mikia ndër mënd u vu/Në shtëpi të saj më shpu... etj.*

Pasthirrmat janë të llojeve të ndryshme: a) të thjeshta: *o, a, oh, ah* etj. b) të prejardhura prej fjalësh të tjera të thjeshta (me konversion nga pjesë të ndryshme të ligjëratës): *o burra, e zeza, lum* etj. c) të përngjitura janë edhe pasthirrmat e formuara nga përngjitja e dy a më shumë fjalëve të veçanta: *obobo, ububu, tungatjeta* etj.

Shpesh bota e brendshme shpirtërore e poetit apo gjendjet e veçanta emocionale e psikologjike vijnë të theksuara përmes figurave që përftohen nga përsëritjet e ndryshme, si: anafora, p.sh.: *Bëre pemëtë me fletë/Bëre dimër e beharë/Bëre arinë dhe denë; Qani pyje, fusha, gurë/Qani male me dëborë! Me zë të madh si shkëmbi/Me zë të madh si gjëmimi etj.*; epanalepsa, p.sh.: *Mbeta more shokë mbeta; Kurbeti shokë kurbeti; Duro, varfëri duro; U tretë, Gjon Lek', u tretë!; Bariu, shokë bariu etj.*

Ideologjia e Rilindjes u shpreh përmes një arti poetik sintetik ku me fare pak poetët kërkonin të jepnin shumë, të bënin përgjithësime të mëdha figurative dhe ideore, pra, ishte një art që më shumë sugjeronte se shfaqte. P.sh.: stili konçiz i De Radës nuk pranoi mbingarkesat, teprimet. Ai u dallua për një figuracion të zakonshëm të zhveshur nga stolisjet dhe fantazia e tepruar. Me intuitë artistike, thjeshtësi e sinqeritet ai ndërtoi *epitete* të bukura, si p.sh.: *valët kreshtërore, hadhia vilebardhë, vasha mespurtekë, re e ufme etj.*

Gjithashtu, sintaksa jo e rregullt i vjen në ndihmë funksionit ideor të vargjeve që shkruan poetët e kësaj kohe. Kështu, në mjaft vargje spikat figura e *anasjellës* ose *inversionit*, e cila është në funksion të theksimit të cilësive të sendeve a gjendjeve shpirtërore të personazheve të poemave të Çajupit a De Radës si, p.sh.: Rinës, Milosaos, Serafinës etj. Në vargjet e “Milosaos” gjejmë: *e bardha shtëpia ime, me të lodhurat të bijat, të erëkëndshmen kafe pinte, një të hirshme zanë, të zbehtat faqe ia kam soditë, të hirshmet dhoma, të hajthmen dorë i utha, me një të trembur hare, me të nderëm bij bujarësh, me të bardhë cipë kreit, dheut huaj ahëre ndër time motra kisha arritur etj.*

Shënime:

- 1) Kostallari, Androkli, Studime Filologjike III, Rreth një pikëpamje të Jeronim de Radës për formimin e gjuhës letrare të kombit shqiptar, Tiranë, 1981, f. 3.
- 2) Prifti, Stefan, “Elipsa në sintaksën shqipe”, Studime Filologjike III, Tiranë, 1966, f. 133.
- 3) Islamaj, Shefkije, “Gjuha dhe identiteti”, TOENA, Tiranë, 2008, f. 257.

Përmbledhje

Gjuha shqipe, lëvrimi i saj, ishte një çështje me rëndësi për kombin tonë. “Shenja e kombësisë është gjuha, - shkruante Samiu, - çdo komb mbahet nga gjuhët”. Kur një komb e humb gjuhën, humb dhe veten. Por, kombi ynë nuk humbi, përkundrazi, gjithçka që kishte të bënte me të u shpreh përmes një shqipeje të përsosur e të rregullt. Këtë bëjnë poetët. Këtë bëri De Rada e Çajupi. Ndaj ne krenohemi me këta poetë, kombi i ynë nderohet me ta, në mos për patriotizmin e kulluar që ata shpalosën, së paku, për majat e larta që arritën si poetë, si gjuhëtarë.

Sistemi vokalik i së folmes së Kazallveqit

prof.dr.Imri Badallaj

Universiteti i Prishtinës

Për historinë e një gjuhe kanë rëndësi të veçantë studimet e të folmeve të saj, të cilat në të shumtën e herëve ruajnë besnikërisht elemente fonologjike-fonetike, forma morfologjike, ndërtime sintaksore, leksema e frazeologjizma, çfarë edhe për shqipen standarde të dhënat e këtilla të konservuara, ose edhe ato aktive, të cilat gjallojnë në sferën dialektore janë me interes të veçantë lingvistik, sepse në këtë mënyrë hetohet, jo vetëm përhapja dhe shtrirja e veçorive dialektore, por edhe funksionimi i të gjitha fenomeneve fonetike e gramatikore brenda tyre.

Njohja e mirë e materies me të dhënat nëpër të folmet e ndryshme, sidomos nga ato arbëreshe, dukshëm ndihmon, jo vetëm për të mësuar mbi zhvillimin historik të shqipes, por edhe për ta pasuruar atë të sotmen.

Studimi i kësaj së folmeje, të cilën e kemi bërë objekt studimi, flet qartë për një stad mjaft të hershëm të gjuhës shqipe, por që hulumtimi i saj është i ngutshëm se dita ditës shumë leksema e struktura gramatikore, s' do të shkojë shumë mot dhe nuk do t'i gjejmë.

Gjallimi i arbërishtes në përgjithësi nuk paraqet ndonjë befasi. Përkundrazi, tregon një shembull të gjallë, se gjuha e arbëreshëve për kaq shekuj në një vend të huaj arriti të qëndrojë e ta përballojë peshën e një trysnie të paparë e tepër të fortë nga italishtja dhe gjuhët e tjera, që e rrethojnë e që pa dyshim kontaktet midis tyre janë mjaft evidente dhe të pandërprera.

Kjo idiomë dialektore sot ruan një pasuri gjuhësore, e cila dita-ditës po mbulohet nga pluhuri i harresës, përkrah asaj, që në shumë ngulime italo-arbëreshe i vetmi mjet komunikimi në familje e më gjerë akoma është arbërishtja.

Duke parë se arbërishtja në Kazallveq ndodhet në procesin e zhdukjes, ia mësymë studimit të saj, duke i vënë në pah dhe duke u dhënë shpjegim veçorive fonologjike-fonetike, gramatikore dhe leksikore.

Gjatë kërkimeve dhe hulumtimeve tona në terren, u bindëm se banorët e Kazallveqit, që nga mosha shkollore e më lartë janë bilingualë dhe të gjithë sidomos të rinjtë, edhe në familjet e tyre, jo me dëshirë e flasin arbërishten, çfarë kjo situatë më shqetësoi pa masë, sepse në një të ardhme përdoruesit e arbërishtes në këtë trevë, do të jenë ekzemplarë të rrallë, apo më mirë të themi fare të pakët.

Nga kjo del edhe një frikë e folësve me moshë të vjetër, se mos vallë, në të ardhmen, jo fort të largët, brezat e ardhshëm ndoshta nuk do të komunikojnë në arbërishte, në këtë gjuhë të ruajtur me kaq zili për shumë shekuj.

Objekti i kësaj monografie kryesisht është regjistrimi dhe shpjegimi i të folmes arbëreshe, duke nxjerrë korpusin gjuhësor nga tregimet, përrallat e këngët e eksploruara gjatë intervistave dhe vrojtimit tona të bëra në Kazallveq të Pulies me folës, të cilët deri më sot e kishin ruajtur më mirë nivelin e arbërishtes. Edhe përgjigjet e informatorëve në pyetësin tonë, që ishte i përbërë nga rreth 3100 pyetjesh, është regjistruar dhe hulumtuar pjesa më e madhe e materies gjuhësore e kësaj idiome, sidomos leksiku në këtë mënyrë studimi na doli në dukje tërësisht.

Banorët Kazallveqit janë dygjuhësorë, por të shkolluarit dhe sidomos të rinjtë, më me dëshirë e flasin italishten se arbërishten. Këto rrethana na lanë përshtypjen se, edhe ata që e kanë ruajtur mirë arbërishten, përdorin dy sisteme nyjetimi, dhe shpeshherë shqiptimi i arbërishtes del i mundur; çfarë tregon se brezat e ardhshëm një ditë, që ajo mund të jetë edhe larg, por gjithsesi e folmja e tyre do të përfundojë në italishten, që kjo e fundit sot është gjuhë e shkollës, e administratës dhe e shumicës së profesioneve, që i ushtrojnë banorët e këtij ngulimi arbëresh.

Kësaj radhe për *Jetën Arbëreshe* e shkëputëm vetëm një pjesë të vogël të monografisë sonë në dorëshkrim me titull: *E folmja arbëreshe e Kazallveqit*, që po i vëmë në dukje disa nga veçoritë qenësore të sistemit vokalik.

Fonemat vokalike

(Fonemi vocalici)

Në të folmen arbëreshe të Kazallveqit kemi regjistruar 6 tinguj vokalik të mirëfilltë: /i/, /y/, /u/, /e/, /ë/, /o/, /a/, por duke u mbështetur në rezultatin e opozicioneve me vlerë fonologjike të shkallës së kuantitetit vazhdimisht në kushte të caktuara fonetike realizohen 11 fonema vokalike:

<i>i, i:</i>	<i>u, u:</i>
<i>e, e:</i>	<i>o, o:</i>
<i>ë (ə)</i>	
<i>a, a:</i>	

Pra, vokalet e kësaj idiome dialektore realizohen të shkurtra dhe të gjata, për të cilat këtu më poshtë do të bëjmë fjalë veç e veç, por gjithnjë duke marrë parasysh funksionet e tyre në segmentin fonematik, sepse vetëm një qasje e tillë lë mundësinë e përimtimit dhe të shpjegimit të mbarë inventarit të fonemave vokalike.

Vështruar nga ky aspekt, jashtë korrelacionit të kuantitetit, mbetet jashtë vetëm fonema *ë*, e cila nuk mund të krijojë opozicion: *e gjatë* – *e shkurtër*.

Përshkrimi dhe klasifikimi nyjëtitor i vokaleve.

Në këtë njësi do të t'i shtrojmë disa të dhëna rreth përshkrimit të veçorive akustiko-fiziologjike dhe rreth aspektit funksional të vokaleve themelore të kësaj së folmeje arbëreshe të Kazallveqit të Pulies.

Përshkrimi ynë mbi këto vokale, vë në dukje, pos tjerash edhe diferencat e veçorive të fonemave vokalike të kësaj idiome dialektore me idiomat e tjera dhe të vetë shqipes standarde, të cilin përshkrim e kemi mbështetur në tiparet nyjëtimore të lëvizjes horizontale të gjuhës brenda aparatit të të folurit, që formon fenomenin e radhës dhe të lëvizjes vertikale të gjuhës, që gjatë nyjëtimit formon fenomenin e quajtur lartësi.

Si në mbarë sferën dialektore të shqipes edhe në këtë të folme arbëreshe tri shkallët e ngritjes, tri radhët e formimit dhe prania ose mungesa e buzorizimit, përbëjnë tiparet, jo vetëm përbërëse, por edhe dalluese të sistemit vokalik të kësaj së folmeje me të folmet e tjera arbëreshe.

Nëpërmjet përshkrimit të këtyre tipareve del në dukje edhe realizimi i kundërvënieve të të gjitha vokaleve brenda strukturës të kësaj së folmeje.

Pra, duke u mbështetur në realizimin e fenomenit të ngritje dhe të radhës, na dalin zanore të ngritjes së lartë: /i/, /u/; të ngritjes së mesme: /e/, /ë/, /o/ dhe të ngritjes së ulët: /a/. Ndërsa sipas radhës vokalet realizohen të radhës së përparme: /i/, /e/; të radhës së mesme ose të përzier: /ë/, /a/ dhe të radhës së prapme: /u/, /o/.

Nga këto vokale (zanore), kur kemi parasysh pjesëmarrjen e buzëve gjatë nyjëtimit të tyre dallojmë dy grupe:

jobuzore: /i/, /e/, /ë/, /a/

buzore: /o/, /u/

I gjithë rendimenti funksional i kundërvënies, që është rezultat i tipareve të ngritjes dhe të radhës, nuk mbështetet vetëm në procesin nyjëtitor, por edhe në mbarë marrëdhëniet e fonemave brenda vetë sistemit fonematik, që kur krahasohen me sistemin e vokaleve kardinale (themelore), në këtë të folme na dalin pak më të ndryshme.

Sido që të jetë, vënia në dukje e tipareve të vokaleve, duke u mbështetur në ngritje, radhë, labializim (buzorizim) dhe kuantitet, ka një rëndësi të veçantë edhe për t'i përcaktuar kufijtë e variacioneve të fenomeneve fonetike brenda kësaj së folmeje, që po i përshkruajmë saktë të realizuara nga gojët e folësve kazallveqiotë dhe me kujdesin më të madh i vështruar si nga pikëpamja nyjëtimore-akustike ashtu edhe nga pikëpamja funksionale.

Mirëpo, gjatë hulumtimit tonë, kur bëmë krahasimin e zanoreve në pozicion të theksuar me ato të cilat ndodheshin në pozicion të patheksuar, na doli qartë, se të theksuarat kanë prirje të bëhen më qendrore, të hapen dhe shpeshherë edhe të bëhen në një farë mase më të prapme, por ky fenomen tek nyjëtimi i vokaleve

nga gojët e informatorëve, vërehej se edhe vokalet e prapme në ndonjë rast bëheshin në një farë mase më të përparme.

Dihet mirëfilli, se kjo dukuri mbizotëron, jo vetëm në arbërishten e Kazallveqit, por në mbarë shqipen, sepse zanoret e patheksuara nyjëtohen me një tendosje më të vogël se ato të theksuarat. Prandaj, vokalet në pozicion të patheksuar nuk pësojnë edhe aq ndryshime cilësore.

Ndryshimet e tyre i hetuam në kuantitet, çfarë na doli se të theksuarat realizoheshin më të gjata dy herë (ndonjëherë edhe më shumë) se të patheksuarat.

Kur e kemi parasysh, se në ligjërim tingujt vijnë njëri pas tjetrit, duke formuar njësi të kuptimshme, të cilat njësi shërbejnë si mjet komunikimi për kombinimin e mendimeve, këto njësi si veshje materiale mund të realizohen vetëm në saje të fenomeneve me karakter lingvistik dhe as sesi ndryshe.

Në këtë arbërishte fonemat vokalike realizohen edhe në formën e alofoneve (varianteve), të cilat në këtë proces fonologjik gjithnjë lidhen me kushtet e caktuara fonetike, që gjithsesi karakterizohen edhe me disa tipare akustike-nyjëtimore. Megjithatë, këto variante nuk kanë aftësi t'i kundërvihen njëra-tjetrës, çfarë do të thotë, se dallimet, të cilat ekzistojnë midis tyre, nuk shërbejnë për të formuar njësi të kuptimshme të fjalëve, jo vetëm në këtë të folme arbëreshe, por edhe në të gjitha idiomat dialektore të mbarë shqipes.

Pra, koncepti i fonemës nuk mund të barazohet me asnjë nga variantet, që mund të dalin, jo vetëm në këtë të folme, por edhe në mbarë të folmet e tjera italo-arbëreshe.

Për t'i vënë në pah funksionet e fonemave vokalike e më vonë edhe të atyre konsonantike, jemi mbështetur në tërësinë e pozicioneve fonetike dhe në mënyrën e përndarjes (distribucionit) së tyre, duke i konkretizuar nëpër çifte fjalësh, apo siç quhen ndryshe nëpër çifte minimale.

Të mbështeturit në çifte minimale mundëson më saktë ndriçimin e funksioneve dalluese të fonemave brendapërbrenda të një njësie dialektore, që në këtë hulumtim tonin për të dalluar funksionin e njësisë tingullore, aplikuar edhe provën e komutacionit, çfarë do të thotë se kemi bërë zëvendësimin e një foneme me një fonemë tjetër.

Kjo mënyrë e punës hulumtuese na ka sjellë drejt përcaktimit atë që quhet ngarkesë e rendimentit funksional të kundërvënies.

I gjithë rendimenti funksional i kundërvënies, që gjithsesi është rezultat i tipareve të ngritjes, të radhës dhe të labializimit, nuk mbështetet vetëm në procesin nyjëtimor, por edhe në rezultatet, të cilat dalin nga vetë marrëdhëniet e fonemave brenda vetë sistemit fonematik, që kur krahasohen me sistemin e vokaleve kardinale, në këtë të folme na dalin pak më të ndryshme nga të folmet e tjera, qofshin ato arbëreshe ose joarbëreshe.

Fonema i.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

i/a: *idhur (amaro, acerbo) – adhur (venuto), bir (figlio) – ba:r (erba);*

i/e: *lpir (leccato) – lëper (ago);*

i/u: *misht (la carne) – musht (mosto);*

i/ë: *li (vaiolo) – lë (lasciare);*

i/o: *lip (lutto) – lo:p (mucca) etj.*

Kjo fonemë vokalike nyjëtohet si e ngritjes së lartë, e radhës së përparme dhe e pabuzorizuar.

Realizohet e gjatë dhe e shkurtër: *pi (ti pi!) pi: (unë pi:);* në të gjitha pozicionet e fjalës:

në fillim të fjalës: *ik (scappare), imi (mio), isht (è) // Tallandisha isht një zog që bën falen ta pusi- Il rondone è un uccello che fa il nido nel pozo // idhur (amaro);*

në mes të fjalës: *fshinj (scopare), klič (chiave) // Mbulli me klič – Chiudi a chiave // gjithë (tutti) // Gjithë e njihjin për folat që thoi – Tutti lo conoscevano per le bugie che raccontava // mirë (buona), hin (entra);*

në fund të fjalës: *lutmi (ultimo), dashuri (amore) // nta muoji xhunji faunji friti për një javë dhe grurët u bëtënj gjithë me një herë e tata ngë kish ku të zëji i pari – Nel mese di giugno il favanio soffio per una settimana, i grani maturarono tutti in una volta e mio padre non sapeva dove iniziare prima la mietitura // shëmti (scempio) etj.*

Fonema u.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

u/i: *musht (mosto) – misht (la carne);*

u/e: u:r (tizzone) – e:r (vento), tru: (cervello) – tre (tre);

u/ë: kë (che), zu (egli cominciò) – zë (io comincio);

u/o: muri (il muro) – mori (egli prese);

u/a: pu:n (lavoro) – pa:n (essi videro)

u/a: mushku (il mulo) – mashkulli (il maschio), u:r (tizzone), ar (oro), luf (anca), lugë (cucchiaio) // Ha me di lugë – Mangia con due cucchiai // E di luga atë çë ka poça – Lo sa il cucchiaio ciò che contiene la pignatta // etj.

Sa i përket mënyrës së nyjetimit dhe artikulimit të kësaj zanoreje, ajo në këtë të folme realizohet e ngritjes së lartë, e radhës së prapme dhe e buzorizuar, duke zënë vend në të gjitha pozicionet e fjalës:

në fillim të fjalës: ujë (acqua), unazë (anello), udhë (strada) // Bëni udhë të ligut – Lasciate strada al cattivo // ulla (fratello) // Ishin njëherë di ullezër – C'erano una volta due fratelli //, uthëll (aceto)

// Vera a mirë bëhet uthull – Il vino buono diventa aceto // uringjël (zio), (i,e,të) urtuor (urtato);

në mes të fjalës: muaj (mese), grusht (pugno), burrë (uomo) // Ndë je burrë mbà fjalën – Se sei uomo mantieni la parola // buxarun (lazzarone) muti (la merda) // Kur ljoset bora duket muti – Quando si scioglie la neve si vedono le feci // dogj (bisaccia)E vura me di këmbë te një këpucë –L'ho messo con due piedi in una scarpa // Ai kushëllon lëtisht – Egli parla in italiano // gùr (pietra) // Gur gur bëhet mur – Pietra su pietra diventa muro // etj.

në fund të fjalës: miku (amico), lexhu (lentamente), kështu (così), dharasu (lontano), këtu (qui, qua) // Këtu e di vjet të shkuora – Due anni fa // etj.

Fonema e. - Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

e/o: je (tu sei) – jo (no), e:r (vento) – o:r (ora);

e/a: e:t (sete) – at (padre). pren (tagliato) – pran (vicino) etj.

Kjo fonemë nyjtohet si e ngritjes së mesme, e radhës së përparme dhe e pabuzorizuar. Si e tillë realizohet në të gjitha pozicionet:

në fillim të fjalës, herë si e gjatë dhe herë si e shkurtër: edhé (anche) // Të thom edhé këtë e vete – Ti dico anche questo e vado via // émbër (nome) // Qen embrin e tatëmadhit – Porta il nome del nonno // Ka embrin a mirë – Gode di buona fama // ethe (febbre) // Kam ethe e madhe – Ho la febbre alta // etje (sete) // Kam etje – Ho sete // èrë (vento) // Frin erë e fortë – Soffia vento forte //

Ulku njeh ulkun ka era – Il lupo riconosce il lupo dall'odore // etra (ettari) //

Bleva tre etra dhe – Ho comprato tre ettari di terreno // énjte (giovedì), ecën (camminare)

// Dëtira ecën natën – Il debito cammina di notte // etj.

në mes të fjalës: vemi // Ta gushti vemi e rrimi bashkë – In agosto andiamo a stare insieme// tjervet(altrui) // Gruoja e tjervet ishtë m'e mirë – La donna altrui è migliore //

në fund të fjalës: faqe // Faqe të kuqe – Gote rosse // Çë faqe ka ajo gruo – Che sfacciataggine ha quella donna // fe (fede), ljule (fiore) // Të rrita si lulje – Ti crebbi come fiore // etj.

Fonema o.- Mund të identifikohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

o/a: lot (lacrimo) – lat (voi lasciasta), marr (pidocchio) – marr (prendo);

o/rr: rro:t (ruota) – rrat (I vermi intestinali);

o/u: voc (gozzo) – vuc (barile);

o/e: dora (la mano) – dera (la porta) etj.

Kjo fonemë nyjtohet si e ngritjes së mesme, e radhës së prapme, e shkurtë dhe e gjatë, duke u realizuar në të gjitha pozicionet.

Në fillim të fjalës: ora (ora), ofiçina (officina), oh, oj (oh!) ov! (ohi!) // ov! (ohi,ahi!) // Ov! Sa më dhemb koça – Ahi! Quanto mi fa male la testa // etj.

në mes të fjalës: dogji // Dogji gluhën – Si bruciò la lingua // Më dërgoiti të falat – Mi mandò i saluti // Vloje bukën e bardhë pë ditë të zeza – Conserva il pane bianco per giorni tristi//;

në fund të fjalës: jo (no), shko (andare), këndo! (canta!) // Këndo ma zë të fortë – Canta a voce alta // etj.

Fonema ë /ə/.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

ë/e: kë (chi) – ke (tu hai) etj.

Ë-ja nyjëtohet si zanore e radhës së përzierë dhe e ngritjes së mesme dhe e pabuzorizuar.

Kjo fonemë kur është në pozicion të patheksuar është e prirë të reduktohet. Megjithatë, ka raste kur ë-ja edhe si e patheksuar të ruhet, por shumë më pak se në toskërishten e sotme, çfarë tregon se e folmja arbëreshe e Kazallveqit ka ruajtur stadin e shqipes së hershme sa i përket përdorimit të saj.

Realizohet

në fillim të fjalëve (në pozicion nistor): *ëmbël (dolce), ëmë (madre) //Jat ëmë – Tua madre // ëndërr(sogno) // Sondenatë të mora ëndërr – Stanotte ti sognai // ëndë (piacere) // M'e k'ënda-Mi fa piacere //*

në mes të fjalës (në pozicion mesor):*dhëndërr (fidanzato) // dhëndrri i saj - il suo fidanzato //*

dhënë (dato), dhëngall (molare), dhëmb (dente) // Krishti i jep bukën atija çë ngë ka dhëmbë- Cristo dà il pane a chi non ha denti //

në fund të fjalës (në pozicion fundor): *gjuhë (lingua) // Dogji gjuhën – Si bruciò la bocca // ishtë (è), koçë (testa) // Kush ngë ka koçë, ka këmbë – Chi non ha testa ha piedi // pulë (gallina), sparangerë (pianta dell'asparago), bukë (pane) // Motër e ulla/ kush ka bukë e ha–Sorella e fratello // chi ha il pane lo mangia // klishë (chiesa), farë (seme), gozhdë (chiodo) // Shkula një gozhdë – Estrassi un chiodo //, gojë (bocca) // Me gojë e plot – A bocca piena // Ç'gjuhë jan 'e fjasjën – Che lingua stanno parlando // etj.*

Fonema a.- Mund të identifkohet me disa fonema të tjera në opozicionet:

a/e: pas (dopo) – pes (cinque);

a/o: marr (prendo) – morr (pidocchio);

a/u: mashku (il maschio) – mushku (il mulo);

Fonema **a** nyjëtohet si zanore e ngritjes së ulët, e radhës së mesme, e pabuzorizuar,

e shkurtër dhe e gjatë. Realizohet në të gjitha pozicionet, qoftë si e gjatë ose si e shkurtër dhe e theksuar dhe e patheksuar:

në fillim të fjalës: *ardhur (venuto), atië (là): // Atie poshtë – laggiù // arrë (noce): // Arrat bjenjën kur piqen – Le noci cadono quando sono mature // asht (osso): U bë lëkurë e asht – E diventato pelle e ossa //*

në mes të fjalës: *acar (acciaio), shapë (ramarro), gjaku (sangue): // Gjaku ngë bëhet ujë – Il sangue in coagula non diventa aqua //*

në fund të fjalës): *kla (piangere // Lisi bën mbëkatën e dega e kla – L'arbero fa il peccato e il ramo piange // sharabà (veicolo leggero per il trasporto di persone), njëra (fino a) /Njera sod edhe ngë më shkruon – Fino ad oggi ancora non mi scrive // Errura njera atje – Arrivai fin là // shpia (casa) // Shpia plot bën gjuojën e urtë – La casa piena fa la donna sargia // etj.*

Alternime vokalike (Alternanze vocaliche). -

Brenda sistemit vokalik të kësaj së folme dukshëm janë shkaktuar edhe alternimet nga të gjitha vokalet dhe grupet vokalike, që shpeshherë këto kanë krijuar funksione fonologjike, duke mos munguar edhe ato morfologjike, si p.sh.:

a/e: *plak (vecchio) – pleq (vecchi) , dash (caprone) – desh (caproni);*

a/o: *marr (io prendo) morra (io presi);*

e/a: *merr (egli prende) – marr (io prendo); ler (nato) – lar (lavato), vete (io vado) – vate (egli andò);*

a/i: *vras (uccido) – vrini (voi uccidete);*

a/ë: *ha (io mangio) – hëngra (io mangiai);*

a/i: *çel (io accendo) – çil (accendi tu), sheh (tu vedi) - shih (vedi tu);*

a/o: *breth (io scherzo) – brodha (io scherzai);*

i/e: *qip (cuci tu) – qep (io cucio);*

o/e: *(i) vogël (piccolo) – (të) vegjël (piccoli);*

o/uo: *zblonj (scopro) – zbluor (scoperto);*

ie/i: *nxier (io tolgo) – nxirni (voi togliete);*
ie/o: *prier (io volgo) – prora (io volsi);*
ie/u: *shtie (io butto) – shtura (io buttai),*
uo/u: *kruonj (io gratto) – kruhem (io mi gratto);*
ie/je: *shtie (io butto) – shtije (buttalo) etj.*

Diftongje dhe togje vokalesh. - Duke u nisur nga parimi se diftongjet përbëhen prej dy elementesh vokalike, që formojnë një rrokje të vetme, por që patjetër njëra nga këto duhet të jetë një vokal i ngritjes së lartë, sepse vetëm të tillat kanë aftësinë e humbjes së rrokjeformimit në pozicion të theksuar, çfarë ne mendojmë se shumë studiues të dialekteve të shqipes i kanë ngatërruar togjet e zanoreve me diftongjet, duke mos qenë në gjendje, që ato t'i identifikojnë në mënyrë të drejtë. Prandaj, në studimin tonë së pari jemi mbështetur në të dhënat teorike rreth diftongjeve në përgjithësi e pastaj, duke i vështruar ato edhe në këtë të folme, por gjithnjë duke e pasur parasysh materien gjuhësore të eksploruar në terren nga gojët e informatorëve kazallvegjiotë.

Në këtë të folme arbëreshe realizohen togjet vokalike: *ie, uo* e më rrallë edhe *ua*.

Togu *ie* në disa fjalë realizohet si tog zanor me theks mbi elementin e parë: *diell (sole), mbiell (seminare), miell (farina) etj.* Mirëpo, ngjet që theksi të kalojë në elementin e dytë dhe togu *ie* kalon në diftongun **je**: *bjerrë (perdere, smarrire), vjehërr (suocera), djeg (bruciare) etj.*

Në mungesë të **y**-së me *ie* realizohen edhe fjalët: *krie (capo), shërbier (servire), nxjerrë(trarre), etj.*

Togu *uo* përbën njërin nga treguesit më të vjetër të stadi të gjuhës shqipe, si *psh.:* *gruoja*, por në trajtën e pashquar del edhe me togun **ua**: *gruas*, përndryshe në fjalët: *bluonj (macinare), rruonj (vivere), shuomi (spegniamo), muoj (mese) duoçit (bisacce) etj.*, realizohet vetëm si tog zanor **uo**.

Elementet etnografike në tablotë e piktorit arvanitas Andrea Kriezis

dr. Merita Toçila

nga Tirana

Përmbledhje

Piktorët arbërorë në brigjet e Italisë dhe arvanitasit e Greqisë dhe të ishujve përreth, bëjnë pjesë në strukturën shpirtërore dhe kulturore shqiptare. Tek veprat e këtyre piktorëve të bie në sy tërheqja drejt rrënjëve të të parëve. Kjo ndjehet fuqishëm tek disa prej tyre, të cilët kanë trajtuar gjerësisht tematikën, motivet, por sidomos veshjen arbërore. Një prej tyre është piktori arvanitas Andrea Kriezis (Kryeziu) nga Hydra. Ai është shquar si një piktor që e ka përqëndruar krijimtarinë me modele që përfaqësojnë anëtarët e familjes së tij dhe të pallatit mbretëror si dhe subjekte detare. Prej tyre kemi veçuar disa tablo ku ndeshim disa elemente të rëndësishëm etnografikë të veshjeve arbëreshe, midis të cilave ato ku paraqet nënën, gruan, babanë, si dhe një tablo me mbretin Otto me veshje arvanite. Nëpërmjet vepres së artit marrim informacionin e munguar për veshjet arbërore të përdorura në fund të viteve '800.

Një ndër më të parët piktorë arvanitas është Andrea Kriezis (Kryeziu) nga Hydra. Informacionin mbi jetën dhe krijimtarinë e artistit arvanitas e jep studiuesi Aristidh Kola në periodikun “Besa” dhe më pas “Arvanon” publikuar prej shoqatës së arvanitasve në periudhën midis viteve '80-'90-të të shekullit XX në Greqi. Kriezis u lind midis vitit 1813-1816 në ishullin Hydra dhe mendohet të ketë vdekur rreth vitit 1880. Ishte i biri i një kapiteni arvanitas të marinës tregtare greke. Ishulli në të cilin u lind dhe u rrit, Hidra, ishte një nga fortesat kryesore për flotën greke gjatë Luftës së Pavarësisë. Ngjarjet, por edhe traditat e bashkësisë arbëreshe në ishull duhet të kenë ndikuar në formimin e artistit. Ai nuk ndoqi profesionin tradicional të familjes së tij detare, por shkoi në Athinë, ku punoi për një kohë si litograf në shtypshkronjën mbretërore të Athinës. Në vitin 1839 u largua në Paris për të përmirësuar aftësitë në teknikën e litografisë, por ndoqi atje edhe studimet për pikturë. Veprat e para të tij rezultojnë të jenë krijuar në periudhën kur ishte në Paris, dhe më saktësisht më 1841. Pas kthimit në Greqi, krijoi si artist i lirë dhe përgjatë viteve 1859-1875 mori pjesë në disa ekspozita. Ka punuar dhe si ikonograf në realizimin e portreteve të disa shenjtorëve në muralet e kishës së Shën Irinit në Poros, por zakonisht nuk i nënshkruante veprat e tij, kështu që vetëm një numër i vogël i tablove i janë atribuar atij. Është shquar si një piktor që e ka përqëndruar krijimtarinë me modele që përfaqësojnë anëtarët e familjes së tij dhe të pallatit mbretëror si dhe subjekte detare. Prej tyre kemi veçuar disa tablo ku ndeshim disa elemente të rëndësishëm etnografikë të veshjeve arbëreshe, midis të cilave ato ku paraqet nënën, gruan, babanë, si dhe një tablo me mbretin Otto me veshje arvanite.

Portreti “Zonja nga Hidra”, realizuar më 1847, është një nga pikturat më të veçanta në gjithë larminë e tablove të trashëguara nga artistët arbëreshë, jo vetëm për trajtimin piktorik, por më së shumti për informacionin që na jep rreth një kostumi arbëror në ishullin Hydra në mesin e shekullit XIX. Nëpërmjet saj, konkretizojmë ato dëshmi mbi veshjet që kanë lënë në tekste e vizatime, udhëtarët europianë kur kanë vizituar ishujt grekë të populluar nga arbërit. Ndërtimi grafik i kostumit është pothuajse i njëjtë me litografinë e Stackelberg realizuar në terren në ishullin Hydra në vitin 1825 botuar në albumin “Costumes usages des peuple de la Grece moderne” dhe po ai kostum me të cilin është fiksuar në telajo heroina arvanite Laskarina Bubulina. Tek veshja e gruas nuk shihen në strukturë ndërhyrjet orientale që pësoan disa kostume brenda trojeve shqiptare pas vdekjes së Skënderbeut. Ajo afron në detaje me ato veshje që i rezistuan këtyre ndërhyrjeve në zona të veçanta të Shqipërisë, të cilat ishin më të izoluar dhe që mbetën të paprekura prej ndikimit osman. Ngjashmëria me veshjet e veriut hamendëson për lëvizjet e imponuara të popullsisë së veriut drejt jugut, sikurse është argumentuar shpesh nga historianët, gjithashtu



Fig. 1

dhe për homogjenitetin që mund të kenë patur veshjet arbërore në të gjitha krahinat e banuara prej tyre por që derivuan më pas prej faktorëve historikë. Kështu vërejmë në pjesën e gjoksit, me jelekun që i mbërthehet nën të, pamja është shumë e afërt me pjesën e përparme të veshjes mirditore, e cila vazhdoi deri në fillim të shekullit XX në Shqipëri. Ajo që i bashkon të dyja është jeleku me ngjyra, i cili nëpërmjet një dekolteje në formë U-je nga ku duket këmisha e bardhë nën të, tërheq vëmendjen drejt kraharorit. Për këtë qëllim këmisha në pjesën e përparme modelohej me qëndisje dhe aplikacione duke ruajtur tonalitetin e së bardhës. Kraharori në këtë rast me relievin e bute që krijonte coha gjatë punimit shndërrohej në një pjesë tërheqëse. Jeleku i zgjedhur i gruas në tablo mund të jetë një cohë mëndafshi e marrë enkas për një grua me mirëqënie ekonomike, që në këtë rast zëvendëson jelekun e vjetër i qëndisur të do shekujve më parë. Ndërsa pjesa e poshtme, përbëhet prej një fundi në formë këmbane me bordurë në ngjyrë tjetër. Ndërthurja e dy ngjyrave me të njëjtin intensitet, korrespondon me po atë zgjidhje si fundi i kostumit të arbëreshëve që përdoret ende sot në zonat e Kalabrisë. Dhe me aq sa arrijmë të shquajmë prej tokitjes së penelit mbi kanavacë, fundi është me pala, por më të gjëra se i arbëreshëve të Italisë. Gama e ngjyrave lëviz ndërmjet të kuqes së errët me vija në ngjyrë okër, smeraldit dhe të bardhës, ku pjesën më të madhe e zë e gjelbra e fundit, e kuqja përmbyll kompozimin ndërsa e bardha, ndodhet aty për efekte teknike të veshjes, por edhe si një pjesë për të veçuar kraharorin e gruas. Shamia që i mbështjell kokën, e ndan grafikisht portretin nga trupi, duke e trajtuar si një ornament më vete. Lulet e shamisë shpërndahen si rastësisht rreth portretit të gruas, duke finalizuar lojën e ngjyrave të kostumit me buqetën në krye. (fig. 1)

Kjo tablo është më e hershme se “Motra Tone” e Kolë Idromenos, por ajo të lë të njëjtin impression prej mënyrës së kompozimit, intensitetit të ngjyrave dhe peshës psikologjike që transmeton subjekti. Ndryshe prej saj, “Zonja nga Hydra”, megjithëse ka një mbledhje shamie rreth kokës, nuk ka ndrojtjen, frenimin dhe mungesën e lirisë që transmeton “Tonia”. Qëndrimi i saj, mënyra e mbajtjes së duarve, të lira por të matura, busti i zbuluar nga mbështjella e shamisë, tregojnë një grua që merrte gjithë vëmendjen, gëzonte gjithë të drejtat (kuptohet brenda kohës) dhe bënte pjesë në një bashkësi më të emancipuar se simotra e saj shkodrane.

Në 1877 Kriezis realizon një portret gruaje, “Trëndafila Kryezis”, me shumë mundësi e shoqja. Duket një grua në moshë madhore dhe ne mund të lexojmë në portretin e saj gjurmët e një jete të qetë dhe pa stërmundime. Rikthehemi përsëri tek Idromeno dhe sjellim në kujtesë portretin e gruas se tij, Cinës. Është e njëjta përkujdesje, jo vetëm prej mjeshtri, por edhe ndjenje për një portret të dashur. Krahasuar me portretin e mësipërm, veshja ka lëvizur. Ka humbur gjurmët e traditaciones dhe ka marrë tiparet e një veshjeje europiane. Në fund të viteve ‘800 në vendet e zhvilluara europiane, u braktisën kostumet e vjetra dhe u përhap nxitimthi kostumi anglez i borgjezëve të rinj, që vinte më i thjeshtë, më praktik dhe i ndërtuar kryesisht mbi kontrastin bardh e zi. Të kamurit dallonin prej shtresave të tjerave jo më nga modeli, por nga materiali. Dhe materialit i mantillës së gruas që duket kadife e dekoruar në borde, nën të një fustan të zi, na lë të kuptojmë kamjen e kësaj aristokrateje të re. I vetmi dekor mbetet jaka e bardhë me dantella, që krijon një ndërhyrje delikate në rrethin e qafës, mbi të cilën është vendosur një bizhu. Flokët e saj kanë një krehje të kujdesshme dhe mbi to ka vendosur një kapele me pupla, e cila mbahet me flokun me anë të një karfice të artë. Këto detaje të thjeshta, por të për cilësore e diferenconin atë në mjedisin ku bënte pjesë. (fig. 2)



Fig. 2

Në portretin e të atit, “Admiral Kriezis”, kapitenit arvanitas të marinës tregtare, duket që autori i ka lënë hapësirë dy elementeve identifikues të etnicitetit të tij brenda tablosë. Në kostumin monokromë të uniformës së një ushtaraku të lartë, ka përzierje me elemente etnografike. Tonet monokramtike në të cilat është trajtuar peizazhi dhe uniforma i japin më shumë intensitet të kuqes së festes në kokë dhe brezit të gjerë me vija me ngjyra të ndryshme, i lidhur në mes sipas traditës arbëreshe duke krijuar një thyerje të linjës së kostumit. Jaka e bardhë me cepat e tylltë dhe lidhja e fjongos në qafë janë karakteristikë e dandyzmit të përhapur gjerësisht edhe në veshjet e burrave. Ajo demonstronte përkatësinë sociale të personazhit të tablosë i cili zinte një vend të respektuar në shoqërinë e kohës, ndërsa festja dhe brezi demonstronin përkatësinë

etnike të tij. Nëse i referohemi sërish veshjeve të përdorura në Shkodër në fund të viteve '800, të trajtuara nga piktori Idromeno, ka ngjashmëri me strukturën e kësaj veshjeje. Dallojmë qartazi tiparet e kostumit shkodran të shekullit XIX, me xhaketën e vogël, brezin e gjerë dhe brekeshat e gjera, të cilat mbliidhen në mesin e pulpës. Dhe jaka e bardhë e këmishës, përveçse është në material të shtrenjtë, nuk devijon nga ai i burrave shkodranë. Këto konstatime mund të na nxjerrin në përfundime interesante të historisë së kostumit shqiptar dhe ndryshimeve të tij në kohë. (fig. 3)

Kriezis ka realizuar dhe një portret të mbretit Otto si asnjë piktor tjetër. Në këtë tablo shihet një paraqitje interesante e ngjyrave, materialit e dekoracioneve. Këtu e arta nuk është më e artë por përzihet me ngjyrën e argjendit. Dhe loja midis tyre tregon shtrenjtësinë e veshjes së mbretit. Sumbullat e shumta të jelekut, të cilat renditen vertikalisht përgjatë bordurës dekorojnë kraharorin e tij. I vetmi kënd ku duket pëlhura, kadife smerald, është një pjesë e kraheve të cilët janë të fiksuar vetëm në kulmin e supit dhe në kyçin e dorës. Edhe ato janë të qëndisuar për qark bordurës njësoj si xhoka. Në një anë mund të shquajmë detajin e valëve të detit aq shumë i përdorur pothuaj në të gjitha qëndisimat për veshjet apo interoret e banesave tona. Nga hapja që krijon mëngorja e kapur vetëm në skaje, në anën brendshme lë shfaqjen e të bardhës së këmishës, e cila, në modelin e kohës me jakën me cepa, duket sikur rri mjaft mirë me një kostum të krijuar shekuj më parë. Prej dinjitetit dhe potencës që impononte kostumi arbëror, bëhej aq i admirueshëm dhe prej personaliteteve të huaj, sa disa prej tyre e kanë përdorur si kostum ceremonial. (fig. 4)



Fig. 3



Fig. 4

Përemrat pronorë në veprën e Ndre Mjedës

Ma. Shyhrete Morina

Universiteti i Gjakovës

Kur krahasojmë përemrat pronorë në veprën e Mjedës me të njëjtët shqipen e sotme, shihet qartë se ky segment gramatikor ka pësuar ndryshime të dukshme, sidomos në strukturë, por semantika është ruajtur mjaft mirë. Meqë, Mjeda si shkodran që ishte veprat e veta i shkroi në dialektin gegë. Kjo më së miri tregon, se dallimet në strukturë janë të karakterit gegë. Zatën tek pronorët dallimet janë më të dukshme se në të gjitha kategoritë e tjera gramatikore.

Ndre Mjeda që atëherë ishte i mendimit të mënjanoheh trajtat, si: *letra yte, libri i jonë, drejtori tonë*, dhe të shkruhen format, si: *libri yt, letra yte; letra e jonë, libri i jonë*. Pra, sipas tij (1934: 24)...aq e pakuptimtë është me thënë: “*káli i jonë*” e “*letra yte*”, sa kishte me qenë e pakuptueshme të thoshte kush: “*këjo kál. “ky letrë*” (Mjeda, 1934: 24). Me këtë mendim pajtohet edhe Selman Riza (2002: 258), i cili thotë se këto trajta duhet të largohen. Mirëpo, nuk pajtohet me mendimin, se këto trajta paskan ardhur nga ndikimet e latinishtes (po aty: 258). Megjithatë një shqyrtim i vëmendshëm i Mjedës, që i kushtoi përemrave pronorë, doli se këta përemra dallojnë brenda shqipes dhe janë të përafërt me përemrat vetorë.

Pronorët kanë një denduri të madhe në veprën e këtij autori. Sidomos përdorimi i tyre në bashkëvajtje me emra ose më vete, është karakteristikë që i afrohet me mbiemrat. Në korpusin tonë një numër i konsiderueshëm i përemrave pronorë që përdori Mjeda, janë përcaktues, përveç disa prej tyre kur shoqërojnë emra farefisnisie, që edhe vendosen para emrit, si: *Po jot ’amë* (Vepra 1: 81), *U shfaq tat gjyshi* (f. 153), etj. Pronorët e shënojnë raportin midis pronës dhe pronarit, siç thotë edhe Bokshi (2004: 14)...*se kuptimi i pronarit s’ mund të jetë i ndarë nga kuptimi i pronës, dhe që këto janë në solidaritet sintaksor të përemrit pronorë. Kur janë në bashkëvajtje me emra, veç përemrave të vetës së parë e të dytë prona shumë dhe pronari njëjës, dalin me nje, si të gjithë të tjerët që janë pa nje*“.

Te Mjeda shihet, se disa përemra pronorë dalin me nyja, që edhe i kemi pasqyruar në tabelat në vazhdim, të cilët në shqipen standarde dalin pa nyja. Krahas ruajtjes së disa formave përemërore me strukturë dhe veçori gramatikore të njëjta, vihen re edhe disa përdorime nga dialekti i tij, dukuri këto që dendur hasen në tërë të folmet e gegërishtes veriperëndimore. Mirëpo, duke mos harruar faktin, se Mjeda përemrave të shqipes u kushtoi mjaft rëndësi, si për nga mënyra e përdorimit të tyre, ashtu edhe me studimin e tyre të gjerë, që e bëri tek autorët e vjetër, duke publikuar edhe një studim të thukët mbi pronorët, që shihet qartë se evolucioni historik i tyre del shumë më i ndërlikuar se i përemrave të tjerë të shqipes.

Si i përdori Mjeda përemrat pronorë në veprat e tij

Për realizimin e këtyre përemrave jemi mbështetur në korpusin e përzgjedhur nga veprat e Mjedës, si: “Juvenilja” “Andrra e Jetës” “Lissus” “Liria” “Scodra”. Në korpusin e nxjerrë të pronorëve në tërë veprën e Mjedës kemi bërë krahasimin e të gjitha formave dhe trajtave të tyre, duke i krahasuar ato me ato forma dhe trajta të pronorëve të shqipes standarde.

Shembujt janë përzgjedhur gjithnjë në kontekst dhe në funksionin e tyre, që ata mund t’i kenë në tërë veprat e autorit, të cilat i kemi përzgjedhur si përdoruesin më të avancuar të gegërishtes veriperëndimore.

Kategoritë gramatikore të përemrave pronorë

Pronorët në vetën e parë te Mjeda dalin me këto forma: im-ême/ e mië- e mija, ynë-jonë, tănë-tonë, tregon se sendi i përket vetës që flet - folësit, si: *Ky asht kali im; E kurr ma ndër ditt e mija* (Juvenilja, 1962: 44); *Kishte mbëlue kocijt e mi* (Po aty, 54); *Ushtrija e jonë mbas leprave Greqijet* (Lissus, 1962: 101); *Këjo tokë e jona* (f. 125), etj.

Veta e dytë: yt (jyt)- jote, e tú- e tua, t’uej-túja, si: *Njaj vaji i jyt nji fjalë* (f. 24); *M’ikë, o shqype, vendi i jot* (Juvenilja, 1962: 44); *Gjama e jote á porsí ankimi* (Po aty, 35); *Burrat t’tu qi toka i mbëlon* (f. 65); *Mbi krahë t’uej; E ndertesat të túja* (f. 132), etj.

Veta e tretë: i tij-e tij, i sajë- e sajë, i vet-e vet/t'veta, si: *Emni i tij* (Vepra 1: 68); *Dukej faret fëtyra e sajë*; *Te shpija e vet*; *Pvetshin hyjt për prind të vet* (Juvenilja: 36); *Lyp m'u vue per lavre t'vet* (f. 70); *Permbi vend qi sasht i vet* (f. 66); *Rrezet e veta* (f. 41), etj.

Kategoria e gjinisë

Sa i përket gjinisë, pronorët në përgjithësi karakterizohen nga raporti pronë-pronar. Kështu, në të dy vetat e para, në cilëndo gjini pronorët dalin me format: *im, ême, yt, jot/ jote*, p.sh: *kali im, shpija ême* (Vepra 2: 120). Pra, te Mjeda kemi formën, që shpreh vetën e dytë, si: *jot amë* (Vepra 1: 81). Ndërsa, sa i përket vetës së tretë ai përdor trajtat: *Jetën e tij, t'delte shtegut* (f. 118); *E zani i saj lajthim* (f. 94); *Dukej faret fëtyra e sajë*; *Prej kendej, n'dorë t'tij veton* (f. 95); *E kurrqja n'ankime t'tija* (Juvenilja, 1962: 52). Siç, shihet te pronori merr edhe fundoren -ë, si: *e sajë*.

Kategoria e numrit

Meqë pronorët kundrohen nga raporti i dyfishtë “pronë-pronar”, për secilin numër kanë më së një formë (Demiraj, 1988: 238). Kështu që, do t'i paraqesim edhe në mënyrën e përdorimit në numrin njëjës dhe në numrin shumës, si p.sh.: kur themi: *ky është kali im* (Vepra 2: 120), përmiri pronor im është në numrin njëjës si prona ashtu edhe pronari. Ndërsa në shembullin: *Kishte mbulue kocijt e mië* (f. 30), përmiri pronor *e mië*, nuk përshtatet me numrin e pronës, sepse prona është në numrin shumës, ndërsa pronari është në numrin njëjës.

Për të pasur një pasqyrë sa më të plotë mbi format e përdorimit të pronorëve, që dalin në veprën e Mjedës, po japim këtu paradigmen e krahasuar të pronorëve të dy vetave të para, njëjës e shumës.

Tabela 1.

Veta I					
Rasa	a. Te Mjeda			b. Në shqipen standarde	
	Pronori			Pronori	
	Njëjës	Shumës		Njëjës	Shumës
	Gjinia mashkullore			Gjinia mashkullore	
E.	i-m	mí ¹⁴		im	e mi
Gj.Dh.	ti-m	t' mi		tim	të mi
K.	tê-m	mí		tim	të mi
Rr.	si-m	t' mi		tim	të mi

Tabela 2.

Veta I					
Rasa	a. Te Mjeda			b. Në shqipen standarde	
	Njëjës	Shumës		Njëjës	Shumës
	Gjinia mashkullore			Gjinia mashkullore	
	E.	ynë	tâ-në		ynë
Gj.Dh.	ti-në	ti-nëve		tonë	tanë
K.	tâ-në	tâ-në		tonë	tanë
Rr.	si-në	si-nësh ¹⁵		tonë	tanë

Tabela3.

Veta I				
Ras a	a. Te Mjeda		b. Në shqipen standarde	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
	Gjinia mashkullore		Gjinia mashkullore	
E.	yt	tú	yt	e tu
Gj.Dh .	ti-t	t'tu	tënd	të tu
K.	tand	tú	tënd	e tu
Rr.	i-t	t'tu ¹⁶	tënd	të tu

Duke parë pasqyrimin e këtyre përemrave pronorë, që dalin në veprën e Mjedës, shohim se format e përemrit pronor të vetës së parë të gjinisë mashkullore **im-** në rasat: emërore, gjinore-dhanore dhe kallëzore dalin: *A pasqyra e vajit t'im* (Juvenilja, 1962: 43); *Djalit tem i kise ndejun* (Po aty, 54); *Atdhen t'ëm e kalove* (f. 26). etj.

Disa përemra pronorë dalin të emëruar dhe përdoren në trajtë të shquar kur shoqërohen me emra të pashquar si, p.sh: *Mbi krye t'ëmin pá nji faj* (Juvenilja: 21) etj. Pronori mashkullor i vetës së dytë njëjës **yt**, si dhe të vetës së parë shumës **ynë/tanë**, si p.sh.: *djali jot për djali yt*, çfarë edhe shihet se plotësisht përkohet me të shqipes së sotme: *yt, ynë, tanë*.

Pronori i vetës së dytë **yt**, i cili në gjinore-dhanore del me formën **tít**, në rasën kallëzore merr këto forma: **tat** dhe **t'and** si, p.sh. *Zânin t'ând* (Vepra 1: 25). Në disa raste përemrat pronorë Mjeda i përdor para emrit, sidomos tek emrat e farefisnisë, si: *U shfaq tat gjyshi* (Po aty: 153); *Po jot'âmë* (f. 81), etj. Format rasore të vetës së parë shumës ynë, në rasën gjinore-dhanore i gjejmë me formën: **tinë**, ndërsa në rasën kallëzore **tânë**, dhe në rrjedhore **sinë**. Këto forma sipas Demirajt (1988: 485): *tinë, sinë, tanë, tinëve, sinësh* janë zëvendësuar nga forma homonime tonë, kurse *sanë* dhe *sonësh* janë zëvendësuar nga format *sonë* dhe *tona*. Në përgjithësi, mbarsat *-ve* dhe *-sh*, të pronorëve në rasat gjinore-dhanore, përkatësisht rrjedhore shumës janë mënjauar, ashtu si të mbiemrat e nyjshëm.

Forma e këtyre përemrave për të dy vetat del me disa ndryshime fonetike me shqipen e sotme standarde. Ndryshime me karakter fonetik dhe morfologjik që kanë pësuar disa forma rasore të këtyre pronorëve, kur krahasohen me shqipen e sotme, siç u vu në dukje edhe në format e ndryshme rasore të tij, shihet se disa sish janë ruajtur nga format e vjetra të disa përemrave pronorë, të cilët i përdor dendur edhe vetë Mjeda.

Format e përemrit pronor të vetës së parë për gjininë mashkullore në veprat e këtij autori dalin: *e mí*, po nganjëherë merr edhe *ë*-në fundore, si p.sh.: *Kish mbulue kocijt e mië* (f. 30), etj. Ndërsa në vetën e dytë shumës për gjininë mashkullore: **tú**, si p.sh.: *Me ndo 'j fëmië tu' e kalamendun; Janë t'bjit t'tu qi pate mot* (f. 68); *Ndoshta kujdesi i t'tujve* (f. 10). Po ashtu, kemi vërejtur edhe disa ndryshime te veta e dytë njëjës për gjininë mashkullore, ku rasa emërore del në dy mënyra si : *ýt/jyt*, kurse në rasat gjinore-dhanore dhe kallëzore del *t'and*, si p.sh.: *Për atdhe t'and shkreta; Pret me t'anden m'u ba nji* (f. 44); dhe në rrjedhore sit. Format rasore në njëjës dhe në shumës të përemrit pronorë të vetës së dytë për gjininë mashkullore *yt/tú*, dalin: *jyt* dhe *jot*, p.sh.: *Njaj vaji i jyt nji fjalë* (f. 24); *M'ikë, shqype, vendi i jot* (f 20), etj.

Tabela 4.

Veta I				
	Pronori		Pronori	
	Njëjës	Shumës	Njëjës	Shumës
	Gjinia femërore		Gjinia femërore	
E.	ê-me	mija	ime	e mia
Gj.Dh .	sê-me	t'mija	sime	të mia
K.	tê-me	mija	time	e mia
Rr.	sê-me	t'mija ¹⁷	sime	të mia

Tabela 5.

Veta I					
Rasa	a. Te Mjeda			b. Në gjuhën standarde	
	Pronori			Pronori	
	Njëjës	Shumës		Njëjës	Shumës
	Gjinia femërore			Gjinia femërore	
E.	jo-në	to-në	tonë	tona	
Gj.Dh .	sa-në	to-nave	sonë	---	
K.	tâ-në	to-na	tonë	---	
Rr.	so-në	so-nash ¹⁸	sonë	---	

Tabela 6.

Veta II					
Rasa	a. Te Mjeda			b. Në shqipen standarde	
	Pronori			Pronori	
	Njëjës	Shumës		Njëjës	Shumës
	Gjinia femërore			Gjinia femërore	
E.	jo-te	tua	jote	e tua	
Gj.Dh .	sa-te	t'tua	sate	të tua	
K.	tan-de	tua	tënde	e tua	
Rr.	so-te	t'tua ¹⁹	sate	të tua	

Siç del edhe nga tabelat e mësipërme, në paradigmën e pronorëve të shqipes së sotme, në krahasim me gjendjen e tyre në veprën e Mjedës, bien në sy ndryshime të dukshme. Një tjetër çështje që mbetet për t'u sqaruar lidhur me elementin e parë të këtij pronori është, se në rasën emërore të gjinisë femërore njëjës del me formën: *ême*. Sipas Sh. Demirajt –e-ja në këtë formë është shtrirë për analogji nga rasa emërore dhe në rasat gjinore-dhanore e rrjedhore me formën *sême*, si p.sh.: *Mi thuei nanës s'ême* (Vepra 1: 28); *Afer shpiës s'ême*, etj. Sipas Becit (1995:52) format *djali jem (em)*, *vajza jeme (eme)* të emërores së pronorit të vetës së parë, prona dhe pronari njëjës. Këto forma sipas tij janë dëshmuar edhe në të folme tjera.

Në rasën kallëzore del forma *tême*, ndërsa në shqipen e sotme del *time*, si: *shoqen time*. Pra, forma e këtyre shembujve, që dalin brenda korpusit tonë me fundoren -e, nuk është e kryehershme, sepse autorët e vjetër veriorë format përemërore të këtyra në rasat gjinore-dhanore dhe rrjedhore të këtij pronori, shton Demiraj, dalin me -i, si për gjininë mashkullore (*tim*, *sim*), ashtu edhe për gjininë femërore (*sime*).

E njëjta vlen edhe për format e ndryshme rasore të elementit të parë të të njëjtit pronor për gjininë femërore. Pra, në rasën emërore jonë, si: *Ushtrija e jonë mbas leprave Greqijet* (Lissus: 101). *Këjo tokë e jona* (Vepra 3: 8). Në rasën gjinore-dhanore del *sanë*, me zanoren -a, e cila në gjuhën e sotme ka pësuar apofoni, si: *shoqes sonë*.

Forma rasore të përmrit pronor të vetës së dytë njëjës për gjininë femërore jote, si: *Shpija e jote gadi mbërriti* (f. 53). Sipas Çabej (1986: 104) ...elementi -e, si te *jote*, është sekundare, dhe përdoret për të karakterizuar më fort femëroren. Në të vërtetë sot thonë *motra jote*, por edhe *got motër*. Domethënë, dallimi bëhet me elementin e parë yt, që përcakton gjininë mashkullore dhe jote gjininë femërore.

Forma rasore e përmrit pronor të vetës së parë shumës del: **e mija**, pra merr edhe tingullin -j për antihiatizim, si: *I hekrave t'mija* (Juvenilja: 47); *Edhe un kopshtije t'mija* (Po aty, 50), etj. Te forma rasore e përmrit pronor të vetës së dytë shumës për gjininë femërore Mjeda përdor formën **tua**. Në këtë rast krahasuar me shqipen standarde del me mungesë të njëjës -e. Ndërsa format: *tuej-tuja*, si p.sh: *Para se në fusha të tûja* (f. 103); *Halldup për t'zeza t'tuja* (f. 95), janë të shpeshta.

Lakimi i përemrave pronorë

Lakimi i pronorëve në bashkëvajtje me emrat e shquar në vetën e parë të gjinisë mashkullore dalin, si: *ky asht kali im, strajca e kalit të tim, bjeri kálit tim, merre kalin têm, largou kalit sim* (Mjeda, 1934: 27). Përemri pronor ka forma të veçanta për të tri vetat e për të dy numrat. I shoqëruar ose jo me emër, ai lakohet në të gjitha rasat (Memushaj, 2011: 74).

a) Në bashkëvajtje me emra të shquar çfarëdo:

Veta e parë njëjës		
Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	vendi im	shpia e ême
Gj.Dh.	vajit t'im	nanës seme
K.	kalin têm	shpín tême
Rr.	kalit sim	shpís s'ême

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	kali ynë	shpia e jonë
Gj.Dh.	kalit tine	shpís sane
K.	kalin tânë	shpín tânë
Rr.	kalit sine	shpís s'onë

Veta e parë shumës		
Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	djelmt e mí	dít e mija
Gj.Dh.	djelmvet t'mí	ditve t'mija
K.	djelmt e mí	dít e mija
Rr.	djelmsh t'mí	ditve t'mija

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	kualt e tanë	shpíjat e t'ona
Gj.Dh.	kalve tine	shpíjavet t'ona
K.	kualt tyt	shpíjat t'ona
Rr.	kualsh sine	shpíjash s'ona

Shënim. Krahas trajtës së përgjithshme *tët*, për vetën e dytë në gjinore-dhanore, në veprën e Mjedës përdoret edhe *tyt*, si: *Shurdh a vendi e shpíja tytë* (Andrra Jetës, 1962: 72), etj.

Veta e dytë njëjës		
Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	vendi i jot	puna e jote
Gj.Dh.	vorrit tand	lokes sate
K.	zanin tand	fytyrën tände
Rr.	prej gjumit t'tanë	prej shprijës sate

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	djali i juej	shpija e juej
Gj.Dh.	djalit t'uejve	shprijës t'uej
K.	djalit t'uej	shpin t'uej
Rr.	djalit t'uejve	shprijës t'uej

Veta e dytë shumë		
Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	djelmt e tú	fushat e tua
Gj.Dh.	djelmvet t'tu	fushavet t'tua
K.	djelmt e tú	fushat e tua
Rr.	djelmvet t'tu	fushash t'tua

Rasa	Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
E.	djelmt t'uej	ndërtesat t'tueja
Gj.Dh.	djelmvet t'uej	fushavet t'ueja
K.	djelmt t'uej	fushat t'tueja
Rr.	djelmvet t'uej	fushash t'ueja

Pronorët e vetës së tretë, kur ndodhen në bashkëvajtje me emrin shprehin kuptimin e numrit të pronarit a të pronës dhe kuptimin e gjinisë së pronës dhe të gjinisë së pronarit të vetës së tretë njëjës, si p.sh.: *Mbas tij me qiri n'dorë; Prej kendej, n'dore t'tij veton (f. 95); E kurrqja n'ankime t'tija (Juvenilja: 52); fetyra e sajë (f. 38); E zani i saj lajthim (f. 94), etj.*

Sipas Bokshit (2005: 158), „Pronorët e vënë vetën në funksion të varur sintagmatik, prandaj ata janë zëvendësues mbiemërorë, që e mbajnë rendondant kuptimin e pronës të shprehur në emër a më përemër dëftor: *djali im: ky im bir*”. Njya e përparme e emrave të lashtë të farefisit: *i biri, e bija, të bijtë*, që sipas Bokshit (2004: 15), janë në distribucion me pronorët e vetës së tretë: *biri i tij /i saj/ i tyre*. Sipas Demirajt (2015:193), relativisht më të rinj janë pronorët e vetës së tretë *i tij, i saj, i tyne/ i tyre* dhe *i vet*.

Përemri pronorë *juej/ t'uej, t'uej*. Kjo formë e këtij përemri te Mjeda del me apostrof, si: *t'uej*, p.sh.: *Mbi krahë t'uej (f. 70); Nana mordë, po i lutet, se t'uejtit (f. 61); Ndoshta kujdesi i t'ujve (Juvenilja: 33); T'zezati t'ujja s kan mbarim (Po aty, 35).*

Përmri pronor i vetës së tretë shumë në veprën e Mjedës del *tyne*, si: *E npër dritë t' tyne xhixhillim si shkëndija* (Lissus, 1962: 101). Ndryshe nga përmrat e numrit njëjës, që dallohen për gjininë e tyre, përmri i numrit shumë përdoret pa ndryshim gjinie (Topalli, 2008:134).

Sipas Topallit (2008: 194), formimi i përmrave pronorë të shqipes është një dukuri e fonetikës sintaksore, por në një kohë të mëvonshme për krijimin e shumë përmrave ka vepruar analogjia gramatikore duke u krijuar këta përmra me rrugë mekanike.

Duke u mbështetur në shembujt e eksploruar nga të gjitha veprat e Mjedës, krejt në fund të këtij shqyrtimi mund të konstatojmë, se kur krahasohen format e të gjitha vetave të përmrave pronorë në veprën e Mjedës me përmrat pronorë të shqipes së sotme standarde, ndryshimet sidomos në strukturë janë evidente, por duke e ruajtur të paprekur semantikën e tyre.

Literatura

1. BECI, Bahri (1995): *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shodrës*, Tiranë: 52;
2. BOKSHI, Besim (2004): *Për vectorët e shqipes*, ASHAK, Prishtinë: 15;
3. BOKSHI, Besim (2005): *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë: 158;
4. DEMIRAJ, Shaban (1988): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë: 238-485;
5. DEMIRAJ, Shaban (2015): *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, (botim i dytë i përmbledhur), Tiranë: 193;
6. DEMIRAJ, Shaban (1980): *Morfologjia historike e gjuhës shqipe I-II*, Enti i teksteve..., Prishtinë;
7. *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHRSH, Tiranë: 232-238;
8. MEMUSHAJ, Rami (2011): *Shqipja standarde*, Tiranë: 74-77;
9. MJEDA, Ndre (1934): *Vrejtje mbi artikuj e prëmnat pronës të gjuhës shqipe*, Shkodër. 24-27;
10. MJEDA, Ndre (1962): *Vjersha dhe poema*, Beograd;
11. MJEDA, Ndre: *Vepra 1, 2, 3*;
12. QUKU, Mentor: *"Mjeda3" Libri i parë Alfabeti* (1899-1912);
13. RIZA, Selman (2002): *Vepra 3*, ASHAK, Prishtinë: 258;
14. TOPALLI, Kolec (2008): *Evolucioni historik i përmrave të shqipes*, Tiranë. 134-194;

Shënime:

- 1) Ndre Mjeda, vep. e cit., f. 26;
- 2) Ndre Mjeda, vep. e cit., f. 26;
- 3) Po aty, f. 26;
- 4) Ndre Mjeda, Vep. e cit., 1934, f. 27;
- 5) Po aty, f. 27;
- 6) Ndre Mjeda, vep. e cit. 1934, f. 27.

Për një gjuhë të përbashkët (koiné) arbëreshe

Veçori të sistemit foljor në Gramatikën e Emanuele Giordano-s

Manjola Lubishtani, MSc.

Universiteti AAB, Prishtinë

Të folmet arbëreshe shfaqin një sistem të larmishëm të trajtave foljore. Në *Gramatikë Arbëreshe* (2005) E. Giordano, duke e konsideruar foljen si “shtyllën kurrizore” të një gjuhe, me qëllimin e vetëm për të krijuar një gjuhë të përbashkët dominuese mbi variantet ekzistuese në të folmet arbëreshe pasqyron ato trajta foljore, të cilat shfaqen si të njëjta ose të afërta me gjuhën standarde shqipe, por duke u kujdesur që të shënojë në kllapa edhe disa nga format e t jera më të përhapura, p.sh.: *isha (ishnja,inja); shkoja (shkonja); këndojëm (këndomi, këndojmë) etj.*¹ Kështu, Giordano radhit kategoritë gramatikore të foljes në arbërishte duke filluar me diatezën, të cilën nuk e emërton si të tillë, por e shtjellon duke dalluar tri forma të saj: 1) veprorë; 2) pësore; 3) vetvetore.

Në diatezën veprorë autori klasifikon: a) *foljet kalimtare*, të cilat emërtojnë veprime që kalojnë nga subjekti te objekti, si: *bënj, këndonj, qepënj, kruanj, mbanj, ha...* dhe b) *foljet jokalimtare*, të cilat emërtojnë veprime që mbeten tek ai që i kryen (subjekti), si: *shkonj, shkas, vete etj.* Në diatezën pësore ai klasifikon të gjitha ato folje, të cilat emërtojnë veprime që i pëson subjekti, si: *jam larë, jam krehur etj.* Siç shihet, Giordano nuk ofron shembuj paradigmatsh të foljeve në kohët e thjeshta, por vetëm në kohët analitike, të cilat janë formuar nga folja ndihmëse *jam+ pjesore*. Vetë pjesëmarrja e foljes *jam* në cilësinë e foljes ndihmëse na jep të kuptojmë që autori në këtë kategori, edhe pse nuk e thekson, përfshin foljet e formës joveprorë kundrejt diatezës veprorë, në të cilën janë klasifikuar folje të formës veprorë. Foljet e formës joveprorë në kohët e thjeshta do të klasifikohen nga autori në grupin e diatezës vetvetore. Mirëpo, krahas shembujve në diatezën vetvetore: *lahem, kruhem, krehem*, shembujt e dhënë *jam larë, jam krehur* do të duhej të përfaqësonin të njëjtën diatezë, pasi ajo (diateza vetvetore) ngërthen të gjitha ato folje që emërtojnë veprim, të cilin kryefjala e fjalisë e kryen dhe e pëson njëkohësisht.²

** * Kategoria gramatikore e mënyrës

E. Giordano radhit tetë mënyra të foljes në arbërishte³: pesë prej tyre (m. dëftore, m. lidhore, m. kushtore, m. dëshirore dhe m. urdhërore) përkojnë me mënyrat e foljes në shqipen e sotme, ndërsa tri të tjerat, të trajtuara si: m. paskajore, m. pjesore dhe m. përcjellore, janë realisht format e pashtjelluara foljore të emërtuara me të njëjtën terminologji e të shfaqura me të njëjtën strukturë. Karakteristike është përdorimi i trajtave gege, krahas atyre toske në të tria format e pashtjelluara: a) paskajore: *për të (me) pasur / për të (me) pasë pasur*; b) pjesore: *pasur (pasë, patur)*; c) përcjellore: *tue (ture, tuke, kute, duke) pasur / tue (ture, tuke, kute, duke) pasë pasur*.

Siç dihet, në të folmet arbëreshe mënyra habitore mungon, fakt ky që vihet në dukje nga vetë autori⁴ gjatë paralelizmit të veçorive gjuhësore arbëreshe me ato të shqipes standarde.

** * Kategoria gramatikore e kohës

Giordano i klasifikon kohët e foljes duke i ndarë në dy grupe me nga katër kohë:

a) **kohë të thjeshta**: koha e tashme, koha e pakryer, koha e kryer e thjeshtë, koha e ardhme e thjeshtë; b) **kohë të përbëra**: koha e kryer, koha e kryer e plotë, koha e kryer e tejkaluar, koha e ardhme e përparme. Kategorizimin e tyre sipas mënyrave të foljes ai e bën gjatë parashtrimit të shembujve të zgjedhimit të disa foljeve përfaqësuese. Duhet theksuar këtu se klasifikimi i nënkohëve foljore është identik me atë që ndiqet në shqipen e sotme, me përjashtim të dy kohëve të mënyrës dëftore (e ardhmja e së shkuarës dhe e

ardhmja e përparme e së shkuarës), të cilat janë forma gramatikore homonimike me ato të mënyrës kushtore⁵. Po ashtu, edhe kur u referohet formave të pashtjelluara foljore, të cilat autori i ka klasifikuar si mënyra më vete, Giordano paraqet dy forma gramatikore nga të cilat, e dyta, haset si një formë e mbipërbërë⁶ që konvencionalisht mund të quhet *kohë e kryer* e paskajores: *për të (me) pasë pasur* dhe e përcjellores: *tue (ture, tuke, kute, duke) pasë pasur*, duke iu kundërvënë formave të zakonshme të tipit *për të (me) pasur / tue (ture, tuke, kute, duke) pasur*; të cilat do të quhen kohë e tashme e paskajores, përkatësisht e përcjellores. Ndërsa për pjesoren, autori njih formën e tipit *pasur (pasë, patur)* të cilën e trajton si formë gramatikore të kohës së kryer.

** * Klasifikimi i foljeve në zgjedhime

Si kriter të klasifikimit të foljeve në zgjedhime, Giordano konsideron tingullin fundor (përkatësisht tingujt fundorë, kur bëhet fjalë për tog zanoresh) të temave foljore. Në bazë të këtij kriteri foljet ndahen në dy zgjedhime, të cilat ndahen më pas në nëngrupe.

I. Në zgjedhimin e parë autori klasifikon foljet, tema e të cilave del më zanore ose tog zanoresh: *këndonj, shkonj, punonj, ha, pi, flë; luanj, lyenj, shqyenj, zienj*.

II. Në zgjedhimin e dytë përfshihen foljet me temë në bashkëtingëllore. Këto folje autori i kategorizon në tri klasa: a) Klasa I përfshin foljet që në vetën e parë e të dytë njëjës të kohës së tashme e të pakryer dalin me temë më bashkëtingëlloren **-t**, p.sh.: *lutënj, këputënj, shkas / shket, thërras / thërret, shkit...*; b) Klasa II përfshin foljet, tema e të cilave del më çfarëdolloj bashkëtingëlloreje të paraprirë nga togu **-ie, -je**, p.sh.: *siell, viell, pjek, mjel...*; c) Në klasën III bëjnë pjesë të gjitha foljet, tema e të cilave, në vetën e parë e të dytë të kohës së tashme e të pakryer, del më çdo bashkëtingëllore, përveç asaj **-t** dhe rasteve kur paraprihen nga **-ie** ose **-je**, p.sh.: *nis-ënj, shkund-ënj, qesh-ënj, trëmb-ënj, puth-ënj* etj.

Si kriter dallimi për foljet e parregullta, të cilat i klasifikon në grup më vete, Giordano thekson trajtat e tyre në kohën e kryer të thjeshtë dhe në kohën e pakryer të mënyrës dëftore; trajtat e mënyrës urdhërore dhe rastet kur ato dalin në pjesoren. Në këtë grup ai radhit këto folje: **ha-** *hëngra, haja, ha, ngrënë*; **vë-** *vura, vëja, vërë, vënë*; **vinj-** *erdha, vija, eja, ardhur*; **shoh-** *pashë, shihja, shih, parë*; **dua-** *desha (disha), doja, duaj, dashur*; **vier-** *vora, virja, vir, vjerrë*. Si *folje të parregullta* autori i konsideron edhe foljet “kam” e “jam”, kur nuk përdoren si folje ndihmëse për krijimin e kohëve të përbëra: **kam-** *pata, kisha (kishnja, kinja, keshja), ki (kij), pasur (pasë, patur)*; **jam-** *qeva, isha (ishnja, inja...), ji, qënë (qënur)*.

** * Format gramatikore të mënyrës dëftore

a) Koha e tashme: Në këtë etapë autori thekson praninë e mbaresës së lashtë “-nj” në vetën e parë njëjës në vend të asaj “-j”, tipike për foljet e zgjedhimit të parë në shqipen standarde. Kjo mbaresë, si tipar i trashëguar nga toskërishtja, e që aktualisht haset në toskërishten veriore⁷, është tipike për foljet me zanore të tipit *shkoj, punoj, këndonj, luaj, lyej, ziej* etj., të cilat në vetën e parë njëjës dalin në këto trajta: *shkonj, punonj, këndonj, luanj, lyenj, zienj* etj. Në vetat e tjera marrin mbaresat **-n, -n, -mi (jëm / njëm), -ni, -jën**: Njëjës: *shkonj, shkon, shkon / shkruanj, shkruan, shkruan*.

Shumës: *shkomi (shkojëm, shkonjëm), shkoni, shkojën / shkrua(j)mi, shkruani, shkruajën*

Foljet e tipit *ha, pi, fle (flë)* në tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresë, ndërsa në shumës marrin mbaresat **-mi, -ni, -në**:

Njëjës: **pi, pi, pi**; Shumës: **pimi (pimë), pini, pinë**

Edhe te foljet e zgjedhimit të dytë, përkatësisht të klasës I e III, mbaresë *-nj* është e pranishme në trajtat e vetës së parë njëjës: *lutënj, hapënj, këputënj; nisënj, shkundënj, qeshënj, trëmbënj, puthënj* etj. Në vetat e tjera ato dalin me të njëjtat mbaresë si foljet e zgjedhimit të parë të tipit *shkoj / ziej*:

Njëjës: **lutënj / hapënj, lutën / hapën, lutën / hapën**

Shumës: **lutmi / hapmi, lutni / hapni, lutjën / hapjën**

Foljet e klasës së dytë të tipit *viell, siell, pjek, djeg* në tri vetat e njëjësit nuk marrin mbaresë, ndërsa në shumës dalin me këto mbaresa: **-mi, -ni, -ën** që, siç shihet, janë të njëjta me ato të trajtave foljore të zgjedhimit të parë.

Një formë mjaft të përhapur paraqet edhe ekzistenca e trajtave analitike *jam e vinj* dhe *jam po të vinj*, të cilat tregojnë vazhdimësinë e veprimit. Këto trajta Kamarda i ka parë si të barasvlershme me gerundin e italishtes (*sto + gerund: sto venendo*). Lidhur me këtë, M. Hashani ⁸ arsyeton se “pa mohuar një ndikim të mundshëm nga kjo trajtë e italishtes me të cilën të folmet arbëreshe bashkëjetojnë prej pesë shekujsh... na duket e domosdoshme të kthejmë sytë dhe të marrim parasysh edhe dritën që lëshon mbi to krahasimi me simotrat e tyre në të folmet e tjera arbëreshe”. Si trajta argumentuese ajo ofron formën analitike të tipit *jam + që (lidhëz)+ folje* që shpreh kuptimin themelor: *jam që laj duart*, formë e cila haset në të folmet e skajit jugor të shqipës (e folmja e Labovës së Kryqit në lokalitetin e Libohovës- Gjirokastër), të cilën e lidh me trajtën *jam ç lanj* në të folmen e Grecit (kraha e Avelinos). Hashani e shtrin krahasimin e këtyre trajtave deri te format analitike të tipit *jam ka shkoj, kjeç ka shkoj* te disa të folme të gegërishtes veriore, duke i parë si të ngjashme nga forma dhe krejt të njëjta nga kuptimi me ato të të folmeve arbëreshe. Si rrjedhojë, ajo mbështet bindjen se këto trajta do të jenë marrë prej Shqipërisënga vetë arbëreshët, duke e pasur zanafillën brenda trungut të shqipës ⁹.

b) Koha e pakryer: Siç shihet, njësoj si në shqipen standarde, në të folmet arbëreshe trajtat e vetës së dytë shumës si te foljet me zanore, ashtu dhe te ato me bashkëtingëllore ndërtohen me mbaresën **-ni**: *shkoni, shkruani, pini, hapni, villni* etj. Për dallim nga shqipja standardenë të folmet arbëreshe, përkatësisht në trajtat e vetës së parë shumës haset dukuria e shndërrimit fonetik *ë > i = mi*, e pranishme si te foljet me bashkëtingëllore (*lutmi, vjellmi, hapmi* etj.), ashtu edhe te ato me zanore (*shkrua(j)mi, shkomi, pimi* etj.). Lidhur me këtë, Gj. Shkurtaj ¹⁰ thotë se “në të folmet arbëreshe nga *marrmë* te *marrmi* kemi të bëjmë me kalim të drejtpërdrejtë *më > mi*, ndërsa te *marrim* (trajtë e shqipës së sotme) procesi i kalimit *ë > i* ka ardhur pas një metateze të *marrmë > marrëm*, prej nga më pas ka dalë *marrim*.

Të ndryshme paraqiten edhe trajtat foljore të vetës së tretë shumës. Përkundër trajtave me **-jnë, -në** te foljet me zanore (*luajnë, dinë* etj.) dhe me **-inte** foljet me bashkëtingëllore (*kapin, marrin* etj.) karakteristike jo vetëm për shqipen standarde, në foljet e zgjedhuara hasim trajtat me mbaresën **-jën** për foljet me zanore të tipit *shkoj, shkruaj* (si dhe te foljet me bashkëtingëllore të tipit *lut, hap*) dhe me **-ën** për foljet me bashkëtingëllore të tipit *viell, siell* etj. Në pasqyrimin që autori u bën trajtave foljore të kohës së pakryer vëmë re se për dy vetat e para të njëjësit dhe për tri vetat e shumësit mbaresat si për foljet me zanore, ashtu dhe për ato me bashkëtingëllore janë të njëjta: **-ja, -je, [-nij]; -jim, -jit, -jin** ¹¹. Përrjashtim bën veta e tretë njëjës e foljeve të tipit *viell*, te të cilat mbizotëron trajta foljore *vill* ose te foljet me zanore të tipit *pi*, te të cilat, krahas trajtës me mbaresën **-nij** që jepet si trajtë alternative *pinij*, ekziston edhe trajta e formës *pij*. Interesante dhe pothuajse identike me format standarde paraqitet edhe zgjedhimi i foljeve *kam* dhe *jam*. Veta e tretë njëjës karakterizohet nga trajta foljore apokopike **kishte > kish** dhe **ishte > ish**: *kisha (kishnja, kinja, keshja), kisha, kish / isha (ishnja,inja...), ishe, ish*, ndërsa format e shumësit, pa trajtat alternative, janë të njëjta me standardin ¹².

c) Koha e kryer e thjeshtë: Në trajtat foljore të kohës së kryer të thjeshtë, të cilat dalin me temë më zanore, dominon aoristi me mbaresën **-va**, ndërsa për foljet e zgjedhimit të parë, tema e të cilave del më tog zanor hasen trajtat me **-ta**: *piva* vs. *shkruajta*, mbaresë kjo sipas J. Gjinarit ¹³ tipike po për çamërishten. Do theksuar këtu ekzistenca e trajtave foljore të tri vetave të shumësit, të cilat dalin me mbaresat **-tim, -tit, -tin** si te temat me zanore, ashtu dhe te ato me bashkëtingëllore: *shkruajtim, shkruajtit, shkruajtin / lutim, lutit, lutin / vulltim, vulltit, vulltin / haptim, haptit, haptin*. Përrjashtim, në zgjedhimin e dhënë nga Giordano, bën folja *pi*, te e cila të gjitha trajtat foljore të aoristit janë identike me ato të shqipës së sotme: *piva, pive, piu; pimë, pitë, pinë*. Forma të njëjta me standardin dëshmojnë edhe paradigmat e një sërë foljesh, të cilat autori i ka klasifikuar në tabela sipas veçorive kategoriale të tyre, p.sh.: *rri – ndënja; ha – hëngra;*

vë – vura; vete – vajta; bie – rashë; dua – desha; shkas – shkava; pres – prita; thom (them) – thashë; jap – dhashëdhe trajtat e apofonizuara: tier – tora; djeg – dogja; flas – fola.; dal – dolla; marr – mora.

ç) **Koha e ardhme:** Giordano vë në pah dy mënyrat e formimit të këtyre trajtave foljore: a) folja ndihmëse “kam” (e cila ndryshon në veta e në numër) + *lidhore* me pjesëzën të, p.sh.: *kam të këndonj, ke të shkruash, kin’ të hani*; b) me foljen *kam* + *lidhore* pa pjesëzën të, p.sh.: *kam këndonj, kam pi, kin’ hani* etj. Edhe format perifrastike të së ardhmes së përparme shfaqin të njëjtën strukturë: folja *kam* + *e kryera e lidhore* me ose pa pjesëzën të: *kam të kem pasur, ke të kesh qenë; ka (të) ketë lutur, kem (të) kemi shkuar, kan’ (të) kenë pirë* etj. Në të gjitha rastet folja “kam” shfaq trajta të pangurtësuar¹⁵ (në vetë e në numër), duke dalluar nga të folmet e tjera të arbëreshëve të Italisë te të cilët kjo folje shfaqet në formën e ngurtësuar të vetës së tretë njëjës “ka”¹⁶. Krahas trajtave të mësipërme perifrastike, Giordano ka paraqitur edhe trajtat e rralla alternative të së ardhmes me *do* + *lidhore* të cilat, në të folmet arbëreshe, kanë kuptimin e futurit volitiv¹⁷, d.m.th për të shprehur një dëshirë a një veprim që duam ta kryejmë. Në këtë kontekst ato e ruajnë kuptimin “dua”, “dëshiroj”: *do (të) martohem = dua të martohem*¹⁸.

Sipas autorit, e ardhmja shprehet edhe me format e së tashmes, sidomos kur gjenden pranë ndajfoljeve të kohës. Dukuria e formimit dhe e përdorimit të së tashmes së dëftores me vlerën e së ardhmes është tipike jo vetëm në të folmet arbëreshe, por në mbarë shqipen.

Format e tjera analitike, ashtu si në shqipen e sotme, formohen me ndihmën e foljeve ndihmëse *kam* e *jam*, të cilat zgjedhohen sipas vetës, numrit, kohës e mënyrës + *pjesoren* e foljeve.

** * Format gramatikore të mënyrave të tjera

Gjatë trajtimit të mënyrave të tjera, E.Giordano shpalos disa veçori të tyre, gjithnjë duke i krahasuar me trajtat analoge të standardit. Kështu, nisur nga analiza e zgjedhimit të paradigmave të disa foljeve, konstatojmë se trajtat foljore të mënyrës lidhore, kushtore e dëshirore janë të njëjta me ato të shqipes standarde, p.sh.: **m. lidhore:** *të kem, të kem pasur, të kisha, të kisha pasur*; **m. kushtore:** *do të kisha, do të kisha pasur*; krahas të cilave paraqet edhe trajtat analitike të formuara nga forma e ngurosur “kish” (veta e tretë njëjës e së pakryerës së dëftores): *kish të kisha, kish të kisha pasur*. Giordano pohon se mënyra kushtore (tema foljore që bart kuptimin themelor), gati në të gjitha të folmet arbëreshe, është e njëjtë me të pakryerën e dëftores.

Po ashtu, edhe në zgjedhimin e foljeve në **m. dëshirore**, autori paraqet dy trajta: njëra identike me trajtat e standardit *paça, paç, pastë, paçim, paçit, paçin*; dhe tjetra si një formë alternative paraardhëse, tema e së cilës është formuar nga alomorfi –fsh-: *patsha, patsh, pattë, patshim, patshit, patshin*.

Si forma të vetat **m. urdhërore** ka vetëm trajtat e vetës së dytë, njëjës e shumës. Vetat e tjera, thekson Giordano, zëvendësohen nga format e vetës së tretë të së tashmes së lidhore, të prira ose jo nga pjesëza “le (je, e)”: *le (je, e) të vinjë*, të cilat përdoren me vlerën e urdhërores. Sipas autorit, përsëritja e trajtës së foljes në vetën e dytë (njëjës ose shumës) të kësaj mënyre: “*këndoni e këndonj e ju thahet goja*” nënkupton edhe formën e gerundit: *duke kënduar ju thahet goja*.

Në fund, autori pohon mosekzistencën e formave gramatikore të **m. habitore**, duke e theksuar praninë e kësaj mënyre si tipar të shqipes standarde e jo të të folmeve arbëreshe.

Shënime:

1) E. Giordano, Gramatikë Arbëreshe, 2005, f. 9;

2) Po ai, f. 54;

3) Gramatika e Akademisë I, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 271.

4) Klasifikim të ngjashëm hasim edhe te L. de Rosa, Elementi di grammatica Albanese, 2005; G. Gerbino, Grammatica della parlata arbëreshe di Piana degli Albanesi, 2009.

5) E. Giordano, Grammatica..., f. 55.

6) Gramatika e Akademisë I, f.295.

- 7) Po aty, f. 301.
- 8) J. Gjinari, Dialektologjia shqiptare, Dispensë, Tiranë, 1970, f. 81.
- 9) M. Hashani – Hoshafi, Sistemi foljor në veprën e Jeronim de Radës, disertacion i doktoratës, Tiranë, 2012, f. 59.
- 10) Po aty, f. 60.
- 11) Sipas M. Hashanit, punim i cit., f.45.
- 12) Sipas Gj. Shkurtajt mbaresat e shumësit janë të njëjta me mbaresat e trajtave foljore të imperfektit në çamërishte; cituar këtu sipas M. Hashanit, f. 49.
- 13) Shih: Giordano, Grammatica....., ff. 56-57.
- 14) J. Gjinari, vep. e cit., f. 89.
- 15) Shih: Giordano, f. 64.
- 16) Shih: D. Camarda, Saggio di Grammatologia Comparata sulla Lingua Albanese, Livorno, 1864, f. 266.; J. de Rada, Caratteri e Grammatica della lingua Albanese, CoriglianoCalabro, 1894, f. 82.
- 17) Khs.: Luis de Rosa, vep. e cit., ff. 93-94.
- 18) Po ai, f. 93.
- 19) J. Gjinari, vep. e cit., f. 89.

Bibliografia

- Camarda D., Saggio di Grammatologia Comparata sulla Lingua Albanese, Livorno, 1864.
- Gerbino G., Grammatica della parlata arbëreshe di Piana degli Albanesi, 2009.
- Giordano E., Gramatikë Arbëreshe, Manduria, 2005.
- Gjinari J., Dialektologjia shqiptare, Dispensë, Tiranë, 1970.
- Grup autorësh, Gramatika e Akademisë I, ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Hashani – Hoshafi M., Sistemi foljor në veprën e Jeronim de Radës, disertacion i doktoratës, Tiranë, 2012.
- Rada de J., Caratteri e Grammatica della lingua Albanese, CoriglianoCalabro, 1894.
- Rosa de L., Elementi di grammatica Albanese (Variante Arbëreshe del Molise), Rur, 2005.

Përmbledhje

Ky punim, nëpërmjet punës së palodhur e shkencore të albanologut Emanuele Giordano në hartimin e tekstit Gramatikë Arbëreshe, synon të hedhë dritë mbi tiparet e sistemit foljor të të folmeve arbëreshe, veçori këto të cilat autori na i ka ofruar përmes një pasqyre mjaft të pasur të trajtave foljore, format gramatikore të të cilave shfaqin shumë herë bashkëpërkime e struktura të njëjta me ato ekzistenciale në shqipen e sotme. Bashkëjetesa dhe shpërfaqja e trajtave të lashta krahas atyre të reja, të cilat me këmbëngulje klasifikohen nga Giordano, e bën edhe më dobiprurëse njohjen dhe analizimin e larmisë së formave e kuptimeve gramatikore sipas kategorive: diatezë, mënyrë, kohë, vetë e numër.

Pikërisht, qasja e qëllimshme e Giordanos drejt paralelizmit me shqipen standarde e bën edhe më aktual qëllimin jetësor të tij për një gjuhë (koiné) të përbashkët arbëreshe që do të vazhdojë të trashëgohet edhe pas Tij...

Fjalë kyç: sistem foljor, gjuhë standarde, kategori gramatikore, trajta foljore, folje ndihmëse.

Tommaso Campera

(nga Mashqiti / Pz)

Për nderin t'yn zot Giordano Emanuele

Kopshti na duftoj fiqët, çë dukshin nga parathira,
e ndë mest t'lisvat, më zbulova fjalët më t'mira:
ma ato ti shkruajta ligjërata t'hjeshëma e t'urta,
fjalët ma shprehjet më t'ëmbra e më të ngurta.

Apara nëng shkruajan arbëreshët, ti zot i dhe fjala,
t'shkreta, si àrat pa kallli, ata kishan vetam hàla:
bular e zëmërgjer kleva, e pilikaç nëng na lora,
kimi fjalët, ma t'çelat shkruami katunda e hora.

Gjëndështa ahiera Janina, të njihja prifti i miri,
deran tukullova, e shpejt mbë shpi më hiri:
zëmra më muar prifti, një gjë nga më t'rralla,
ndë ajo shpi, ndë ku ngrihshin shumë shkalla.

Ndë hummerat u shpirti kisha, e zëmra i shuar,
atje njoha përrallzan, ndë një ditë turbulluar:
“Mallkimi «tha prifti» të qollan posht ta pisa,
ma parkalesja, nëng u dhënova atë çë stisa?”.

IN ONORE DEL NOSTRO PAPAS GIORDANO EMANUELE - L'orto ci mostrava i fichi, che apparivano dalla finestra, / e in mezzo agli alberi, mi svelasti le parole più buone: / con quelle, tu scrivesti dialoghi graziosi, e saggi, / parole con le espressioni, più dolci, e più dure. / Prima non scrivevano gli arbëreshë, tu padre gli hai dato la parola, / miseri, come messi senza spighe, loro avevano solo ariste: / nobile e generoso fosti, e nudi non ci hai lasciati. / abbiamo le parole, con le qual scriviamo paesi e città. / Mi trovo allora in Ejanina, per conoscere il buon prete, / alla porta bussai, e presto in casa mi fece entrare: / il cuore mi prese il prete, una cosa delle più rare, / in quella casa dove si innalzavano tante scale. / Negli abissi avevo l'animo, ed il cuore spento, / là ho conosciuto la favola, in un giorno oscuro: / “La bestemmia «disse il prete» ti porta giù negli inferi; / con la preghiera, non ti sei accorto cosa ho costruito?”. / Un sabato ci vedemmo, padre, e giù dall'altare venivi, / nel mentre che io, dalla soglia della porta, a Ginestra entravo: / ci trovammo per una Messa, celebrata a Ginestra, / messa arbëreshe che a Maschito non facevano mai. / Nel mentre che con vesti sante agghindato ti vestivano, / mi vedesti e gli occhi ti si accesero, ti brillavano: / “Senti «mi dicesti» questi qua non li conosco, / e a te, come cometa, apparsa in cielo io ti vedo: / la messa devo dire, scusami, ho vergogna, / sono prete, lo so, ma anche umano, ed ho bisogno!”. / Ti piangiamo, oh padre, ti ricordiamo per ciò che eri, / tutti noi perdemmo qualcosa, e l'ha persa la Chiesa: / ma generoso tu fosti, e svestiti non ci hai lasciato, / abbiamo le parole, con le quali scriviamo paesi e città.

Një t'shtunë u pam, zot, e posht nga autari vija,
ndërkur u, nga praku klishës, Ndërzbur hija:
na u gjem për një mëshë, kremëtuar Ndërzbur,
mëshë arbëreshe, çë Mashqit nëng bëjan kurr.

Ndërkur ma pëtka t'shejta stolisur të vishjan,
më pé e sitë të u dheztin, të llambarisjan:
“Gjegjam - më the - këta këtu nëng i njoh,
e tij, si illi ditës, dukur ndë qialli u të shoh:
meshan kam të thom, ndëlem, kamandiri,
jam prift, a di, po jam njerëzor, e kam hëri!”.

Të klami, moj zot, t'mbami mend për atë çë isha,
t'gjithë ne dëburtim gjagjë, e a dëbuar Klisha:
po zëmërgjer ti kleva, e xheshur nëng na lora,
kimi fjalët ma t'çelat, shkruami katunda e hora.

E-mail Drejtorit

Grazie, Agostino!
Edizione-compleanno n.95 del Zot !
Cari saluti a tutta la tua famiglia.
Alicia (Bodily), Usa

Grazie e complimenti
Con affetto
g. (Passarelli) (Roma)

Tè haristis shumë.
Nani duhet t'e djovas/lexoj gjithë "librin".
Pali (Borgia), Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Ju pergezoi per kete numer dhe ju uroj pune sa per te mbare per numrin e ardhshem.
Me te mira,
Elidon. /Dodaj), Tiranë

Z. Giordano,
falemnderit për nr. 79 të “Jetës arbëreshe”.
Ua kam dërguar edhe disa miqve e kolegëve të mi!
Është një numër përkujtimor shumë i mirë për zotin Emanuele Giordano.
Emil (Lafe)

E mora. Haristis.
Të fala,
Zefi (Schirò Di Maggio)

I dashuri Gustin, kam marr Jeten 79 e të hiripsi për dhuratën çë më bëre. Jam vurtetë i lumt sa të lexonj gjithë ata çë zoti Manoll shkruati për arbëreshët e gjithë ata miq çë e kujtuan nani çë nëng është më me ne. Jam edhe i bindur se zotin Manoll nëng e harron mosnjeri. Shumë të fala.
Karmenuci (Stamile (ka Shën Japku,Cs)

Shumë i nderuari Agustino,
Së pari të përgëzoj për daljen e numrit 79 të revistës Jeta Arbëreshe. Me të vërtetë ke bërë shumë punë e mund, por suksesi nuk të mungoi dhe them me plotgojën, se Zotit Lalë ia ke ngritur përmendoren më të ndritur të jetës dhe veprës së tij. Unë kur i lexova gjithë ato kujtime për personalitetin dhe përkushtimin e tij për të bërë në tërë shkencën, kulturën dhe

mbajtjen gjallë të rritit bizantin, më rrëqetëj i tërë kurmi.
Zoti Manuil do të na mungojë, por ne duhet ta ruajmë kujtimin e tij, duke ia studiuar tërë veprën e tij, që gjithsesi, ajo është shumë e madhe , shumë e rëndësishme dhe shumë e nevojshme për çdo intelektual të sojtit tonë.(...) Shumë respekt e të fala nga kosovari juaj

Imri Badallaj (Prishtinë)

Falemnderit per revisten. Do ta lexoj me kenaqesi. I perjetshem qofte kujtimi i ketij arberori te madh!
ju pershendes
Merita (Toçila) - Tiranë

Pershendetje z.Agostino!
Ju falem nderit shume per numrin e ri te Jetes. E lexova me nje fryme, pasi brenda saj arrita te njoh e te mesoj me shume per vepren qe la pas xhaxhai juaj. Une nuk ju kam derguar mesazh ngushellimi (dhe kjo jo nga indiferenca per humbjen tuaj), por kam preferuar qe kete ta shpreh ne menyren time: Gramatiken e z. Emanuele e kam te vendosur ne nje vend mjaft te dukshem ne biblioteken time. Eshte gramatika e pare qe me eshte dhuruar nga mentori im, prof. dr. Imri Badallaj. Ky tekst gramatikor eshte dhe do te mbetet shenja me e forte lidhese me Arberishten dhe veçorite e saj. Shume here e marr ne duar, e shfletoj, mbaj shenime e kuptoj shumeçka. Por mbi te gjitha, mesazhin qe z. Emanuele na la: Te perpiqemi per nje gjuhe te perbashket- nje koine arbereshe- e cila do te ruhet e te trashegohet edhe pas tij.....
Me shume respekt,
Manjola Lubishtani (Prishtinë)

Carissimo Agostino,
come sempre ti ringrazio per avermi inviato la rivista.
L'ho letta con attenzione, ma questa volta soprattutto con immensa commozione.
Certo del tuo impegno nel continuare l'opera di Zoti Emanuele, affettuosamente ti saluto.
Nicolino Pisarri (Frasnitë,Cs)

Carissimo Agostino,
 solo oggi ho appreso dalla Rivista la triste notizia della scomparsa del caro zoti Emanuele. Le mie più sentite condoglianze a te e a tutta la tua famiglia. Ci mancheranno il suo zelo religioso, il suo forte attaccamento alla Chiesa, il suo lungo impegno pastorale, la sua profonda cultura, l'amore sincero verso l'Arbëria, il suo infaticabile dinamismo che gli hanno consentito di dispiegare con continuità le sue energie in varie direzioni fino all'ultimo giorno della sua vita con risultati da tutti apprezzati. Tutte le sue opere meritano il plauso e la gratitudine di tutti gli Abreshë e il suo ricordo rimarrà radicato profondamente nei loro cuori. Ho apprezzato il fatto che hai dedicato l'ultimo numero della Rivista a ricordare i suoi numerosi meriti e sono rimasto positivamente colpito dalla grande notorietà che a buon diritto circondava la sua figura di sacerdote, studioso e letterato. Sono sicuro che ben difficilmente negli anni a venire potrà sorgere qualcuno in grado di uguagliarlo nelle competenze e nelle capacità. Conosco il tuo profondo attaccamento a Zoti e capisco quanto siano dolorosi per te questi momenti, ma ti sia di conforto sapere che, ne sono sicuro, tu e tutta la tua famiglia siete circondati dall'affetto di tutti coloro che hanno avuto la fortuna di conoscere Zotin e che ora egli sta ricevendo in Paradiso la ricompensa del servo buono e fedele promessa dal Signore. Ti abbraccio con l'affetto e la stima di sempre,

Damiano Piro. (ka Strigari,Cs)

Grazie. occasione di dirvi che, nella citta di Costantinopoli (da 20 anni), non dimentico Ejanina, Zot Emmanuel e la vostra preziosa chiesa.

Picc. sorella Diana. (Costantinopoli)

I nderuar z. Agostino Giordano,
 me të vërtetë që nr. 79 i "Jetës" është mbresëlënës (impressionante) si nga pasuria e lëndës, ashtu dhe nga numri i faqeve. Edhe një herë ju përgëzoj për punën tuaj të kujdesshme. Nisma juaj e re për "Opera omnia" të Emamule Giordanos dhe thirrja e një kuvendi për nder të tij meritojnë jo vetëm lavdërime, por edhe mbështetje e përkrahje të gjithanshme.

(...)

Me urimet më të mira

Emil Lafe (Tiranë)

Shumë i dashuri Gustin,
 shumë i bukur dhe i vlershëm numri i fundit "Jeta Arbëreshe", i kushtuar Zotitl Manol, i cili meriton këtë edhe më shumë. Por, kështu shkon e vete "jeta jonë", si na mbësonej çdoherë Ai në mësimet e tij, pjetë me humorizëm dhe me philozofi. Flamurin e tij me arbëreshët dhe me të folmet e tyre me kulturë dhe me urtësi nani e ke ti në doren e djathtë, dhe duhet t'ë qelljesh përpara, ture vënë bashkë e ture mbajtur t'gjall zërin, vuxhen, që edhe sot na siell mbrënda te zëmrat tona dhe te vatrat tona era e historisë. (...)

Me shendet

A.Bellusci (Frasnitë,Cs)

Falënderonj me të fala dhe urime të ngrohta,
zoti Nikollë (Villotta, Kastërnexh,Cs)

Laureta Petoshati

(nga Vlora)

Këpucë për udhë

Këpucët janë lëvozhga e arrës
që mbrojnë thelbin brenda,
këmbët që i drejton mendja
kur nisin udhë nga malli, halli e gjendja.

Udhë të bëra nga këpucë të larta,
kërcasin në zyra nga trallisja që lë nata,
pispillosten, ngrefosen, sikur s'ka gremisje
dhe ku çdo mbarim duket një rinisje.

Udhë me këmbë që mbajnë bucela, shkarpa,
ndërsa duart me shtiza thurin papushim
më shumë rëndon dhimbja mbi të shkretat brshnja,
si të jenë anije gati për batim.

Këpucë punuar me dorë për foshnjat e njoma,
ndërsa ngrihen e bien kur mësojnë të ecin,
këpucë për fëmijë që i rreh bora e ftoma,
kur shkojnë në shkollë dhe gjumi ka zënë shtetin.

Këpucë për këmbë të hallakatura si mendja,
e pavendosur se nuk di ç'rrugë të marrë,
nga të reja në të vjetra, tak-fak ndryshon gjendja,
kur rrugaçi brenda natës rrëmben statusin shtetar.

Këpucë që xixëllojnë, shtrënguar me qafa,
kur flamur –shpalosur nis një det marshimi,
vringëllojnë armët, shungullojnë pafkat,
toka nis e dridhet në rezonancë tërbimi.

Ndërsa shkojnë vargan kërcasin vullkan,
nga ushtari i thjeshtë te gradat e larta,
çizmet edhe dhëmbët ku armatosur janë,
për hapin e shtrirë, për thirrjet e zjarra.

Këmbë të ënjtura, mavijosura në këpucë,
nga qëndrimi i gjatë në llogore e në llucë,
ç'duhen për këmbë të ngriira kur bëhen të prera,
a vishet me këpucë kutërbimi, era?

Këpucë për paqe, sandale për rrugë të madhe,
drejt Fushës së Yjeve, fundit të botës, diku në Spanjë,
ku Shën Jakobi prehet e mban në gjë një xhixhivalle,
gocën e detit, që e gdhendën valët, siç thanë të parët
tanë.

Këpucë të thjeshta dhe të ngrohta, për një rrugë të
gjatë,
për të shpëtuar shpirtin e trupin në një vend të
shenjtë,
te Kishë e Shën Ndout, ky vend magjik mbi shpat,
me gjuhë pelegrinësh e gjithë Europa flet.

Këpucë, këpucë për rrugën e duhur,
ku thelbi, ku shpirti bëhen më të bukur...

© *Vlorë janar 2014*

Vajzat t'i ngjajnë qepës

Do të ha qepë le të më vijë era,
le të shajë kush të dojë për këtë gjë,
ka një zili vajzash që ua ndjell qepa,
paçka këtë fakt s'e pranon asnjë!

Qepa vjen nga brenda tokës, një pash,
vjen nga dheu, balta e prapë ajo ndrin,
skuqet, nxihet si kurm i vajzave në plazh,
e fërgëllon dritën si të jetë rubin!

Vajzat vdesin për fustane pas trupit,
lyer pas tij, të butë dhe të lehtë,
e duan rrumbullake kupën e gjurit,
të gjitha këto a nuk i ka një qepë?!

Krenaret i fshehin dhimbjet kur vriten
dhe qepa hesht kur thika e copëton,
ato s'e luajnë dot hipokriten,
lot krokodilësh derdh kush lëndon!

Çfarë i vëmë plagës sa hejë që shembemi,
a s'e rrethojmë, e ngjeshim me qepë e kripë?!
A s'duhet që si qepa njerëzve t'u gjendemi,
t'i ngjajmë pakëz qepës e ta pohojmë pa frikë!

© *Vlorë janar 2014*

Giovanni Frate

nga Ruri (Cb)

Shoku krimb

Po mbë këmb kam mall të ngas
Pa kumbor pa martiri
Shpirtin ime u qënj pas
Tjerit flak ngë do t'i di

Ndrose vet e ka me mua
Teku gjëndem ng'i kallon
Ktë ng'e mbanj nderën dua
Ethja ngrin! pas më shkon

Ngrinj drelart popà kta si
Ngë shoh më një bukur drit
Qjellëza drin një zduq me hi
Midhje llatrun koll e putit

Ajëri ndjen mbë bar e bot
Lahet guri ndën ka shiu
Zogu bredh me degën lot
Dridhet lulja qeshën siu

Drinj kta si drelart ka moti
Plot me gaze shend e flet
Brënda djellit ki t'ishi Zoti
Hapet zëmbra fare pet

Kjase krimbi me atë bisht
Dish më thoi pse vet ngë del
Pë t'harroje atë çë ishtë
Gjims e hën ngë bën e djel

Puthën hënza lum e mal
Shtin varëja njëqind re
Ndjehem rregj ngë duhen fjal
Ngost me paqe bie përdhé

Fluturakaz të bekuor
Sa ciptohen me harë
Brënda dheut i cufunoor
Më se krimbi ngë ka hje

Pjesa tija kjeti shkruor
Shekulli ligjën mirë ng'e ndavi
Ng'i dha krimbit një kuror
Gjall ndën dheut ati i ngavi

Prëz ka kpuca del një krimb
Zbithën barkun prjer p'atej
Jo një gaz jo një cimb
Koç dreposht më sheh si nej

Rri si shkëmb ngë thot mosgjë
Vetëm vetëm gjia një i mjer
Të fërtetën ng'e di më
Ktu më duket ke mund bjer

Ti moj krimb di më ke u
Ngë pakzon gjithsej si dele
Humbe ndën pë mos t'bjersh tru
Ng'i përcjell kta tafanele

Rri mbë të kërkon arrësir
Nat e zez e zez si ur
Dish e zëja mbë të mirë
Më prjer bishtin rri si drur

Uei, ti krimb, çë do ka u!
Sa ti shket e dinjën gjith!
Kta pak fjal më dollën... ashtë
I kuq ka turpja prora bith

Bën ke je surd e çikat
Ngë do t'lihesh ka kjò timb
Shket qet qet ngë nxjer mëkat
Je m'i Larti shoku krimb.

AMICO BRUCO - Sempre a piedi amo camminare / Senza fragori senza testimoni / La mia anima porto dietro / Altre ambizioni non voglio conoscere // L'aria odora d'erbe e creta / Si purifica la roccia sotto il temporale / L'uccello folleggia col ramo gioca / Tremola il fiore arride l'occhio // La luna bacia fiumi e monti / Sospinge il vento cento nuvole / Mi sento un re non servono parole / Colmo di pace mi distendo a terra // Di lato alla scarpa spunta un bruco / Arretra il ventre si volge per di là / Non un sorriso non un'insofferenza / A testa bassa mi scruta come nebbia // Sta sulle sue cerca buio / Notte nera nera come tizzone / Vorrei prenderlo per le buone / Mi gira la coda rimane di legno // Forse lui ce l'ha con me / Dove mi trovo non gli va giù / Questo non lo sopporto il rispetto pretendo / Lo sdegno sale! poi mi passa // Lancio gli occhi lassù nel cielo / Pieno di sorrisi ali e foglie / Dentro il sole dovrebbe esserci Dio / S'apre il cuore senza macchia alcuna // Farfalline benedette / Quanto s'atteggiano felici / Dentro la terra sprofondato / Soltanto il bruco non ha senso // Impalato come masso non dice nulla / Solo soletto come un poveraccio / La verità non comprendo più / Qui mi sembra di avere torto // Oh tu bruco che vuoi da me! / Quanto tu strisci lo san tutti! / Queste poche parole mi sono sfuggite... così / Rosso di vergogna mi sono voltato // Alzo gli occhi di nuovo in su / Non ravviso più gran bella luce / La volta celeste lancia un baule di cenere / Invidie ladri tosse e appetito // Forse il bruco con quello scodinzolare / Voleva dirmi perché non esce allo scoperto / Per dimenticare quel che è / Un mezzo lunedì che non farà mai domenica // Il suo destino è stato steso / Il mondo non ha ben distribuito il giusto / Non ha concesso al bruco alcun onore / Vivo sotto terra lì gli è toccato stare // Tu oh bruco ne sai più di me / Non battezi il creato come un pecorone / Ti eclissi lì giù per non impazzire / Non ingoi queste scempiaggini // Fai finta d'essere sordo e cieco / Non vuoi sporcarti in questo immondezzaio / Strisci silente senza inveire / Sei il più Alto amico bruco.

Alessandro Rennis

ka Ungra (Cs)

Lufta e Kosovit

Kur lufta m'zu mbi atij tratùri
adhë nëng dinja ç'ish dhulluri;
nani e di, se pe mëmin – në lot –
jo më mish, ...po gjak me bot !

...Ktu është dora çì m'karicoj,
më atej janë di sy: nëng di çì m'thonë;
më prap është nj'grik e mbullitur ...
... pa një t' thrritur !!!

Nëng di ku jam..., ku kam qindronj
ku mund vete, ku mund shkonj...
Qjo luftë e egir – mua kshtu m'u duk –
m'la të gjall se t'ju lip një tul buk !

Ati im e vëllau i madh
qindruan prapa – kështu m' thanë –
t'i bëjn t' tjerve atë çì m'bën mua:
...po u ktë nëng dua !

Pse nëng di minu si m'e thon;
po ti thrritim me ëmrin e parë,
si m'thrriti mëma...
thuam vet....Kosovár !

(Aprile 1999)

LA GUERRA DEL KOSSOVO* - Non sapevo cosa
fosse il dolore / fin quando – su di un trattore- non
passò la guerra. / Ora so tutto: in lacrime , riesco a
vedere mia madre / non più carne, ma sangue e terra
fumante! //

Qui è la mano che mi accarezzava nel sonno.../ più in
là son due occhi che non so cosa mi dicano; / poco più
indietro c'è una bocca ...serrata /senza un grido !//
Ed io non so più dove sono ; dove fermarmi; dove
andare ! / Questa guerra feroce ha segnato il mio
domani: / mi ha lasciato vivo solo per chiedervi / un
tozzo di pane! //

Mio padre e mio fratello più grande / sono rimasti indietro perché – mi hanno detto – / devono fare agli altri figli
di questa terra / ciò che gli altri hanno fatto a me; /ma io questo non lo voglio,//
perché mi son ridotto a non sapere neppure chi sono. / Dammi tu un nome:...uno qualsiasi. / Anzi...dammi il
nome di un tempo antico, / quello che mi dava mia madre:/ semplicemente...."Kosovàro" " ! //

* *(La poesia fa riferimento al triste episodio di un bombardamento - nell'aprile del 1999 - piovuto per errore
su di una colonna di profughi kosovari).*

Nicola Alfano

ka Shën Pali (Pz)

Gluhet e zëmres

Gluhet e zëmres
janë gluhet më t'ëmljez
çë krijetur ti i xë
e nëk i harron më.

Çë kur ndër fashë ti jé
jat'ëmë të nimren me haré
e ato fjalë tij t'qindronjen
e si nj'ëndrez së t'lëshonjen.

Tue rritur i harron,
ndëper jetës vete e më s'i kulton;
si një cinxull i vjeter i lëshon
e pir shum mot nëk i kirkon.

Ma si shkonjen vitrat e ti je vet
ato fjalë të kultonjen njeter jet:
ato fjal të kultonjen t't'ëmë
e ti prire e je djalë pa kundë.

LE LINGUE DEL CUORE -

Le lingue del cuore / sono le lingue più dolci,/ che da
bambino tu impari / e non le dimentichi più.//

Da quando sei in fasce / tua madre ti parla con gioia / e
quelle parole ti restano / e come un sogno non ti
abbandonano.//

Crescendo le dimentichi / vai per il mondo e più non
le ricordi / come un vecchio straccio li abbandoni / e
per molto tempo non le cerchi. //

Ma col passare degli anni e tu sei solo / quelle parole
ti ricordano un altro mondo: / quelle parole ti
ricordano tua madre / e tu ritorni e sei un eterno
fanciullo.//

Carmine Stamile

ka Shën Japku (Cs)

Shoqes t'ime

Të njoha një ditë me erë e shi,
të njoha kur inja shumë i ri
e ndë zëmër të mbajta ngaherë vurtetë
si një shurbes që nëng gjëndet ndë jetë.

Të desha mirë më shumë se sitë
E mëngu një herë të bëra britë;
Britë nëng t'i bëra mëngu me si
Pëse malli it më nxori nganjë ngulli.

Malli im për tij qe si një lum
Çë poshta qellën gurë shumë;
qe si një erë e stohët që fortë frin
qe si një monotrof që qiellin nxin.

Po qe edhe si një diell që ndë dimër të ngrohu,
qe si një ajër i ngrit që ndë verë të stohu;
qe një zjarr që mua zëmërën më dogji,
qe një prush që mua kurmin më poqi.

Nga ki mall i madh, nga herë i ri,
U lenë tre bij me shumë bukuri;
për këta bij shurbeva natë e ditë
sa të i rritënja me nder vit për vit.

Po tuke shurbier moti shkoi
E pjeqëria hollë e hollë arrvoi;
m'u zbardh lesht e bora edhe fuqit
po malli im për tij ngadita u rrit.

Edhe nani që ti shumë mirë nëng rri
Malli im për tij u bë më i madh e ti e di;
pëse u kujtonj se dashuria e vetë
Mund të shëronj e mund të jap shëndetë.

Kur më ruan me ata të pikulluame si
Ti më mxier, ngaherë, nganjë pokundri;
e kur më qeshën me atë buzë që nëng fjet më
ti më jep fuqi, ditë për ditë, më se një.

U dua sa të rri, për shumë mot, ngaherë mirë
Sa të të ndihni ditë për ditë si kam deshirë;
E kur Zoti Krisht do të të mbjedh si një bijë
U dua sa të kallarem ndë varr bashkë me tij-ë.

A mia moglie

Ti ho conosciuto un giorno con vento e pioggia,
ti ho conosciuto quando ero molto giovane
e nel cuore ti ho tenuta davvero
come una cosa preziosa che non si trova al mondo.

Ti ho voluto bene più dei miei occhi,
e non ti ho tradito neppure una volta;
non ti ho tradito neppure con il pensiero
perché il tuo amore mi ha tolto ogni desiderio.

Il mio amore per te è stato come un fiume in piena
Che trascina verso la valle molte pietre;
è stato come un vento gelido che forte soffia,
è stato come una grande tempesta che il cielo oscura.

Ma è stato anche come un sole che d'inverno ti ha
riscaldato,
è stato come un venticello fresco che in estate ti ha tolto
la calura;
è stato un fuoco che ha bruciato il mio cuore,
è stato una brace che mi ha arrostito il corpo.

Da questo grande amore sempre nuovo,
sono nati tre figli molto belli;
per questi figli ho lavorato notte e giorno
per crescerli onorevolmente anno per anno.

Ma lavorando il tempo è passato
E piano piano è arrivata anche la vecchiaia;
i capelli sono diventati bianchi e le forze sono venute
meno
ma il mio amore per te ogni giorno è diventato più
grande .

Anche adesso che tu non stai molto bene
Il mio amore è cresciuto ogni giorno di più e tu lo sai;
perché io penso che solo l'amore
ti può guarire e ti può dare la salute.

Quando mi guardi con quegli occhi pieni di tristezza
Tu mi togli sempre ogni malinconia;
e quando mi sorridi con quella bocca che non parla più
mi dai forza ogni giorno di più .

Io desidero di stare bene per molto tempo
Per aiutarti ogni giorno come desidero io;
e quando il Signore ti chiama lassù , come una buona
figlia,
io voglio scendere nella tomba insieme a te.

Zef (Sepi) Gallo

nga Shën Marcani (Ta)

U ka bërë e plakë

U ka bërë e plakë
gluha jone.
E, si gjithë të plakët,
ka bjerrë shumë dhëmbë.
Kur thot ndenjë fjalë
nëng kapohët më
kaq mirë.
Denja të vëi dhëmbët
të rea, pë t'e ndienja
ta këshëllur si një herë
pë të më bloj zëmërën
gaz.
E dinjë se këtë
nëng ishtë një punë
e mosgjëuti, por çë
duami se plaka jone
ka pjerri vazë, ka
t'ja vëmi dhëmbët
të rea.

E' INVECCHIATA - E' invecchiata / la nostra lingua./
E, come tutti i vecchi, / ha perso molti denti./ Quando dice
qualche parola / non si capisce più / molto bene./ Vorrei
che mettesse i denti / nuovi, per sentirla / parlata come una
volta / perchè mi si riempisse il cuore / di gioia./ Lo so che
questo / non è un lavoro / da niente, ma se / vogliamo che
la nostra vecchia / torni ragazza, dobbiamo / metterle i denti
/ nuovi.

Linari jet çë shuahët,
bën pak dritë, mbase
vart jet çë sos, ashtu
si sos gjella, kur shëndetja
të len.
Drita bën të shohësh,
shëndetja bën të rrosh.
Shëndetja e drita janë

LA SALUTE E LA VITA - La lampada sta per spegnersi, /fa poca luce, perchè / l'olio sta per finire, così/ come finisce
la vita quando la salute/ti lascia/ La luce ti fa vedere, /la salute ti fa vivere, /la salute e la la luce sono/ come il pane e
l'acqua e, /quando queste due mancano/ noi uomini, volenti o no/ dobbiamo raccogliere i ferri/ e dobbiamo
partire./ Dobbiamo andare in un posto/ dove c'è quiete, forse è/ grande quanto il mare.

Ndë Bekuame

Sa herë, manatët,
nxitu, u ka vajtër
pë këmb me pa këpuce
ndë Bekuame.
Këtu vehëshi jo pë të
lozhi, por pë të lutshi
të bie shi, mos të
thahëshën ullinti, fiqët
e vreshta.
Çë ato thahëshën, vdisëshi
nga ujria.
Ndë të vajtër ndë Bekuame
gra e burra rrahëshën
me tërkuzë lagur e
sëngët të gjakuti shihëshën
pë së llargu.
Mbase Zonja jone dimbëshi
përçë, pas pak mot, shiu
arrëi, me gaz i madhë
të gjithëve.

AL SANTUARIO DELLA BENEDETTA (MADONNA) - Quante volte, la mattina, /in fretta, si è
andati/a piedi senza scarpe/ al Santuario./ Qui si andava non
per/ giocare, ma per pregare/che piovesse, perchè/non
seccassero gli ulivi, i fichi/e la vigna./ Se quelli
seccavano, si moriva/dalla fame./ Nel cammino verso il
Santuario della Benedetta/donne e uomini si
frustavano/con funi bagnate /e i segni del sangue si
vedevano/da lontan./ Forse la Signora nostra si
commuoveva/perchè, dopo poco tempo, la pioggia/arrivava,
con gioia grande/di tutti.

Shëndeta e gjella

si buka e ujët e,
kur këto di mangonjën,
ne krishtere, duami o jo,
kambledëmi hekurët
e ka nisëmi.
Ka vemi nde një vend
ku rrjeshi, mbase ishtë
i madhë sa deti.

Një jetë e re

Fjalët: Francesco Scaravaglione, spixanjot.
Arr.muzikor: Francesco Scaravaglione
Këndoi: Pasquale Bruno, çivitjot (rron Frasnitë).

E kur arrvòi ndë shuràl
 pundàrti ania dal e dal
 e ti, si e lodhur, mbete ati
 sikur e bjërrur, pa liri;
 e qetu qetu, pa një fjalë,
 mbulove sytë prapa një dorë
 e të pështoj një lotë,
 të pështòj një lotë.

Pra u kallàrte bashkë me mua
 e vure këmb te një port i huaj
 ma t'u çel një dritë tek ata sy
 që vura ré oj vetëm u.

-“Ma nëng është drita që vejë e gjëja,
 si ajo 'pjet diell' te Shqipëria!”
 Ma është drita e shuar ka vetmìa... (Rit) (2 herë)

-“Nëng është dera ime,
 nëng është dera jonë,
 ma është sprënxa
 që vjen e na takson
 një jetë e re!”.

Ma ti qindrove qetu qetu
 nëng ruan mua ma ruan detin
 e i kallëzòn njëj suvalë
 një milë mendime, një milë fjalë
 e një premtim se ndonjë menatë
 ke t'shkosh këtë det, ke t'priresh prap
 te Shqipëria: mëma që t'sallvon,
 mëma që të mbron ka vetmìa.

-“Ma nëng është drita që vejë e gjëja...”
 Ma është drita e shuar ka vetmìa. (2 herë)

Seminari XXXIV Ndërkombëtar
i Prishtinës

(17-28 gusht 2015) -

Drejtor: prof.asoc.dr. Rahman Paçarizi,
 Bashkëdrejtor: prof.dr. Aljula Jubani

*Arbëreshë, Lëtinjë dhe Bashkëpunëtorë të 'Jetës
 Arbëreshe' që folin në Seminar:*

Ligjëratë

Zef Chiaramonte: Çështja e gjuhëve amtare te shërbesa e shenjtë Meshari i Gjon Buzukut (1555) një comes në gjuhën shqipe ndërmjet reformës, kundërreformës dhe islamit.

Referime

Innocenzo De Gaudio: Analysis of the forms, mechanisms and transmission of oral sources in Arbëresh traditional music;

Emilia Conforti: Il sistema nominale della parlata albanese di San Benedetto Ullano;

Aleksandar Novik: Shqiptarët në Perandorinë Ruse në shekujt XVIII –XIX: të dhënat e reja në fushën arkeologjike, historike dhe etnografike;

Aleksandar Novik dhe Marina Sulloeva: Dasma ndër shqiptarët e Devollit: materialet etnolinguistike të studimeve shkecore në terren të viteve 2011-2014;

Marcella Giulia Lorenzi: Publications in Italo-Albanian Studies edited by University of Calabria Press (Centro Editoriale e librario);

Tryezë e doktorantëve

Manjola Lubishtani: Zotërimi i normës dejtshkrimore nga nxënësit dhe mësimdhënësit në shkollat fillore;

Kumtesa

(sesioni i gjuhësisë)

Bardh Rugova: Gjuha e shkencës;

Majlinda Bregasi: Përemrat e pushtetit dhe të solidaritetit në ndërveprimin ballë për ballë;

Merita Hysa: Identiteti gjuhësor si mjet përfshirjeje dhe përjashtimi social;

(sesioni i letërsisë)

Edmond Çali: Feja dhe variantet e autorit në romanin Dasma të Ismail Kadaresë;

Bardhyl Matraxhiu foli mbi temë arbëreshe: Misticizmi erotik i De Radës.

'Vjershe lipi' të zotit Bernardo Bilotta (Frasnitë 1843-1918)

Këta Sonete Lipi, njera sot dorëshkrime, gjënden te Kuaderni I (format 15x20 cm., fleta 66, faqe 132, të pasingëara ka autori), ku janë mbledhur të tjerë sonete e ndryshe poezi, të gjithë të datuar 1990-1991, mbi motive fetare, autobiografike, satirike, të rastit, etj... Sonetet, që këtu botohen, Bilota i shkruajti mbi smundjen e rëndë dhe vdekjen e së mbesës Rinë, që ai duaj shumë mirë. Dhe i zgjodha ndë mes t' tjerash (21 në përgjithësi), me titull "Simes mbess sëmuur". Sonete të thjeshtë, dmth. pa bisht, njëmbëdhjetë rrokjesh, me rimë ABAB ABAB CDC DCD ose ABBA ABBA CDC DCD. Kuaderni është i shkruar ka dy anët: ka ana ku gjënden Sonetet tanë (faqe 30-36), kemi 38 fleta; ka jetra anë, fletat janë 28. Çdo Sonet është i datuar ka dora e Bilotës, një titull për të gjithë, e s' janë të pjerrë në gjuhë italiane. (a.g.)

(transkripton) **Drejtori**

ka Purçilli (Cs)

I S'imes mbes sëmuur

Helq frim ti, mbesa ime, e dreq mund preç
Shënmria të kët të t' shkulej ka kjo smund,
çë t'vū përposh e t' mbān sa s' und këceç
llargu ka ajo, e mbār lītht si ndë rrtūd.

Mund preç shëndeten pār mbi tīj të vreç
të prjerr, përse helq frim me būz e hūd,
se taksmi Shënmērīs t' e çoç të veç
tek më dritson e mbjeth gjith nga katūd.

Prana çë të shëron tīj, tēnen mbes,
qellmi ndër këmbet sāj gjith me harë
t' i thueç me nē: "Mēm qielli, kam dreq bes

se e mira Trinitats ti vetem jē;
se sā mīr lutenj vet ka ti mund pres;
ka ti, çë drit e shndet gjith jetes jē.

(19-9-1901)

III

Shërom ti, mëma madhe, timen mbes:
shërome ti çë vetem mund e shroç:
shërome për se pata e kam u bes
se vetem ti kët mīr mundë më bëç.

Shërome e ndë çë t' ftesa em ndëles,
më pār se me kët mīr ti të më gzoç;
ndëlem e bēm të miren ç' ka ti pres
ka ti çë s' dī ndër helmet të na shtlloç.

Shërom ti timen mbes, çë aq harē
më bēm me t' miren sāj, se të do mīr
si një çë më ndër vashat të kām hjē.

Mēm, gjegjem, se të truhem si një bīr,
e shrome për se shndeta e gjelles jē
e drita e gasi gjelles të fanmīr.

(27-9-1901)

VI

Tek më erdha të t' çonja somenat
ti, mbes, s' më dolle përpara s' ish zakōn,
të më pieje: "Si rri? Si sondenat
m' e shkove? Fjete mīr, si dish Inzōn?"

Ti s' më dolle e më thē: "Vi, ngjitu lart
të ngrohesh, se duell bora e vatrat thōn
me kucarin e math të prēr ndē malt".
Ti s' më dolle e më thē: "Ulu se, njōn,

dhe tata e mëma, çë jān te shpia mbatān
ka tatmadhi, çë ngrēhet dielli lart,
se i kënda t' fjēr te pandohjīt i rān".

Ti s' më dolle e më piejte ndē ndonj kart
na e rru ka Manuelli, ç' aq ti mbān
ndēr trū sā posa e ëndrren vo nga nat.

(10-11-1901)

VIII

Si s' më dolle, s' më del mē, mbesa ime,
se Zotikrisht, si t' dish, nuse të muer.
S' më vlen mē të losem me aq rkime,
dit e nat gajdhīt tū tue kujtuer.

Të muer kush mundi të t' mirr e zëmres time
të t' shkulej, se është i Zoti më i bēkuer.
Të muer si hjē të kish e me këndime
Ëngjlit të qelltin nuse të dritsuer

tek dhëndrri: ai ndrruer me drit e bukurī
të prit me mäll të math e shūm harē
të stolisur me gjith tëndezit gadhī,

kuj aq harē m'i kish, se i kish e hjē
Me to vet e paltuer ka jona shpī,
çë s'mundi më të t'jip, si nusje t'rē.

(10-11-1901)

IX

I shtīr ka malli të t'shijja somenat
si t'kisha harruer se s'ishe më mbē shpī,
erdha të t'çoja e t'folja e sīt e mī
të prēja tue të vrēr t'urtez e fat

të gjelles time. Për kēt mbrēmenat
s'të lēnja t'rrinje vet. Zēmra m'u mbī
kūr s'të vreve gjakūn: gjaku m'u ngrī
kūr kujtova tīj vāt po nuse e bgat

me nj'dhënderr çë të piksen me harē;
me nj'dhënderr çë mburon me ëmbelsī;
me nj'dhënderr kuj ti e mīr më kē hjē.

S'u shuejta u për helmin si qirī
te zura gjith kto t'mira e vura rē
e u llambardhosa si lulet, pra ç'u dī.

(11-11-1901)

XIV

Oh t'mirez çë më bëje, mbes, nga nat,
ndē vinje mbē të ënderr e më çonje
e bukur e e gzuer si gjellat lart
e çë bëhet ndër qiell po drej më thonje!

Oh gjëgjëz çë më bēnje nd'edhe gjat
me mua tue rrfiēr e fol ahiera mnoje!
Mē ndihsha me tīj mbān pa rrfiēr i bgat
se ti si ëngjillith shëjt gjellen më prēnje.

Shi, mbes, e mīr sa māj mund jēç harruer
ka trūt e zēmres time, kēt të mīr
t'mund kēm ka ti nga nat të jēm i çuer.

Ndē ti më gjegjsh, u ndihem i fanmīr
nd'at hēr, si ndihen shpirtrat e bēkuer
kūr shohen Shēnmrīn me t'sajin Bīr.

(18-11-1901)

XV

Sā shtrëjt, o krēher, të të mbānj më nget,
për se shurbeve mirith timen mbes,
e i shkilqeve lesht kūr bënej kshet
si nji Ēngjlli parrajsi të pa ftes.

Sā shtrëjt u kam të t'mbānj po me vërtet,
se t'mbajtin duert e saja, për mua thes
pjot ār e pjot harē; e se meshndet
ajo t'bēri t'paren hēr, te t'muer me bes

të kish t'e shroje, si qēn ka Rroma i sjëll:
sjëll ka e dashura Rrōm çë t'paren hēr,
ku, si qella të vllān, ajo dōj qëll.

Dōj qëll se të shëjtrohej e martuer
me Zotinkrisht t'e kish prana ndër qiëll.
Krēher, të dua se t'mbajtin shëjtet duer.

(19-11-1901)

XVIII

Somenat, mbesa ime, dhëndrri it
Gustini, it kushrī, na la e t'u nis
e na vate ndē Merket, si s'i ngit
të vēj, ndē kish qēn ti i nguret lis

mbreej Dekjes, çë të mudi bēt të t'shkit
kēmba ndē varrt, ku thëll pra u gramis...
S'u kish nisur, t'na lēj, ndē ndē ktē vit
s'na u kish zdredhur me helm e egra Pis.

Ai kish mbetur, si dojem gjith, me nee
nuse të t'mirr e t'rrijet bashk me mua
Si di pllumba të mbjedhur ndē shpīt rē.

S'u kish nisur t'na lēj ndēkt lotësh krua
t'e vrēm të nisur llargu ndrishe dhē
e s'shoh, si tīj sē shoh, më kūr e dua.

(23-11-1901)

E Premtja e Javes Madhe*(pruar arberisht) **papas Giordano Emanuele**

(ka Frasnita-Cs / 1920-2015)

Dymbëdhjetë Vangjelet

(Të Ënhten mbrëma)

Vangjeli i parëNga Vangjeli sipas Janjit
(13,31-18,1)

I tha Zoti Dishipujvet të tij: "Nani i Biri i njeriut u lavdërua; edhe Perëndia u lavdërua tek ai. Nëse Perëndia u lavdërua tek ai, edhe Perëndia do të lavdëronjë atë nga ana e tij, e shpejt do t'ë lavdëronjë atë. Bilzit e mi, edhe për pakëz mot u jam me ju. Do të më kërkoni, po, si i thashë Judhinjvet, se ku vete u ju s'mund të vini, nani ju e thom edhe juve. U ju jap juve një kumandament të ri: të duheni mirë njeri jetri si u ju disha mirë juve, se edhe ju të duheni mirë njeri jetri. Nga ky do t'ju njohën gjithë se jini dishipuj të mi, nëse u dafshit mirë njeri jetri". I thot Simon Pjetri: "O Zot, ku vete ti?". Jisui ju përgjegj: "Atje ku vete u, ti për nani s'mund të më vish pas, po do të vish pëstaj". I thotë atij Pjetri: "O Zot, pse s'mund t'vinj pas teje nani? U do të jap edhe jetën time për tij!". U përgjegj Jisui: "Ti do të japësh jetën tënde për mua? Me të vërtetë të thom tij: s'do të këndonjë gjeli më parë se të më mohosh tri herë! Mos u tërboftë zëmra juaj: kini besë tek Perëndia e kini besë edhe tek u. Tek shpia e Atit tim janë shumë vende, e nëse nëng ish ashtu, ju e kisha thënë. U vete të ju ndreqënj vendin për ju; e kur të vete e t'ju e kem ndrequr vendin, njetër herë do të vinj t'ju marr me mua; ashtu që, ku jam u, të jini edhe ju. E ku vete u, ju e njihni udhën?". I thotë Tumazi: "O Zot, na s'ë dimi ku vete ti, e si mund të njohmi udhën?". Jisui i thotë atij: "U jam Udha, E Vërteta dhe Jeta. Mosnjeri vjen tek Ati veç se me anën time. Nëse më njihni mua, do të njihni edhe Atin tim. E që nani e njihni, edhe e kini parë". I thotë atij Fëlipi: "O Zot, buthtona neve Atin, e na sosën neve". Jisui i thotë: "Nga aq mot që jam me ju e edhe s'më ke njohur, Fëlip? Ai që më ka parë mua, ka parë Atin. Si mund të thuash 'Buthtona Atin?'. S'ke besë ti se u jam tek Ati e se Ati është tek u? Fjalët që ju thom juve nëng i thom nga vetëheja ime po Ati që është tek u bën këto vepra. Kimni besë se u jam tek Ati e Ati është tek u; së paku besonie për veprat. Me të vërtetë, me të vërtetë ju thom juve: edhe ai që më ka besë mua do të bënëj veprat që bënëj u, e do t'i bënëj edhe më të mëdha se këto, sepse u vete tek Ati. Çdogjë të lypni ndë ëmrit tim do t'ju e bënëj, se të lavdërohet Ati tek i Biri. Nëse më lypshit gjë në ëmrit tim, u do t'ë bënëj. Nëse më doni mirë mua, do të ruani kumandamentet e mi. U parkalesënj Atin e ai do t'ju japë juve njetër Ngushëllimtar, që do të rrië bashkë me ju për gjithmonë: Shpirtin e së vërtetës, që jeta s'mund të marrë sepse nëng e sheh e nëng e njeh. Ju e njihni sepse rri bashkë me ju e do të jetë tek ju. Nëng ju lë të paprindë, do të prirem tek ju. Edhe pak mot e jeta s'më sheh më, po ju do të më shihni, ju do të rroni sepse u rronj. Ndë atë ditë ju do të njihni se u jam tek Ati im, e ju jini tek u e u tek ju. Ai që mban kumandamentet e mi dhe i ruan, ky më do mirë mua; e ai që më do mirë mua do të jetë i dashur mirë nga Ati im; edhe u do t'ë dua mirë e do t'i butthohem atij". I thot Judha, jo Iskarjoti: "O Zot, si vete që ti do të na butthohesh neve e jo jetës?". Jisui ju përgjegj e i tha: "Nëse një më do mirë mua do të gjegjënj fjalën time, e Ati im e do mirë atë, e na vimi tek ai e do të rrimi tek ai. Ai që s'më do mirë mua nëng i ruan fjalët e mia; e fjala që ju gjegjini nëng është imja po e Atit që më dërgoi. Këto shërbise ju i kam thënë juve kur isha edhe me ju. Po Ngushëllimtari, Shpirti i Shëjtë që Ati do të dërgonjë ndë ëmrit tim, ai do t'ju mësonjë juve gjithësej e do t'ju kujtonjë gjithë atë që ju kam thënë juve. Paqen ju lë juve, ju jap paqen time. Po u s'ju e jap si ju e jep jeta. Mos u tërboftë zëmra juaj, as u trëmbtë. Ju e gjegjëtit se ju thashë juve: Vete e pra do të prirem tek ju. Nëse ju më dojt mirë, kish të gëzohëshit se u vete tek Ati, sepse Ati im është më i madh se u. E nani ju e kam thënë më parë se të bjerë, se të kini besë kur

të bjerë. Njëng dua të flas më gjatë me ju, se po vjen krei i kësaj jetje, po ai s'ka fuqi mbi mua; po jeta ka të dirë se u e dua mirë Atin e bënë atë që Ati më urdhëroi. Ngrëheni, ikmi nga ky vend. U jam dhria e vërtetë dhe Ati im është vreshtari. Çdo villostar që tek u nëng siell frut, Ati e pret; e nganjë që siell frut ai e kalladhepsën se të sjellë më shumë frut. Ju nani jini të pastër për fjalën që ju kam thënë juve. Qëndroni tek u dhe u tek ju; ashtu si villostari s'mund të sjellë frut nga vetëheja e tij nëse s'qëndroftë tek dhria, kështu edhe ju, nëse s'qëndroshiti tek u. U jam dhria, ju villostet: ai që qëndron tek u e u tek ai, ky siell shumë frut, sepse pa meje ju s'mund t'bëni faregjë. Kush nëng qëndron tek u, vjen shtënj jashtë, si degë dhrije e thahet, e pra e mbledhën dhe e shtellojnë mbë zjarr dhe e djegën. Nëse qëndroshiti tek u, e fjalët e mia qëndrojnë tek ju, lypni atë që doni e do t'ju jipet juve. Në këtë është lavdëruar Ati im: të sillni shumë frut e të bëheni dishipuj të mi. Si më dish mirë mua Ati, kështu u ju disha mirë juve. Qëndroni te dashuria ime. Nëse ruani kumandamentet e mi, qëndroni te dashuria ime; ashtu si u ruajta kumandamentet e Atit tim e qëndroni te dashuria e tij. Ju thashë këto shërbise se gëzimi im të qëndronjë tek ju dhe gëzimi juaj të jetë i plotë. Ky është kumandamenti im: të duheni mirë njeri jetri, si u ju desha mirë juve. Mosnjeri ka një dashuri më të madhe se kjo: të japë jetën e tij për miqtë e tij. Ju jini miqtë e mi, nëse bëni atë që ju urdhëronj juve. Njëng ju thërres më shërbëtorë, sepse shërbëtori nëng e di atë që bën i zoti; po ju thërrita miq, sepse gjithë atë që gjegja nga Ati ju e kallëzova juve. S'më kini zgjedhur ju mua, po u ju zgjedha juve, e ju bëra se të veni e të sillni frut, dhe fruti juaj të qëndronjë; sepse gjithë atë që t'i lypshiti Atit tim ndë emrit tim, t'ju e japë. Këtë ju urdhëronj: duheni mirë njeri jetri. Nëse jeta ju do lig, kin të dini se ajo më dish lig mua më parë se juve. Nëse ju ishit të jetës, jeta do mirë të sajti. Po, sepse ju s'jini të jetës, se u ju zgjedha nga jeta, për këtë jeta ju do lig. Mbani mend fjalën që ju thashë juve: s'është shërbëtor më i madh se i zoti i tij. Nëse më kanë reshtur mua, do t'ju reshtjën edhe juve; nëse kanë ruajtur fjalën time, do të ruajën edhe tuajën. Po gjithë këto ju i bëjnë juve për shkak të emrit tim, sepse nëng njohën atë që më dërgoi. Nëse s'kisha ardhur e s'i kisha folur atyre, s'kishin mëkat, po nani s'kanë ndëlesë për mëkatin e tyre. Kush më do lig mua, do lig edhe Atin tim. Nëse s'kisha bërë në mes të atyreve shërbise që mosnjeri bëri, s'kishin ndonjë mëkat; po nani kanë parë e kanë dashur lig mua e Atin tim. Se të bëhej fjala e shkruajtur te Ligja e tyre: "Më dishitin lig pa gjë". Kur të vinjë Ngushëllimtari, që u do t'ju dërgonj nga ana e Atit, Shpirti i së vërtetës që buron prej Atit, ai do të më bënë martri, edhe ju do të më bëni martri, sepse kini qënë me mua që të parzën herë. Ju thashë këto shërbise se të mos të skandallizoheni. Do t'ju përzënë nga sinagogat, e vjen hera kur, kush t'ju vrasë juve, ka besë se i jep lavdi Perëndisë. E do të bëjnë këto shërbise sepse nëng njohin as Atin as mua. Po u këto ju i thashë sepse, kur të vinjë hera, të kujtoni se ju i thashë juve. S'ju i thashë më parë, sepse isha me ju. Po nani u prirem tek ai që më dërgoi e mosnjeri ndër ju më pyen: Ku vete? Po, sepse u kam folur kështu, helmi ju mbloi zëmren tuaj. U po ju thom të vërtetën: është më mirë për ju se u vete, sepse nëse u s'vete, Ngushëllimtari s'do të vinjë tek ju; po, kur të ikën, do t'ju e dërgonj. E, kur të vinjë ai, do të bindënj jetën për mbëkatën, për drejtësinë e për gjykimin. Për mbëkatën, se s'kanë besë tek u; për drejtësinë, se u jam e vete tek Ati e s'do të më shihni më; për gjykimin, se pringjipa e kësaj jetje që gjykuar. Kam edhe shumë shërbise të ju thom, po nani s'mund t'i mbani. Po, kur të vinjë Shpirti i së vërtetës, do t'ju mësonjë juve gjithë të vërtetën, sepse ai s'ka të flasë nga vetëheja e tij; po do t'ju thetë juve gjithë ato që ka gjegjur e do t'ju thetë shërbiset që kanë të vijën. Ai do të më lavdëronjë mua, sepse do të marrë nga u e do t'ju e kallzonjë juve. Gjithë atë që ka Ati është timtë; për këtë thashë se do të marrë nga timtë e do t'ju e kallzonjë juve. Adhe një çik e s'më shihni; e adhe një çik e më shihni njetër herë". Thanë ahiera dica ndër Dishipujt e tij njeri jetrit: Ç'është këta që na thotë: "Adhe një çik e s'më shihni e adhe një çik e më shihni", e këtë "Sepse vete tek Ati"?". Thojn prandaj: Ç'është këta "një çik" që thotë? S'ndëlgomi atë që thotë". Njohu Jisui se dojin t'e pyejin e i tha atyre: "Mbi këtë shërbes ndër ju veni ture u pyejtur njetri jetri sepse ju thashë: "Adhe një çik e s'më shihni e adhe një çik e më shihni njetër herë? Me të vërtetë, me të vërtetë ju thom juve se do të qani e do të ksini, po jeta do të gëzonjë; ju do të jini mbë lip, po lipi juaj do të ndërrohet mbë hare. Gruaja, kur len një bir, ka helm se erdhi hera e saj; kur pra ju le djali, s'kujtohet më për helmin, se ka hare se u le një njeri te jeta. Kështu edhe ju, nani, jini mbë lip; po pra do t'ju shoh njetër herë e zëmra juaj do të gëzonjë, e gëzimin tuaj mosnjeri mund t'ju e nxjerë. E tek ajo ditë s'do të më pyeni më faregjë. Me të vërtetë, me të vërtetë ju thom juve se çdo t'i lipni Atit ndë emrit tim, do t'ju e japë. Njera nani s'lyptit faregjë ndë

ëmrit tim: lypni e do të kini, ashtu që harea juaj të jetë e plotë. Këto shërbise ju i thashë me përrallaz; po vjen hera kur jo më me përrallaz ju folënj juve, po hapët do t'ju folënj për Atin. Tek ajo ditë do të lypni ndë ëmrit tim e s'ju thom se parkalesënj Atin për ju; sepse Ati vetë ju do mirë, se ju më kini dashur mirë mua e kini pasur besë se u dolla nga Perëndia. Dolla nga Ati dhe erdha në jetët; nani lë papaj jetën e prirem tek Ati". I thonë atij Dishipujt e tij: "Njo, nani folën hapët e s'folën më me përrallaz. Nani dimi se ti di gjithsej e se s'lypset të të pyenjë ndonjeri; prandaj na kemi besë se ti dolle nga Perëndia". Ju përgjegj atyre Jisui: "Nani ju kini besë? Njo se vjen hera, e nani po erdhi, kur do të shprisheni nganjë për kundin tuaj e do të më lëni vet, po u s'jam i vetëm, sepse Ati është me mua. Këto shërbise ju i thashë juve se të kini paqë tek u. Tek jeta do të kini helm, po bëni zëmër: u e munda jetën!". Kështu foli Jisui. Pëstaj ngrëjti sytë e tij ndë qiell e tha: "O Tatë, erdhi hera, lavdëro tët Bir, ashtu që edhe yt Bir të të lavdëronjë tij. Sepse ti i dhe atij zotëri mbi çdo njeri, ashtu që edhe ai t'i japë jetën e pasosme gjithëve atyre që ti i dhe atij. Kjo është jeta e pasosme: të të njohën tij të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jisu Krishtin, që ti dërgove. U të lavdërova mbi dhenë: veprën që ti më dhe të bëja, u e mbarova. E nani ti lavdëromë mua, o Tatë, me lavdinë tënde që u kisha mbanë teje, më parë se të krijohet jeta. U i kallëzova ëmrin tënd njerëzvet që ti më dhe mua nga jeta: ishin të tutë e m'i dhe mua e ata e ruajtën fjalën tënde. Nani ata njohtin se gjithë ato që m'dhe mua vijën nga ti; sepse fjalët që ti më dhe mua u ja dhe atyre e ata i muartin e njohtin me të vërtetë se u dolla nga ti, edhe patëtin besë se ti më dërgove. U parkalesënj për ata; nëng parkalesënj për jetën, po për ata që ti më dhe mua; sepse janë të tutë. E gjithë të miat janë të tuat, e të tuat janë të miat, dhe u po u lavdërova tek ata. U nëng jam më te jeta, po ata janë te jeta, e u po vinj tek ti. O Tatë i shëjtë, ruaji ndë ëmrit tënd ata që më dhe mua, se të jenë një si na. Kur u isha me 'ta, i ruajta ndë ëmrit tënd; ata që ti më dhe mua u i ruajta e mosnjë ndër ata u buar, veç se i biri i së bjerrjes, se të vërtetohej Shkrimi. Nani u vinj tek ti, e këto u i thom te kjo jetë; se të kenë edhe ata të plotë harenë time në vetëhenë e tyre. U i dhe atyre fjalën tënde, e jeta i deshi lig sepse ata s'janë të jetës, si u s'jam i jetës. Nëng të lypënj t'i nxiersh nga jeta, po t'i ruash nga i ligu. Ata s'janë të jetës, si u s'jam i jetës. Shëjtëroji ata me të vërtetën. Fjala jote është e vërteta. Si ti më dërgove mua te jeta, u dërgova ata te jeta. E për ata u shëjtëronj vetëhenë time, se të jenë edhe ata të shëjtëruar me të vërtetën. Nëng parkalesënj vetëm për këta, po edhe për ata që, për fjalën e tyre, do të kenë besë tek u. Se të jenë një, si ti, o Tatë, je tek u e u tek ti; se edhe ata të jenë një tek na; se të ketë besë jeta se ti më dërgove. E lavdinë që ti më dhe mua u ja kam dhënë atyre, se të jenë një si jemi një na. U tek ata e ti tek u, se të jenë të përsosur tek njësimi e se të njohë jeta se ti më dërgove e deshe mirë ata si më deshe mirë mua. Tatë, ata që ti më dhe mua, dua se të jenë me mua ku jam u, e të shohën lavdinë time që ti më dhe mua, sepse ti më deshe mirë parë se të krijohet jeta. Tatë i drejtë, jeta nëng të njohu, po u të njoha e këta njohtin se ti më dërgove. E u i buthtova atyre ëmrin tënd e do t'ja buthtonj; se dashuria, me të cilën ti më deshe mirë mua, të jetë tek ata, si edhe u jam tek ata". Si tha kështu, Jisui dolli me Dishipujt e tij e vate mbanë lumit Qedhron, ku ish një kopsht. Atje hyri ai e Dishipujt e tij.

Vangjeli i dyjtë

Nga Vangjeli sipas Janjit
(18, 1-28)

Nd'atë mot, Jisui dolli me Dishipujt e tij e vate mbanë lumit Qedhron, ku ish një kopsht. Atje hyri me Dishipujt e tij. E Judha, që ish po t'e tradhëtonij, njih atë vend, sepse Jisui shumë herë mblidhej atje me Dishipujt e tij. Judha, poka, pasur një koortë ushtarësh e ca roja nga Krerët e priftravet e nga Farisenjtë, vate atje me hilnerë, vravashka e me shpata. Ahiera Jisui, që dij gjithë shërbiset që kish t'i bijën atij, i dolli përpara e i thotë atyre: "Çë kërkoni?". Ju përgjegjtin ata: "Jisu Nazarenin". I thotë atyre: "Jam u". Ish me 'ta edhe Judha që e tradhëtonij. Sanënga i tha atyre "Jam u", u dhanë prapë e ranë gjatë mbë truall. Njetër herë i pyejti Jisui: "Çë kërkoni?". E ata thanë: "Jisu Nazarenin". Tha atyre Jisui: "Ju e thashë se jam u; nëse prandaj më kërkoni mua, leni të venë këta". Se të bij ashtu fjala që ai kish thënë: "Ndër ata që më dhe mua, s'borë mosnjë". Ahiera Simon Pjetri, që kish shpatën, e nxori dhe lavosi një shërbëtor të Kryepërfittit e i preu

veshin e djathtë. Ky shërbëtor thërrirej Mallk. Po Jisui i tha Pjetrit: "Vëre shpatën te milli. Nëng kam pi u qelqin çë më dha Ati?". Koortja, pra, e tribuni e rojat e Judhinjvet rrëmbien Jisuin, e lidhtin, e e qelltin më parë tek Ana, i vjehri i Kajfasit, çë ish Kryeprift tek ai vit. Kajfasi pra ish ai çë i kish thënë Judhinjvet se ish më mirë të vdis një njeri i vetëm për gjithë popullin. Ndërkaq Simoni Pjetër vini prapa, larg Jisuit, bashkë me njetër dishipull. E ky jetri dishipull ish i njohur nga Kryeprifti e prandaj hyri me Jisuin tek vali i shpisë së Kryepriftit. Pjetri përkundra qëndroi jashtë, afër derës. Po ai jetri dishipull, çë ish i njohur nga Kryeprifti, dolli e i foli dertares e bën e hyri edhe Pjetri. I tha Pjetrit dertarja: "Mos je edhe ti ndër Dishipujt e këtij njeriu?". E ai ju përgjegj: "Nëng jam". Rrijin pra shërbëtorët e rojat afër zjarrit e ngrohëshin, se bëj ngritë. E ish edhe Pjetri me 'ta e rrij e ngrohej. Ahiera Kryeprifti pyejti Jisuin për Dishipujt e tij e për mësimin e tij. Jisui ju përgjegj: "U i fola gjindjes hapët. Gjithmonë mësova te Sinagoga e tek Tempulli, ku mbjidhen gjithë Judhinjtë, e s'thashë një fjalë fshehura. Pse më pyen mua? Pyej ata çë gjegjëtin çë i thashë atyre; njo, ata e dinë atë çë thashë". Si ai tha kështu, një rojë çë gjëndeje atje i dha një shpëllakë dhe i tha: "Ashtu i përgjegje Kryepriftit?". Ju përgjegj Jisui: "Nëse fola lig, thuajme; po nëse fola mirë, pse më bie?". Ahiera Ana dërgoi Jisuin të lidhur tek Kryeprifti Kaifas. Ndërkaq Simoni Pjetër ngrohej afër zjarrit. Atij pra i thanë: "Mos je edhe ti ndër Dishipujt e tij?". E ai mohoi e tha: "Nëng jam". Po i tha një ndër shërbëtorët e Kryepriftit, çë ish gjiri i atij kuj Pjetri i kish prerë veshin: "S'të pashë u tij te kopshti bashkë me 'të'". Pjetri mohoi njetër herë e mbjatu një gjel këndoi. Ahiera qelltin Jisuin çë nga shpia e Kajfasit njera te Pretori, e ish menatet njize, e ata nëng hyjtin te Pretori se të mos të bëhëshin të papastër e të mund të hajin Pashkën.

Vangjeli i trejtë

Nga Vangjeli sipas Mateut
(26, 57-75)

Nd'atë mot, ushtarët, si rrëmbien Jisuin, e qelltin te Kaifasi, Krei i priftravet, tek i cili u kishin mbledhur Skribët e Pleqtë. E Pjetri i venij pas prej së larg, njera te shpia e Kryepriftit; e, si hyri mbrënda, rrij ulët me shërbëtorët, tue parë si vej shërbësi. E Krerët e priftravet e gjithë sinedri kërkojin martri të rremë kundër Jisuit, se t'e vrisjin. E nëng gjëjin një, megjithëse kishin dalë shumë martri të rremë. Pëstaj erdhëtin dy martri të rremë e thanë: "Ky tha: u mund të dërmonj Tempullin e Perëndisë dhe t'e stisënj te tri ditë". E si u ngre Krei i priftravet, i tha: "Faregjë i përgjegje këtyre çë thonë kundër teje?". Po Jisui rrij qet. E Krei i priftravet i tha: "U të lutem shumë, ndë ëmrit të Perëndisë, të na thuash nëse je ti Krishti, i Biri i Perëndisë të gjallë". Jisui ju përgjegj: "Ti e the. Përkundrazi ju thom juve: sotepara, do të shihni të Birin e njeriut ulur nga e djathta e Perëndisë, çë vjen mbi retë e qiellit". Ahiera Kryeprifti shquar të veshurat e tija e tha: "Ky mallkoi, çë na duhen më martri? Nani ju e gjegjëtin mallkimin. Ç'ju duket?". Ata ju përgjegjëtin: "Ka të vdesë". Ahiera i pështyjtin në faqe e i dhanë shpëllaka e të tjerë e rrahtin me shkop, ture i thënë: "Thuajna neve, o Krisht, kush të ra?". Pjetri pra rrij përjashta tek dera e, qasur një shërbëtorë, i tha: "Edhe ti ishe me Jisuin Galilë". Po ai mohoi përpara gjithëve, tue thënë: "Nëng di ç'thua". E, si ai dil jashtë ka dera, e pa njetër shërbëtorë e i tha atyre çë rrijin atje: "Ky ish me Jisuin Nazarë". E ai mohoi njetër herë, tue thënë: "S'e njoh atë njeri". E, pas një çik, ata çë rrijin atje ju qastin e i thanë Pjetrit: "Vërtet edhe ti je një ndër ata, se të folurit tënd të zbulon". Ahiera ai zu e vu nëmë e muar bé: "S'e njoh atë njeri". E mbjatu gjeli këndoi. E Pjetri u kujtua për fjalën çë i kish thënë Jisui: "Parë se të këndonjë gjeli ti do të më mohosh tri herë". E, dalë jashtë, qajti shumë tharët.

Vangjeli i katërt

Nga Vangjeli sipas Janjit
(18, 28 – 19,16)

Nd'atë mot, qelltin Jisuin çë nga shpia e Kajfasit njera te Pretori, e ish menatet njize, e ata nëng hyjtin te Pretori se të mos të bëhëshin të papastër e të mund të hajin Pashkën. Dolli pra jashtë Pilati e i tha atyreve: "Çë

thoni ju kundër këtij njeriu?”. Ju përgjegjëtin e i thanë: “Nëse nëng ish një njeri i lig, s’te kishim dhënë ndër duart e tua”. I tha atyreve Pilati: “Mirnie ju e gjykoni sipas ligjës suaj”. Po Judhinjtë i thanë atij: “Na nëng mund të vrasmi mosnjeri”. Se të binij ashtu fjala që kish thënë Jisui, të buthtonij se si kish të vdis. Hyri njetër herë Pilati te Pretori e, thërritur Jisuin, i tha: “Je ti Rregji i Judhinjvet?”. Ju përgjegj Jisui: “E thua ti këtë o t’e thanë të tjerë për mua?”. U përgjegj Pilati: “Mos jam judhi u? Gjindja jote e Kryeprifrat të vunë ndër duart e mia. Ç’bëre ti?”. U përgjegj Jisui: “Rregjëria ime nëng është e kësaj jetje. Nëse rregjëria ime ish e kësaj jetje, shërbëtorët e mi kishin luftuar për të mos të bija ndër duart e Judhinjvet. Po rregjëria ime nëng është e kësaj jetje”. Ahiera i tha Pillati: “Ti poka je rregji?”. U përgjegj Jisui: “Ti e thua: u jam rregj. U për këtë u leva e për këtë erdha te kjo jetë: se t’i bëja martri së vërtetës. Kushdo është me të vërtetën gjegjën fjalën time”. I tha Pilati: “Ç’është e vërteta?”. E sa tha kështu, njetër herë doli ndër Judhinjtë e i tha atyreve: “U nëng gjënj tek ai mos një ftesë. Po nani ju kini zakon se kam t’ju lironj një njeri ndër Pashkë. Doni t’ju lironj Rregjin e Judhinjvet?”. Po ata thërritëtin njetër herë: “Jo atë, po Barabën”. E Baraba ish një kusar. Ahiera Pilati urdhëroi të mirrin Jisuin dhe t’e rrahjin me fërshërë. Dhe ushtarët, dredhur një kurorë gjëmbash, ja vunë mbi krye dhe i vunë ngrah një veshje të kuqe dhe e përqeshjin e i thojn: Të falemi, o Rregji i Judhinjvet!”. E i jipjin shpëlaka. E doli jashtë njetër herë Pilati e i tha atyreve: “Nani u ju e nxier jashtë se të xëni se u s’gjënj mos një ftesë tek ai”. SE doli jashtë Jisui, me kurorën gjëmbash e me të veshurën e kuqe. E i thotë atyreve Pilati: “Njo njeriu!”. Po, sa e panë, Kryeprifrat dhe rojat ngrëjtin zërin e thanë: “Vëre mbë kryq, vëre mbë kryq!”. I tha atyre Pilati: “Mirnie ju e vënie mbë kryq, sepse u s’gjënj tek ai mos një ftesë”. Ju përgjegjëtin Judhinjtë: “Na kemi ligjën e, si thot kjo ligjë, ai ka të vdesë, sepse u bë Bir i Perëndisë”. Kur Pilati gjegji këto fjalë, u trëmb më shumë. Hyri njetër herë te Pretori e i tha Jisuin: “Nga je ti?”. Po Jisui s’ju përgjegj. I thotë atij Pilati: “Nëng më flet mua? Nëng e di ti se u mund të të lë të lirë e mund të të vë mbë kryq?”. U përgjegj Jisui: “Ti s’mundje faregjë mbrej meje, nëse nëng t’u kish dhënë nga larti; prandaj, ai që më vu ndër duart e tua ka një mëkat më të madh”. Çë ahiera Pilati kërkonij të lironij Jisuin, po Judhinjtë thërrisjin: “Nëse liron këtë, nëng je mik i Qesarit. Kushdo bëhet rregj vëhet kundër Qesarit”. Pra që gjegji kështu, Pilati nxori jashtë Jisuin e u ul te gjyqi, te vendi që thërritej Llithòstroton, ebraisht Gavathà. E ish e prëmjtja e Pashkëvet, qasur ora e gjashtë, e i tha Judhinjvet: “Njo Rregji juaj!” Po ata thërrisjin: “Nxire, nxire, vëre mbë kryq!”. Tha Pilati: “Mund të vë mbë kryq Rregjin tuaj?”. Ju përgjegjtin Kryeprifrat: “S’kemi njetër rregj veç se Qesarin!”. Ahiera Pilati ja dha ndër duart e tyre, se të vëhej mbë kryq.

Vangjeli i pestë

Nga Vangjeli sipas Mateut
(27, 3-32)

Nd’atë mot, Judha, tradhëtari, kur pa se Jisui kish qënë dënuar, i metanosur, i pruar tridhjetë rëgjëndat Krerëvet të priftravet dhe Pleqvet, 4tue i thënë: “Bëra mëkat se tradhëtova gjakun e paftesë”. Po ata thanë: “Çë na intereson neve? Shihe ti”. E ai, si shtu rëgjëndat te Tempulli, iku e vate e u var. E Krerët e priftravet, marrë rëgjëndat, thanë: “S’është mirë të vëmi këto te thesari, se janë çmim gjaku”. E, mbajtur këshill, blejtin me ato dhenë e qeramidhàrit, për varr të të huajvet. Për këtë ai dhe qe thërritur “dhë gjaku” njera sot. Ahiera u bë e thëna e Profitit Jeremi që thotë: “E muartin tridhjetë rëgjëndat, çmimi i të shiturit, që të bijtë e Izrailit kishin kontraktuar, e i dhanë për dhenë e qeramidharit, si më kish urdhëruar Zoti”. E Jisuin e qelltin përpara Governororit, e Governorori e pyejti, tue i thënë: “Ti je Rregji i Judhinjvet?”. E Jisui i tha atij: “Ti e thua”. E kur e ngalesjin Krerët e priftravet dhe Pleqtë, s’i përgjegjej faregjë. Ahiera i thotë atij Pilati: “Nëng gjegjën ti sa thonë mbi tij martritë?”. E s’ju përgjegj atij mos një fjalë, aq sa u çudit shumë Governorori. Te çdo festë, Governorori kish zakon t’i lërenij popullit një filaqir, atë që dojin. Kishin ahiera një filaqir të njohur, që ja thojn Barabë. Nani, si ata u mblodhëtin, i tha Pilati: “Cilin doni t’ju lë? Barabën ose Jisuin, të thërritur Krisht?”. Sepse ai dij se për zili ja kishin dhënë ndër duar. E, si u ul mbi thronin e ligjës, i dërgoi thënë e shoqja e tij: “Mos patsh faregjë ti me atë të drejtë, se shumë pësova sot mbë ëndërr për të”. E Krerët e priftravet dhe Pleqtë i thanë gjindjes të lipjin Barabën, e Jisuin t’e vrisjin. E ture ju përgjegjur, Governorori

i tha atyre: "Cilin doni t'ju lëshonj ndër këta të dy?". E ata thanë: "Barabën". I thotë atyre Pilati: "Ç'kam të bënj prandaj me Jisuin, të thërritur Krisht?". I thonë atij gjithë: "Ka të vëhet mbë kryq". E i tha atyre: "Çë lig bëri?". E ata më shumë thërrisin, tue thënë: "Ka të vëhet mbë kryq". E, si pa Pilati se s'kish më çë të bëj, po më shumë trubullí bëhej, si muar ca ujë, lajti duart përpara gjindjes, tue thënë: "U s'kam ftesë për gjakun e këtij të drejti, shihnie ju". E gjithë populli u përgjegj: "Gjaku i tij le të bjerë mbi ne e mbi biltë tanë". Ahiera i lëshoi atyre Barabën; e Jisuin, pra çë bën e e rrahtin, ja dha se t'e vëjin mbë kryq. Ahiera ushtarët e Governororit qelltin Jisuin te Pretori e mblodhëtin rreth atij tërë koortën, e, pra çë e xheshëtin, i vunë ngrah një mandjel të kuq. E, pjeksur një kurorë gjëmbash, ja vunë mbë krye e një kallmër te dora e djathtë. E, përgjunjur përpara atij, e shajin, ture i thënë: "Të falemi, o Rregj i Judhinjvet". E, ture i pështytur, i mirrjin kallmrin e me 'të i bijin mbi kryet. E pra çë e shajtin, i xheshtin mandjelin dhe i vunë ngrah të veshurat e tija, dhe e qelltin t'e vëjin mbë kryq. E, dalë përjashta, gjetëtin një njeri qirinë, të thërritur Simon, dhe e shtrënguan të ngarkonij kryqen e tij.

Vangjeli i gjashtë

Nga Vangjeli sipas Markut
(15, 16-32)

Nd'atë mot, ushtarët qelltin Jisuin përmbrenda valit, çë është Pretori, e mblodhëtin gjithë koortën. E veshin me një veshje të kuqe; e, dredhur një kurorë gjëmbash, ja vunë mbi kryet. E zunë e e tefaljin: "Të përshëndetmi, o Rregj i Judhinjvet!". E i bijin në kryet me një kallmër e i pështytin ngrah. E, ulur përgjunja, e adhurojin. E, pra çë e përqeshin, i xheshtin të veshurën e kuqe dhe e veshin me t'veshurat e tija. E e qelltin jashtë se t'e vëjin mbë kryq. Dhe shtrënguan një njeri çë mblidhej nga dheu, Simonin Qirenë, tatën e Llisandrit dhe Rufit, se të qellnij kryqen e tij. E qelltin te vendi çë thërritet Golgothà, çë vjen me thënë "vend i kutullës". E i dhanë të pij verë të përzyer me mirrë. Po ai nëng e muar. E pra ç'vunë mbë kryq, ndajtin të veshurat e tija, tue shtënë shortë, kuj i ngit çdo pjesë. Ish ora e tretë kur e vunë mbë kryq. E mbishkrimi i ftesmës së tij thoj: "Rregji i Judhinjvet". E me 'të vunë mbë kryq dy kusarë, një nga e djathta e një nga e shtrëmbura e tij. E ra Shkrimi çë thoj: "Qe i vënë bashkë me të padrejtët". E ata çë shkojin e mallkojin ture tundur kryet e tue thënë: "Ec, ti çë dërmon tempullin e tek tri ditë e stisën! Shpëto vetëhenë tënde e zbritu nga kryqja!". Ashtu edhe Krerët e priftravet bashkë me Skribët, ture e përqeshur, thojn njeri jetrit: "Liroi të tjerët e s'mund të lironjë vetëhenë e tij! Krishti, Rregji i Izrailit, le të zbritet nga kryqja nani, ashtu shohmi e kemi besë!".

Vangjeli i shtatë

Nga Vangjeli sipas Mateut
(27, 33-54)

Nd'atë mot, si errunë ushtarët te një vend i thërritur "Golgothà", çë vjen me thënë "vend i kutullës", i dhanë të pijë verë të përzyer me fell. E si e qasi ndë buzët, s'dish t'e pij. E si e vunë mbë kryq, ndajtin të veshurat e tija, tue shtënë shortazit; se të bëhej çë u tha nga Profiti: "Ndajtin të veshurat e mia e mbi tunikën time shtunë shortazit". E, ulur, e ruajin atje. E vunë, mbi kryet e tij, ftesmën e tij, të shkruar: "Ky është Jisui Rregji i Judhinjvet". Ahiera qenë vënë me 'të mbë kryq dy kusarë, një nga e dhjathta e një nga e shtrëmbura. E ata çë shkojin atej, e mallkojin, tue tundur kryet e thojn: "Ti çë dërmon tempullin e tek tri ditë e stisën, shpëto vetëhenë tënde! Nëse je i Biri i Perëndisë, zbritu nga kryqja!". E kështu edhe Krerët e priftravet e përqeshin, bashkë me Skribët e Pleqtë, e thojn: "Shpëtoi të tjerët e s'mund të shpëtonjë vetëhenë e tij. Është Rregji i Izrailit, le të zbritet nani nga kryqja e do t'i kemi besë. Ai pati besë tek Perëndia, le t'e lironjë nëse e do mirë. Sepse tha: "Jam i Biri i Perëndisë". Edhe kusarët, çë ishin mbë kryq bashkë me 'të, e shajin edhe ashtu. E tek e gjashta orë u err mbi tërë jetën, njera tek e nëndëta. E tek e nëndëta orë thërriti Jisui me zë të madh

e tha: "Eli Eli lamà savahthani?", çë vjen me thënë: "Perëndia im, Perëndia im, pse më lëreve?". E dica ndër ata çë rrijin atje, kur e gjegjëtin se thoj ashtu, thanë: "Ky thërret Elinë". E mbjatu një ndër ata vate e muar një sponxë, e ngjyeyti në uthull, e vu mbi një kallmër e i dha të pij. E të tjerët thojn: "Leje, shohim nëse vjen Elia t'ë shpëtonjë". E Jisui, tue thërritur njetër herë me zë të madh, vdiq. E njo se veli i Tempullit u nda dysh, çë lart njera poshtë; e dheu u tund, e shkëmbet u çajtin, e varret u hapëtin, e shumë kurme shëjtrash të vdekur u ngrënë. E, dalë nga varret, pas ngjalljes së tij, erdhëtin te qyteti i shëjtë e ju buthtuan shumëve. Qenturjoni dhe ata çë bashkë me 'të ruajin Jisuin, si panë dhenë çë tundej e shërbiset çë bëhëshin, u trëmbëtin shumë, e thojn: "Ky ish vërtet i Biri i Perëndisë!".

Vangjeli i tetë

Nga Vangjeli sipas Llukës
(23, 32-49)

Nd'atë mot, ishin qellur bashkë me 'të edhe dy të keq, se t'ishin vrarë. E kur errunë te një vend çë thërritet Kutull, atje vunë mbë kryq atë e të keqtë, njërin nga e djathta e jetrin nga e shtrëmbura. E Jisui thoj: "O Tatë, ndëleji ata, sepse nëng e dinë çë bëjën". E, ture ndajtur pra të veshurat e tija, shtunë shortazit. E populli rrij e ruani. E Krerët e përqeshjin ture thënë: "Shpëtoi të tjerët, le të shpëtonjë vetëhenë e tij, nëse ky është Krishti, i zgjedhuri i Perëndisë". E e përqeshjin edhe ushtarët, ture ju qasur e tue i dhënë uthull, e tue thënë: "Nëse ti je Rregji i Judhinjvet, shpëto vetëhenë tënde!". E përmbi kryet e tij ish edhe një mbishkrim: "Ky është Rregji i Judhinjvet". E njëri ndër keqbërësit, të vjerrë me 'të mbë kryq, e shani tue thënë: "S'je ti Krishti? Shpëto vetëhenë tënde edhe neve!". Po jetri ju përgjegj, dhe i nëmrenij atij ture i thënë: "Edhe ti s'i trëmbe Perëndisë, megjithëse je i dënuar tek i njëjti pësim? Na me të drejtë jemi dënuar, sepse marrmi rrogën për ato të liga çë bëmë; ai, përkundra, s'bëri faregjë të keqe". E shtoi: "Kujtohu për mua, o Jisu, kur të hysh te rregjëria jote". E Jisui i tha: "Me të vërtetë të thom: sot do të jesh me mua ndë Parrajsit". Ish si ora e gjashtë kur dielli u vrë, e u err ndëpër gjithë jetën njera tek e nëndëta orë. E veli i Tempullit u nda dysh. E Jisui thërriti me zë të madh e tha: "Tatë, ndër duart e tua e lë shpirtin tim". E, si tha kështu, vdiq. E si Qenturjoni pa çë u bë, lavdëroi Perëndinë tue thënë: "Me të vërtetë ky ish një njeri i drejtë!". E gjithë ata gjindë, ardhur se të ruajin atë çë bëhej, kur panë çë kish ndodhur, prirshin ture i ratur stomachjit. E rrijin atje, prej së larg, gjithë ata çë e njihjin, si edhe gratë çë i kishin ardhur pas nga Galilea, ture ruajtur këto shërbise.

Vangjeli i nëndë

Nga Vangjeli sipas Janjit
(19, 25-37)

Nd'atë mot, afër kryqes së Jisuit rrijin e jëma e tij, e motra e s'jëmës së tij, Maria e Kleofës dhe Maria e Magdalës. Jisui ahiera, si pa të jemën e Dishipullin çë doj mirë afër asaj, i tha s'jëmës: "Grua, njo yt bir!". E pëstaj i tha Dishipullit: "Njo jot'ëmë!". E çë ahiera Dishipulli e muar te shpia e tij. Pëstaj Jisui, si dij se gjithsej u kish bënë, se të plotësohej Shkrimi, tha: "Kam etë!". Ndodhej atje një katrolle plotë uthull. Për këtë ata, ngjyeytin një sponxë tek uthulla, e vunë tek mala e njëi kallmri e ja qastin te buza. E pra çë piu uthullën, Jisui tha: "Gjithsej u bë!". E, ulur kryet, dha shpirtin. Ish e prëmtë, e Judhinjtë, se të mos të qëndrojin te kryqja kurmet tek e Shtunia – sepse ish e madhe ajo e Shtunë – parkalestin Pilatin t'i pritëshin këmbët atyreve e të nxirshin nga kryqja. Vanë poka ushtarët e i prenë këmbët të parit dhe jetrit çë kish qënë vënë mbë kryq me 'të. Po kur errunë tek Jisui e panë se kish vdekur, nëng i prenë këmbët, po një ndër ushtarët i shpoi brinjzën me shtizën, e mbjatu i dolli gjak e ujë. E kush e pa bën martri dhe martria e tij është e vërtetë. E ai e di se thotë të vërtetën, se të kini besë edhe ju. Këto shërbise ranë se të plotësohej Shkrimi: "Nëng ka t'i çahet mosnjë asht". E njetër shkrim thotë edhe: "Do t'i ruajën atij çë kanë shpuar".

Vangjeli i dhjetë

Nga Vangjeli sipas Markut
(15, 43-47)

Nd'atë mot, si erdhi Sepa nga Arimatea, këshilltar bular, çë edhe ai prit rregjërinë e Perëndisë, bëri zëmër e vate te Pilati e i lypi kurmin e Jisuit. Pilati u çudit se vërtet kish vdekur, e, si thërriti Qenturjonin, e pyeji nëse kish vdekur vërtet; e kur e xu nga Qenturjoni, i dha kurmin Sepës. E ky, bjejtur një pëlhurë, si e zbriti nga kryqja, e pështolli me pëlhurën dhe e vu te një varr, i gërmuar te shkëmbi, e rrugullisi një gur te dera e varrit. Ndërkaq, Maria e Magdalës dhe Maria e jëma e Josesit ruajin ku e vëjin.

Vangjeli i njëmbëdhjetë

Nga Vangjeli sipas Janjit
(19, 38-42)

Nd'atë mot, Sepa i Arimatesë, (çë ish dishipull i Jisuit, po fshehura se i trëmbej Judhinjvet), i lypi Pilatit të mirrë kurmin e Jisuit. Pilati ja dha. Ahiera ai vate e muar kurmin e Jisuit. Vate edhe Nikodhimi, (ai çë më parë kish vatë natën tek Jisui), e qelli një përzierje mirrje dhe àloe, afro njëqind llibrash. Ahiera ata muartin kurmin e Jisuit, e pështualltin me pëlhura, e lyejtin me val të mershëm, si kanë zakon Judhinjtë kur varrosjën ndonjeri. Te vendi ku u kish kryqëzuar Jisui, ndodhej një kopsht e te kopshti ish një varr i ri, ku adhe mosnjeri kish qënë varrosur. Atje prandaj varrostin Jisuin, sepse ish e prëmtja e Judhinjvet, e varri ish afër.

Vangjeli i dymbëdhjetë

Nga Vangjeli sipas Mateut
(27, 62-66)

Tek jetra ditë, çë është pas së Prëmtës, u mblodhëtin Kryepriftrat e Farisenjtë te Pilati, e i thanë: "Zot, u kujtuam se ai njeri i rremë tha, kur ish adhë i gjallë:"Pas tri ditësh do të ngjallet". Prandaj urdhërò të ruhet varri njera tek e trejta ditë; se të mos të venë Dishipujt e tij, natën, t'e vjedhën e pra t'i thonë gjindjes:"U ngjall nga të vdekurit". Dhe ky do të jetë i sprasmi gënjim, më i keq se i pari". E i tha atyre Pilati:"Ju kini rojën, e ceni dhe ruanie si dini". E ata, si vanë, siguruan varrin, vulostin gurin e vunë rojën.

* Këta 12 Vangjele i gjëni tek "**Vangjeli**" i pjerrë arbërisht nga zot Emanuele Giordano, - me pëlqimin qishtar -, tip.Mit, Cosenza 2006 (supplemento a 'Jeta Arbëreshe', nr.50/2006).

Njoftim / Informacion

Edhe ndëse u buar mot,
ç'te ky numër 80/2015,
e për gjithë numaret të shkuar e të ardhshëm,
revista Jeta Arbëreshe
ka Kodin e saj (Supporto Web ISSN)

ISSN 2465-1141
Jeta arbëreshe [Online]

Ndëse daftë Inzot,
ndëse mbetshim mirë,
ndëse na e ka ënda,

me vitin e ri,
kjo Rivistë
gjashtëmujore online
do të ketë
një Blog të ri.

Urime
për Krishtlindjen 2015
dhe
për Vitin e ri 2016 !

La cultura Arbëreshe è Mediterraneo intrecciato all'Adriatico

Pierfranco Bruni

ka Sullarënxa (Cs)

candidato italiano al Nobel 2015 per la Letteratura

Nel rapporto tra etnie e religioni è imprescindibile una struttura di pensiero che sia letteraria o antropologica. Ci vuole attenzione e conoscenza, professionalità e saperi.

È da trent'anni che lavoriamo su questioni relative al rapporto tra etnie, letteratura e mediterraneo ed è da decenni che pubblichiamo testi con relativi bilanci su una tale questione e non smettiamo mai di approfondire, restare estasiati, rimanere rattristati in quelle realtà cangianti tra il gioco dei colori, la misura del tempo e la cifra dello spazio.

Mi ritornano alcuni canti: *“Sei rosa sei rosa bianca e garofano nella sera dell'estate con il vento sulle onde e le voci di Bisanzio che ascolto tra le vie delle spezie, sono memorie antiche. Porti sul viso il verde e il rosso della trasparenza dei veli delle danzatrici che sfidano il tempo sconfitto dalle età e ti osservo specchiando i miei occhi nei tuoi. Questa sera al canto del muezzin mi avrai nell'anima e i nostri corpi saranno una stretta di isole per viverci come eterni nel finito delle lune sul mare. Ascoltami per una sera ancora. Domani sarà un volo in più nel deserto degli spazi e delle ricordanze”*. Il mondo Balcano è anche quell'Albania che fa i conti con il mondo musulmano e cattolico.

